



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Inxhinieri Agroushqimore”, profili “Teknologji
Agroushqimore”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Laura Shabani

Prof. As. Bedri Dragusha

Shtator/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës të vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL me qëllim vlerësimin e jashtëm të programit të studimit (PS) të Ciklit të dyë Master i Shkencave në “Inxhinieri Agrorshqimore”, profili “Teknologji Agrorshqimore”. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Agrorshqimore”, profili “Teknologji Agrorshqimore” është program studimi ofruar nga Fakulteti Bujqësisë dhe Ushqimit pranë UBT.

Programi “Master i Shkencave në IAU, Profili TAU” u hap me VKM nr.1221, datë 03.09.2008 dhe realizohet pranë Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit ku Departamenti i Teknologjisë Agrorshqimore, është përgjegjës për zbatimin e këtij programi.

Programi Msc në IAU Profili TAU, zhvillohet si një program studimi bashkëkohor për kërkim shkencor dhe transferimin e njohurive, në fushën e bioteknologjisë dhe ushqimit, për krijimin e potencialit teknologjik të vendit dhe kontributin e tij në sektorët e sistemit të prodhimit, kërkimit dhe zhvillimit teknologjik të ushqimit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe integrimin Evropian. Në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në kuadër të këtij programi, janë vënë në dispozicion të tij katër laboratorë bashkëkohorë shkencorë, si dhe janë instaluar pesë linja pilot të prodhimit.

Ky PS është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e FBU dhe jep kontribut në sektorët e prodhimit dhe teknologjitë e ushqimit. PS synon përgatitjen e specialisteve teknologë agrorshqimore, specialistë për ushqimin dhe sigurinë ushqimore, të aftë të kontribojnë në të gjitha etapat e zinxhirit ushqimor.

Në raport janë paraqitur dhe gjetjet e GVJ nga vizita konkrete dy ditore në DTAU dhe takimet me stafin akademik, studentët, dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme që kontribojnë në mbarëvajtjen e punës dhe zhvillimit të PS. Mbi bazën e tyre është bërë plotësimi dhe përgjigjia ndaj të gjitha kërkesave lidhur me plotësimin e kriterëve të standardeve të vlerësimit të jashtëm.

Ky PS pason programin e studimit Bachelor në TAU dhe si i tillë duhet të thellojë më tej studimet dhe formimin shkencor, nëpërmjet moduleve të grup lëndëve inxhinierike; krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë.

Programi i studimit në ciklin e dytë, Master Shkencor në IAU, profili TAU është i organizuar në dy vjet, katër semestra, zhvillon 14 lëndë të vlerësuara në kredite, të shpërndara në tre semestra; dhe finalizohet me punimin e Diplomës Master që vlerësohet me 30 kredite dhe okupon 300 orë të semestrit të katërt. Numri total i krediteve është 120.

Struktura dhe organizimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM nr.41/2018. Kreditet e lëndëve objektivat e studimit, pritshmëritë e aktiviteteve formuese dhe ngarkesa respektive në orë mësimore, janë të paraqitura në çdo syllabus, të moduleve përkatëse sipas VKM nr. 41. Gjithashtu ato janë përmbledhur në kurrikulën e çdo viti si dhe në Planin mësimor të detajuar në orë/kredite.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Në bazë të Agjendës së vizitës dy ditore (10 – 11 Qershor 2019) të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Vlerësimin dhe Akreditimin e programit të studimit: Master Shkencor në "Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore", të Universitetit Bujqësor të Tiranës të miratuar nga të gjitha palët e përfshira u realizuan këto veprimtari të planifikuara:

Datë 10. 6.2019

Ora	Veprimtaria e Planifikuar	Pjesmarrësit në takim
08 ³⁰ – 09 ⁰⁰	Takim i grupit të vlerësimit të jashtëm (Akomodimi dhe diskutim mbi vizitën)	Ky takim u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (Prof B. Dragusha, Prof. Asoc. L. Shabani dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL
09 ⁰⁰ – 10 ⁰⁰	Takim me Dekanin e Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit dhe Përgjegjësën e Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore	Ky takim u realizua me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, në Dekanat.
10 ⁰⁰ –11 ³⁰	Takim me Grupin e vetëvlerësimit të programit	Takimi u realizua me Anëtarët e GVB
11 ³⁰ –12 ³⁰	Takim me stafin akademik të programit të studimit	Takimi u realizua me Stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm për këtë program studimi, në ambjentet e DTAU, ku secili nga pedagogët bëri prezantim të shkurtër të moduleve përkatëse që mbulonte.
12 ³⁰ –13 ³⁰	Vizitë në laboratorët e lëndëve të PS, kimisë, Biologjisë, linjat e përpunimit.	GVJ u shoqërua nga stafi drejtues i Departamentit dhe punonjësit përkatës të Laboratorëve
13 ³⁰ –14 ³⁰	Vizitë në sekretarinë mësimore	Takimi u realizua me Punonjësen e sekretarisë për programin e studimit: Master në "Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore"
14 ³⁰ –15 ⁰⁰	Takim me Qendrën e Karrierës dhe ALUMNI	Takimi u realizua me Përfaqësues të Qendrës
15 ⁰⁰ –15 ³⁰	Mbyllja e ditës së parë të vizites	Ky takim u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm Prof. B Dragusha Prof. Asoc. L. Shabani ; dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL

Datë 11.06.2019

Ora	Veprimtaria e Planifikuar	Pjesmarrësit në takim
08 ³⁰ – 09 ⁰⁰	Takim i shkurtër i Grupit të vlerësimit të jashtëm	Ky takim u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (Prof. Dr. B. Dragusha, Prof. Asoc. L. Shabani ; dhe Koordinatorit Teknik të ASCAL
09 ⁰⁰ – 10 ⁰⁰	Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Mësimit dhe Kurrikulave	Takimi u realizua me Përfaqësues të zyrave përkatëse
10 ⁰⁵ – 11 ⁰⁰	Takim me studentët e programit të studimit	Ky takim u realizua me Studentët e vitit të parë dhe të dytë të këtij programi
11 ⁰⁰ – 12 ⁰⁰	Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore	Takimi u realizua me me personin përgjegjës për këtë zyrë
12 ⁰⁰ – 13 ⁰⁰	Takim me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve	Takimi u realizua me personin përgjegjës për këtë zyrë.
13 ⁰⁰ – 13 ³⁰	Pushim	
13 ³⁵ – 14 ³⁰	Vizitë në Bibliotekë	
14 ³⁰ – 15 ⁰⁰	Takimi përmbyllës me Përgjegjës të Departamentit	Ky takim u realizua vetëm me Përgjegjës të Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, me Prof As A.K.

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi studimi është Specialistia e ASCAL, Znj Suela Kromidha

Më datë 12.09.2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me njoftim zyrtar, është dërguar në UBT Draft RVJ e programit Msc në Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore.

Më datë 18.09.2019, nëpërmjet sistemit AMS vjen përgjigja nga UBT në lidhje me këtë Draft Raport. Përgjigja ju dërgohet GVJ me email. GVJ pa me kujdes përgjigjen dhe objeksionet e dhëna nga Institucioni dhe ka marrë në konsideratë disa prej tyre duke bërë edhe ndryshimin përkatës në Raportin përfundimtar. Për pikat të cilat nuk bëhen ndryshime, GVJ ka dhënë edhe arsyetimin pse nuk bën ndryshime.

Më konkretisht:

I. **Si paraqitet në Draft RVJ** - Standardi I.3, Kriteri 2 (numri i studentëve që ndjekin vitin e dytë të këtij programi studimi nuk është shumë i lartë, 22 studentë, po kaq janë dhe në vitin e parë)

Përgjigja e UBT - Numri i studenteve është 22 sepse pranimi i tyre është kryer në përputhje të plote me Rregulloren e Studimeve të Diplomës së Ciklit të Dytë: MSH në IAU Profili: TAU (dok. 7_1 Neni 4 – Kushtet e Pranimi në Program). Në Rregulloren e Studimeve të Diplomës së Ciklit të Dytë: MSH në IAU Profili: TAU (dok. 7_1, Neni 9 – Numri i pranimi të studenteve) përcaktohet qarte se numri minimal për hapjen e kursit është 10 studente; kuotat për ciklin e dytë të studimeve janë me të reduktuara se cikli i parë, sepse misioni i këtij program studimi është përgatitja e një

elite kerkuesish dhe akademikesh ne sektorin agroushqimor. Per rrjedhoje, nuk konstatojme asnje verejtje reale dhe te qendrueshme lidhur me plotesimin e ketij kriteri. Perkundrazi, theksojme se një nga arsyet e qendrueshmërisë në vite të Programit të Studimit MSH në IAU-TAU, është tregu gjithmonë në zhvillim i punës në sektorin e agropërpunimit dhe ushqimit nëpërgjithësi, dokumentuar me korrekte nga i gjithë dokumentacioni mbeshitetes i vene ne dispozicion (16_2; 16_3; 16_3.1; 17; 32; 34_1; 34_2 dhe 18).

Përgjigja e GVJ -- Komente GVJ: ky fakt nuk është dhënë si vërejtje, por meqënëse më sipër në RVJ raportohet: “se 64% të diplomuarëve janë punësuar si teknolog agropërpunimi etj. “për të kuptuar se sa studentë realisht përfaqëson kjo përqindje. Këta studentë nuk janë të vetmit në tregun e punës, sepse edhe PS nuk është i vetmi që ofrohet nga Institucionet e Arsimit të Lartë. (ashtu si tregohet dhe në analizën përfundimtare).

GVJ nuk bën ndyshime në RVJ përfundimtar

- II. Si paraqitet në Draft RVJ - Standardi I.3, Kriteri 4 -** Ne RVJ permendet vetem se “Sipas dokumentave të paraqitura, duhet të cilësojmë se të dy Programet e Studimit, kurrikulat e të cilëve referohen për ngjashmëri me Programin MSH në IAU-TAU, emërtohen Master Shkencor “Teknologji Ushqimore”. Dokumenti i dorëzuar nr 14-10.1 dhe 14-10.2”

Përgjigja e UBT - Ky kriter percakton “*perafrimin me programe studimi te ngjashme te ofruara nga institucione nderkombetare*” dhe jo me “*programe studimi me emertim te njejte*”. Vlen te theksohet se nga krahasimi i kurrikulave të Programit të Studimit Master Shkencor me të njëjtin drejtim, rezulton një ngjashmëri shumë e madhe midis programeve të studimit. Kështu, rezulton që 71.4% e lëndëve në FBU (10 lëndë), janë pothuajse ose krejtësisht të njëjta me lëndët që zhvillohen në programin e studimit Master Shkencor ne Teknologji Ushqimore te zhvilluar në Universitetin e Molise-s (Ref.14_10.1); ndërsa, nga krahasimi FBU – Universiteti i Milanos, rezulton se numri i lëndëve të MSH në IAU-TAU është gjithësej 14, ndërsa në UMIL numri i lëndëve është 12. Përmbajtja e të 7 lëndëve të UMIL përputhet 100% me programet e lëndëve përkatëse në FBU (Ref. 14_10.2). Përputhshmëria e lartë e programeve, ka bërë që të ketë levizje të konsiderueshme të studentëve tanë drejt këtyre universiteteve, për programe exchange për një periudhë studimi prej një apo dy semestra, si dhe për mbrojtje temash diplome të përbashkëta (Ref.35_2; Ref.35_3; Ref.79_2; Ref.35_1).

Përgjigja e GVJ – GVJ thekson se kjo konfirmohet në RVJ. Shënimi më sipër është në funksion të objeksionit që RVJ ka për emërtimin e këtij PS. Sqarojmë që bazuar në kurrikulat egzistuese dhe përfrimin në shkallë të lartë me programet më sipër, emërtimi i këtij PS koncidon më mirë Master Shkencor “Teknologji Ushqimore”se sa MSH në IAU-TAU

GVJ nuk bën ndyshime në RVJ përfundimtar

- III. Si paraqitet në Draft RVJ -** Vlerësimi i dhënë për Standardin I.3 nga GVJ është “KRYESISHT”

Përgjigja e UBT - Ne perfundim te Standardit I.3 konstatojme se nuk eshte paraqitur asnje verejtje objektive dhe e qendrueshme lidhur me plotesimin e kerkesave te ketij standardi. Prandaj, pretendojme qe shkalla e vleresimit te tij te ndryshoje nga “Kryesisht” ne “Plotesisht”

Përgjigja e GVJ - Shkalla e vlerësimit të Standartit I.3 është dhënë “Kryesisht” duke u mbështetur në kriterin 7 dhe 8 të standartit, të cilat nuk përputhen me kriterin.

Kriteri 7: Ne programin e studimit “Master i shkencave ”Master i arteve”, duhet te përfshihen elemente te mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi ne gjuhe te huaj me qëllim thithjen

e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe nderkombëtarizimit të institucionit.

Përgjigjia në RVJ: *Programi i studimit MSH në IAU profili TAU zhvillohet në gjuhën shqipe meqënëse dhe studentët janë shqipfolës të vendit dhe nga trojet.*

Në vazhdim RVJ: *“Stafi mendon dhe ka planifikuar për tu përgatitur në gjuhë të huaj (anglisht) dy module nga lënda “Metodologji e Kërkimit Shkencor” dhe një modul nga lënda “Toksikologjia e ushqimeve”, për vitin akademik 2019-2020, me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe nderkombëtarizimit të institucionit.”. Pra si shkruhet aty flitet për planifikim dhe për tu përgatitur pra nuk është materializuar, nuk zhvillohen module në gjuhë të huaj (anglisht).*

Kriteri 8: Për programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.

Përgjigjia në RVJ: *Aktualisht departamenti ka arkivuar në gjuhën angleze dokumentacionin: CV akademike të pedagogëve, Programe të lëndës sipas formatit VKM nr.41, Lista studentësh në programe shkëmbimi Erasmus, dhe disa Plane kalendarë për modulet e programit.*

Pra si shkruhet aty flitet për një pjesë të dokumentacionit dhe jo për të gjithë dokumentacionin si e kërkon kriteri.

GVJ mendon që vlerësimi për standartin I.3 të mbetet “KRYESISHT”

IV. Si paraqitet në Draft RVJ - Standardi I.4, Kriteri 2 - Në RVJ paraqiten dy vërejtje lidhur me këtë kriter.

Vërejtja 1: “kemi informacion që UBT ka bërë kërkesën pranë MAS për kodifikimin e Programeve të Studimit, por nuk ka marrë ende një konfirmim të këtij kodifikimi”

Përgjigjia e GVJ për Vërejtjen 1: *Kodifikimi i programeve të studimit është një veprim që NUK kryhet nga Institucioni (UBT) apo nga Fakulteti, por nga MAS. Me sa konstatojmë, të gjitha programet e studimit të zhvilluara në UBT janë në pritje të këtij kodifikimi.*

Përgjigjia e GVJ: Dakort me objeksionin

Vërejtja 2: “Emërtimi i programit të studimit bëhet me dy emra, kjo sqarohet në një dokument, tabelë e gjithë programeve të studimit që UBT ofron e manaxhon. Programet klasifikohen sipas fushës së studimit (Inxhinieri Agrorshqimore), profili (Teknologji Agrorshqimore) dhe kategorisë Bachelor ose Master (profesional/shkencor). Dokumenti i dorëzuar nr 26. Në fakt, mendoj që fusha e studimit është më e gjërë se profili i studimit, sipas kësaj logjike programi duhet të emërohet: MSC Teknologji Agrorshqimore profili Inxhinieri Agrorshqimore. Unë mendoj që programet të emërtohen thjeshtë, me një emërtim dhe jo me dy siç emërtohet nga institucioni (në rastin e këtij programi: Master Shkencor në Inxhinieri Agrorshqimore me profil Teknologji Agrorshqimore); ose më thjeshtë. Mendojmë se është më mirë që programi i studimit në fjalë të emërohet thjesht Master Shkencor në “Inxhinieri Agrorshqimore”, meqënëse është i nivelit master dy vjet, pra studime të thelluara dhe të profilizuara dhe paraprihet nga PS bachelor në Teknologji Agrorshqimore. Për të mbajtur këtë emërtim Master Shkencor në “Inxhinieri Agrorshqimore”, rekomandojmë të shikohet dhe të përmirësohet kurrikula me module të grup lëndëve inxhinierike”

Përgjigjia e GVJ për Vërejtjen 2: *Emërtimi i Programit të Studimit në IAU Profili TAU, është kryer në bazë të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.1221, datë 03.09.2008, në bazë të Vlerësimit pozitiv të dhënë nga Keshilli i Akreditimit dt.26.08.2008 lidhur me hapjen e këtij programi. Theksojmë se paraparakisht emërtimi dhe përmbajtja e këtij PS kanë qenë objekt debati të gjere në Keshillin Shkencor të Fakultetit, në Senatën e UBT si dhe në terheqjen e opinionit të profesoreve me të njohur të fushës nga Universitetet perendimore me të cilët kemi patur bashkëpunim.*

1. Në të njëjtin vendim urdherohet hapja edhe e programeve të tjera të studimit, pjesë e

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

www.ascal.al

Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, me emërtimin Inxhinjeri Agrarë me profile të ndryshme si: Hortikulture, Mbrojtje Bimesh, Prodhim Bimor, Zootekni dhe Akuakulture; si dhe Inxhinjeri Mjedisit. Nga ana jone, si FBU dhe Departamenti i Teknologjisë Agrorëshqimore kemi hartuar dhe zbatuar një kurrikulë që përfaqëson me se miri termin "Inxhinjeri Agrorëshqimore" si drejtim të programit të studimit. Kështu një total prej 15 modulesh që zhvillohen në këtë PS, 6 prej tyre janë module të mirëfillta inxhinjerieke (Ref.14_7.5) si: Kimia Fizike e Ushqimeve; Inxhinjia e Perpunimit të Ushqimeve; Reologjia e brumerave; Bioteknologjia e Fermentimeve dhe Projektimi në Industrinë Ushqimore, Teknikat Bashkohore të Paketimit. Vlen të theksohet, se edhe pjesa tjetër e moduleve (9 prej tyre), kanë orientim të theksuar si inxhinjierik ashtu edhe teknologjik, duke përmbushur objektivat e formimit të këtij PS

Përgjigja e GVJ - Në RVJ thuhet: që programet të emërtohen thjeshtë, me një emërtim dhe jo me dy siç emërtohet nga institucioni (në rastin e këtij programi: Master Shkencor në Inxhinjeri Agrorëshqimore me profil Teknologji Agrorëshqimore); ose më thjeshtë Mendojmë se është më mirë që programi i studimit në fjalë të emërohet thjesht Master Shkencor në "Inxhinjeri Agrorëshqimore". Mendoj që kjo është më e përshtatshme për të eliminuar ngatërimet ose "lapsuset" me emërtimin e programit të studimit edhe në dokumentet zyrtare. Mendojmë që nga 6 modulet e mësipërme 3 janë të mirëfillta inxhinjerieke: *Inxhinjia e Perpunimit të Ushqimeve, Reologjia e brumerave dhe Projektimi në Industrinë Ushqimore. Në lidhje me modulën e fundit (Projektimi në Industrinë Ushqimore,) duhet të theksojmë se referuar syllabusit të lëndës temat që trajtohen kanë të bëjnë me inovacionin e produkteve të reja se sa mirfilli projektim në industrinë ushqimore. Kështu në total nga 15 module (një prej të cilave është teza e diplomes) 3 janë të mirëfillta inxhinjerieke. Gjithashtu duhet të zhvillohet moduli Bioinxhinjeri (në vend të Bioteknologjisë e Fermentimeve)*

Në RVJ thuhet: rekomandojmë të shikohet dhe të përmirësohet kurrikula me module të grup lëndëve inxhinjerieke". Këtu përmend dhe sygjeroj disa nga modulet e këtij grupi që kanë të bëjnë me modelimin matematik dhe fizik, dinamikën, simulimin dhe optimizimin e proceseve në industri dhe në fund me projektimin e proceseve dhe impjanteve. Komenti GVJ: Përsa i takon pjesës tjetër të moduleve, një pjesë kanë orientim teknologjik si: "Shkencat e bulmetit dhe prodhimi i djatherave special" "Rruajtja dhe mbrojtja e produkteve ushqimore," "Teknikat bashkohore të paketimit", "Drejtimi i cilesise dhe sigurise ushqimore". Nga ana tjetër, 4 module nuk kanë lidhje me orientimin teknologjik ose inxhinjierik, si "Toksikologjia e ushqimeve" "Biokimia e ushqimit dhe të ushqyerit tek njeriu" Kimia e produkteve natyrore" "Metodologji e kërkimit shkencor", *kjo sipas dokumentit të dorëzuar 14.7.5, kurrikula 2018-2019 dhe syllabuseve përkatëse.*

GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtar

V. **Si paraqitet në Draft RVJ** - Standardi I.4, Kriteri 3 - Vlerësimi i dhënë për Standardin I.4 nga GVJ është "PJESERISHT"

Përgjigja e UBT - *Ne përfundim të Standardit I.4 konstatojmë se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qendrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, pretendojmë që shkalla e vlerësimit se tij të ndryshojë nga "Pjeserisht" në "Plotësisht"*

Përgjigja e GVJ: Vërejtjet që lidhen me kriterin 2 të këtij standardi, duke u mbështetur edhe në argumentet e mësipërme, që kanë të bëjnë me përmbajtjen e kurrikulës e cila nuk e përfaqëson plotësisht emërtimin e Programit të Studimit, i vlerësojmë si shumë të rëndësishme, prandaj shkalla e vlerësimit mbetet PJESERISHT

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

VI. Si është paraqitur në Draft RVJ Standardi I – Përfundimi I vlerësimit të këtij Standardi është “Kryesisht”

Përgjigja e UBT - *Ne përfundim të shqyrtimit të vlerësimit të bërë në plotësimin e kriterëve të Standardit I dhemeqenese 4 kriterë nga 6 janë vlerësuar plotësisht, lutemi rivlerësimin e këtij standardi me pretendimin nga Vlerësimi “Kryesisht” në “Plotësisht”*

Përgjigja e GVJ - Institucioni nuk i ka parë mirë vlerësimet e standarteve të fushës I. Mendojmë se 4 kriterë “Plotësisht” nga 6 kriterë gjithësej janë 2/3 ose afërsisht 70%, kështu nuk mund të jetë vlerësimi total i fushës II në kategorinë “Plotësisht”. Ndërkohë që dy kriterë të tjera, I.3 ka vlerësim kryesisht dhe I. 4 ka vlerësim pjesërisht. Vlerësimi përfundimtar mbetet “KRYESISHT”

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

VII. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II. 2 Kriteri 3 - Verejtje e RVJ: “Nga vizita e GVJ pranë institucionit, takimi me studentët, e programit master u konstatua që lënda e PS: “Inxhinieria e përpunimit të ushqimeve” nuk zhvillohet nga staf i brendshëm përgjegjës i lëndës, sipas përcaktimit në syllabusin përkatës. Ky modul zhvillohet nga pedagog staf akademik i jashtëm emri i të cilit nuk figuron në listën e miratuar të pedagogëve të jashtëm për këtë vit akademik (verifikuar edhe në zyrën e burimeve njerëzore). Leksionet e këtij moduli nuk zhvillohen në ambjentet e FBU, studentët zhvillojnë leksionet në ambjentet e FSHN –UT”

Përgjigja e UBT - *Eshte e vertete qe ne listen e pedagogeve te jashtem te programuar ne fillim te vitit, nuk kemi perfshire pedagogun e jashtem Prof.Dr. I. M., ne lenden “Inxhinieria e Perpunimit te Ushqimeve”, sepse fillimisht u mendua se kjo ngarkese mund te perballohej nga stafi I brendshem (Ref.14_7.5 – Kurrikula 2018-2019). Lenda zhvillohet semestrin e dyte. Por ne muajt e pare te semestrit te pare, FBU/DTAU fitoi si coordinator nje projekt Erasmus per ngritje kapacitetesh “STEPS”. Ne keto kushte ngarkesa e stafit te brendshem (Prof.As. A.K. – titullare e modulit) u rrit tej parashikimit, per shkak te angazhimit ne kete projekt. Per kete arsye Prof. I. Malollari (I cili eshte nje nga bashkepunetoret me te ngushte te institucionit, qe ne themelimin e tij) u ofrua vullnetarisht te angazhohet pa pagese per te realizuar nje ngarkese prej 30 ore mesimi. Pjesa tjeter e ngarkeses se këtij moduli eshte realizuar nga personeli i brendshem i fakultetit, Theksojme se sa me lart, nuk eshte cenuar aspak cilesia e mesimdhënies. Perkundrazi, bashkepunimin me profesorin e konsiderojme nje vlere te shtuar jo vetem nga pikepamja shkencore dhe profesionale, por edhe ne aspektin e bashkepunimit te shendoshe midis dy IAL-ve, UBT dhe Universitetit te Tiranës (Fakulteti I Shkencave te Natyres).*

Përgjigja e GVJ: Objeksioni është thjesht shpjegim i problematikës së ngritur në RVJ, mendojmë se vërejtja e bërë në RVJ qëndron, pasi institucioni nuk ka dokument zyrtar që të vërtetojë angazhimin e pedagogut në fjalë në mesimdhënie.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

VIII. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II. 2 Kriteri 6 - Ne RVJ nuk është paraqitur bazikisht asnjë vlerësim lidhur me plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni mbështet konstatohet i plotë dhe në përputhje me kriterin. Pretendimi se “Nuk ka dokument të vendimit për emërimin e koordinatorit të PS”

Përgjigja e UBT – *Ky fakt nuk qëndron sepse: Rregullorja e studimeve të FBU (Ref.6_1) përcakton qartë detyrat dhe rolin e Përgjegjës të departamentit; konkretisht në Nenin 16, pika 6, pika 8 dhe pika 14. Në keto kushte bëhet e vërtetë roli i Përgjegjës të Departamentit si Koordinator i cdo programi studimi që mbulon Departamenti që ai drejton.*

Përgjigja e GVJ: Dakort me objeksionin

GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar duke e hequr fjalinë “Nuk ka dokument te vendimit për emërimin e koordinatorit të PS”

IX. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.2 – Vlerësimi për këtë Standard është “Pjesërisht”

Përgjigja e UBT - *Ne përfundim te Standardit II.2 konstatojme se nuk eshte paraqitur asnje verejtje objektive dhe e qendrueshme lidhur me plotesimin e kerkesave te ketij standardi. Nga 7 kritere, ne vetem 1 prej tyre (kriteri 3) ka patur nje verejtje, e cila me pas eshte sqaruar. Per kete arsye lutemi rivleresim me pretendimin qe shkalla e vleresimit se tij te ndryshoje nga “Pjeserisht” ne “Plotesisht”.*

Përgjigja e GVJ: - GVJ mendon se vërejtja ose konstatimi që jepet në kriterin 3, është e rëndësishme, tregon se institucioni nuk ka treguar seriozitet me dokumentacionin zyrtar përkatës. Prandaj mendojmë që nuk mund ta neglizhojmë. Vlerësimi nuk mund të jetë plotësisht. Vlerësimi mbetet **PJESERISHT**

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

X. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.3, Kriteri 2 - Ne RVJ verehet: “Ato paraqiten qartë në sylabuset përkatëse të lëndëve ndersa planet kalendare nuk gjenden në dokumentat e dorëzuar; në RVB ato referohen si dokument nr 54”

Përgjigja e UBT - *GVB gjykoj te pergatiste dhe dorezonte edhe Planet Kalendare te moduleve, megjithese ato nuk kerkoreshin si dokumentacion mbeshtetes. Keto Plane Kalendare jane dorezuar ne disk dhe hard copy si dokumenti 54_1 - Plane Kalendare Shqip de Dokumenti 54_2 – Plane Kalendare ne Anglisht. Per cdo rast jemi te gatshem t’jua veme perseri ne dispozicion.*

Përgjigja e GVJ - Komenti: GVJ i përmbahet faktit që nuk është e domosdoshme egzistenca e dy dokumentave paralele syllabus dhe plane kalendarike kjo është përmendur edhe në kriteret e tjera.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XI. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.3, Kriteri 4 - Në RVJ Vërejtje 1: “Në planin mësimor 2018-2019, të PS MSC IAU-TAU, Dokumenti i dorëzuar nr 14.8.3 në lidhje me këto informacione ka paqartësi. Ngarkesa mësimore e moduleve ndahet vetëm në dy zëra: orë leksion dhe seminare. Nga vizita e GVJ në DTA u konstatua që disa module të programit zhvillojnë edhe séance praktike laboratorike, por ato nuk pasqyrohen as në planin mësimor as edhe në sylabuset e lëndëve përkatëse. Mendojmë që në planin mësimor duhet të jepet informacion për peshën që zënë në ngarkesën javore seancat laboratorike, dhe të specifikohet ngarkesa sipas tre zërave: orë leksion: orë seminar/ushtrime, orë laboratore. Gjithashtu kjo duhet të pasqyrohet paralelisht në sylabuset përkatëse të lëndëve që zhvillojnë seanca praktike laboratorike, shoqëruar edhe me tematikat e laboratoreve. Këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lënde ashtu si e parashikon VKM Nr 41 dt 24.01.2018. Nuk është e nevojshme që krahas programit të lëndëve të jenë dhe planet kalendarike thjesht për të treguar tematikat e seminareve ose praktikave laboratorike. Ky dokument nuk është në ato të dorëzuara për këtë PS por pretendohet nga pedagogët përkatës se egziston për çdo lëndë”.

Përgjigje e GVJ per Verejtjen 1: GVJ eshte kontradiktore ne analizen qe i ben me lart vleresimit te paraqitjes se elementeve te mesimit dhe shpendarjes se tyre. Keshtu, nqs do te shikohet me poshte, ne vleresimin e kriterit 6 lidhur me informacionet qe permban Programi i studimit, GVJ

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

www.ascal.al

shprehet se: *“Titullarët e moduleve/lëndëve, pjesë e personelit akademik të DTAU, ku ky program studimi operon, dorezojnë çdo fillim viti akademik, programin lëndor (syllabus-in) për modulën që mbulojnë, në formatin e përcaktuar të VKM Nr 41/2018. Gjithashtu referuar ndarjes së praktikave lëndore, leksioneve, seminare dhe gjithë pjesëve përbërëse të modulit, secili titullar lëndë paraqet në departament, planin kalendar ku ka të specifikuar me orë dhe përqindje, të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e lëndës. Dokumenti i dorëzuar nr14.2 shtojca 2”.* Duke dashur ti pergjigjemi gjithësesi Verejtjes se bere ne Kriterin 4, po vazhdojme me poshte me obieksionet tona:

2. Ne planin Mesimore14_8.3 pasqyrohen dy zerat kryesore: Leksione dhe Seminare. Kjo gje eshte bere per aresyen e thjeshte se “Seminaret” zhvillohen ne menyra te ndryshme, ne varesi te karakterit te modulit. Keshtu, ne disa module ato zhvillohen ne forme teorike, ne disa module zhvillohen ne forma ushtrimesh dhe ne disa te tjera ne forme seancash laboratorike. Ne pjesen me te madhe te moduleve “seminaret” perbehen nga forma te kombinuara, pra teorike, laboratorike apo ushtrimore. Per kete aresye, Planet Mesimore i kemi paraqitur thjesht, dmth te fokusuara vetem ne dy zera, duke patur si qellim evidentimin e ngarkeses mesimore dhe jo llojin e ngarkeses. Kete gje ia kemi sqaruar edhe eksperteve te GVJ gjate vizites se tyre.

3. *Formati i VKM Nr 41 dt.24.01.2018, Shtojca Nr.2 “Programi i lendes” lejon vetem paraqitjen e tematikave te zhvilluara nen zerin “Temat e Lendes”. Per kete aresye, ne perputhje me kete Format, ne kemi paraqitur vetem Temat e moduleve perkatese, pa i detajuar dhe ndare ato ne Leksione, Ushtrime, Praktika laboratorike etj. Sa me siper, eshte zbatuar ne te njejten menyre nga te gjitha programet e studimit ne UBT. Theksojme se kjo menyre paraqitjeje eshte kryer vetem gjate vitit akademik 2018-2019, pra ne zbatim te VKM Nr.41 Shtojcanr.2. Para ketij viti, Syllabuset paraqiteshin ne menyre shume te detajuar, sipas nje formati te emetuar nga Rektorati i UBT. Nga konsultimi qe u be me ekspertin e ASCAL gjate vizites se GVJ, na u tha se pavaresisht Shtojces nr.2, ne jemi te lire te shkruajme ne menyre te detajuar edhe oret e seminareve.*

4. *Duke patur si qellim paraqitjen sa me te sakte te menyres se si kryhen oret e “Seminareve”, kemi plotesuar Planet Kalendar te lendeve, ku jane evidentuar ne menyre te hollesishme oret konkrete te zhvillimit te seminareve teorike, praktikave laboratorike, ushtrimeve, detyrave te kursit, detyrave te kontrollit ndermjetes etj se bashku me tematikat perkatese. Keto Plane kalendarare disponohen ne dokumentat 54_1 (Shqip) dhe 54_2 (Anglisht).*

5. *Sa me siper, mendojme se nuk e cenojne cilesine e paraqitjes dhe kontrollit te mesimdhënies, pasi Departamenti dhe Fakulteti kane konsideruar dokument baze, krahas Planeve Mesimore dhe Syllabuseve te lendeve, Planet Kalendarare - te cilat tregojne ne kohe reale zhvillimin konkret te mesimit, sipas tematikave dhe ngarkeses se aprovuar.*

Përgjigja e GVJ - Nuk ka vlerësim kontradiktor lidhur me këtë kriter dhe kriterit 6, (gjithësesi do ta komentojmë në kriterin 6). Në RVJ jemi shprehur qartë në lidhje me mënyrën e paraqitjes së ngarkesës në syllabus për elementët leksione, seminare/ushtrime, dhe laboratore në auditor. Për ato module që i zhvillojnë të tre këto elemente duhet të dali e qartë ne syllabus sa ore në javë studenti bën leksion, sa orë seminar ose ushtrime dhe sa orë laboratore. Kjo nuk është treguar në syllabuset përkatëse. Përveç ngarkesës për secilën nga këto elemente duhet te pasqyrohen, gjithashtu në syllabus dhe tematikat e leksioneve dhe temat e laboratorëve. Nuk është e nevojshme egzistenca paralele syllabus dhe plane kalendarike për secilin modul.

Verejtje 2: *“Në planin mësimor figuron për të gjitha modulet që provimi përfundimtar zhvillohet me gojë, ndërkohë që në programet e lëndëve përkatëse mënyra e provimit ndryshon; kryesisht është me shkrim, ose shkrim gojë”.*

Përgjigja e UBT- *Konstatim i sakte. Mendojme se pasaktesia ne Planin Mesimor, ka qene nje lapsus i printimit. Forma e zhvillimit te provimit:me shkrim apo me goje, eshte përcaktuar qarte ne Programin e lendes sipas VKM nr.41 dhe eshte zbatuar rigorozisht sipas ketij dokumenti.*

Përgjigja e GVJ - Institucioni e pranon që ka mospërputhje për mënyrën e pasqyrimin të zhvillimit të provimit në këto dy dokumenta.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XII - Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.3, Kriteri 6 - RVJ shprehet pozitivisht në lidhje me këte kriter,

Përgjigja e UBT - duke kontradiktuar vërejtjen e bërë në kriterin 4 të këtij standardi: “Titullarët e moduleve/lëndëve, pjesë e personelit akademik të DTAU, ku ky program studimi operon, dorëzojnë çdo fillim viti akademik, programin lëndor (syllabus-in) për modulën qëmbulojnë, në formatin e përcaktuar të VKM Nr 41/2018.

Gjithashtu referuar ndarjes së praktikave lëndore, leksioneve, seminare dhe gjithë pjesëve përbërëse të modulit, secili titullar lënde paraqet në departament, planin kalendar ku ka të specifikuar me orë dhe përqindje, të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e lëndës. Dokumenti i dorëzuar nr14.2 shtojca 2”.

Përgjigja e GVJ - GVJ gjykon se nuk ka kontraditë, me kriterin 4, **këtu thuhet konstatimi** që titullarët dorëzojnë dy tip dokumentash, syllabus dhe plan kalendar me informacionin e nevojshëm për organizimin e lëndës. Ndërkohë në kriterin 4, në RVJ tregohet se nuk është e nevojshme egzistenca paralele syllabus dhe plane kalendarike për secilin modul, (kjo është vërejtja që ka GVJ mbi këtë problem). Gjithashtu kjo pohohet më poshtë dhe në këtë kriter. Në vazhdim të paragrafit të cituar më sipër në objeksioni e Institucionit, marrë nga RVJ, është shkruar: Këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lëndë ashtu si e parashikon VKM Nr 41/2018. Nuk është e nevojshme që krahas programit të lëndëve të jenë dhe planet kalendarike

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XII. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.3, Vlerësimi për këtë Standard është “Pjesërisht”

Përgjigja e UBT - Në përfundim të Standardit II.3 konstatohet se nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, kërkojmë rivlerësim dhe pretendojmë që shkalla e vlerësimit të jetë “Pjesërisht” në “Kryesisht”.

Përgjigja e GVJ - GVJ nuk është dakort me gjykimin e mësipërm që “nuk është paraqitur asnjë vërejtje objektive dhe e qëndrueshme lidhur me plotësimin e kërkesave”. mendojmë se vërejtjet qëndrojnë dhe janë të rëndësishme. Vlerësimi i standartit II 3 mbetet **PJESËRISHT**.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XIII. Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.4, Kriteri 5 - Vërejtje: Në ciklin e dytë të studimeve organizimi i moduleve dhe raportit midis formimit teorik dhe praktik është 1:2 parashikuar sipas Rregullores së Studimeve MSH në IAUTAU, dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 7. Në fakt sipas planit mësimor të këtij PS ky raport është 2 orë leksion:2 orë seminare/laborator pra 1:1. Në total 420 orë leksione • 480 orëseminare, ushtrime, punë laborator dmth 1:1,4”

Përgjigja e UBT - Në Rregulloren e Studimeve MSH në IAU-TAU (Ref.7_1, neni7) nuk është përcaktuar ndonjë raport midis formimit teorik dhe praktik 1:2; Raporti aktual që ne zbatojmë në këte PS është ai i deklaruar në Planin mesimor, pra 1:1 (2 ore leksion + 2 ore seminare) në auditor; Në Rregulloren e studimeve të PS, ku theksohet: 420 ore leksion = 480 ore seminare (të ndara në 420 ore seminare në auditor dhe 80 ore vizita në kompani prodhimi dhe biznese). Pra, bazikisht, në I përmbahemi ngarkesës 1:1 të oreve në auditor të deklaruar në Planin Mesimor.

Përgjigja e GVJ - GVJ është dakort dhe pohon faktin e cituar më sipër, por duke treguar që vetë

institucioni në RVB cilëson se ky raport është 1:2 parashikuar sipas Rregullores së studimeve MSH në IAUTAU, dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 7. Kjo rezulton e gabuar

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XIV - Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.4, Kriteri 6 - Në RVJ në përgjithësi shprehen mendime pozitive lidhur me përdorimin e literaturës në këto PS.

Konstatohet që në disa module literatura nuk është pasqyruar në programin e lëndëve, e detajuar për çdo kapitull, sipas formatit të rekomanduar nga VKM nr 41

Përgjigja e UBT - Në VKM nr.41 Shtojca 2 nuk kërkohej pasqyrimi i literaturës së rekomanduar apo baze për çdo kapitull të lëndës.

Vërejtje 2: “Në modulën: **Inxhinjeria e përpunimit të ushqimeve nuk është shënuar literatura**”

Përgjigja e UBT - Sakte. Është harruar pa u shënuar

Përgjigja e GVJ – Institucioni pohon dhe vërejtja mbetet.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XV - Si është paraqitur në Draft RVJ - Standardi II.4, Kriteri 9 - Në RVJ vërehet se: “Nga dokumentat e dorëzuara nuk rezultojnë marrëveshje konkrete të nënshkruara midis UBT_FBU dhe bizneseve. Dokumenti i dorëzuar nr 34.1 është vetëm një listë biznesesh bashkëpunuese dhe dokumenti i dorëzuar nr 34.2 është vetëm një format marrëveshje”

Përgjigja e UBT - Njësia bazë, FBU, bashkëpunon në mënyrë të vazhduar me biznesin. Në funksion të nevojave për zhvillimin e procesit mësimor, realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushën e Ushqimit dhe transferimit të njohurive FBU operon me marrëveshje dypalëshe të zyrtarizuara.

Kështu në dokumentin 32 jepen disa Marrëveshje bashkëpunimi të skanuara midis UBT dhe disa institucioneve shtetërore (Ministria e Bujqësisë, AKU) dhe një firmë private CMB Albania Shpk.

1. *Praktikat profesionale (dokumentacion në dosjen e RVB Bacheor IAU-TAU) dhe një pjesë e madhe e temave të Diplomes MSH zhvillohen pranë bizneseve, sic është dokumentuar në 35_1.*

2. *Lista e bizneseve e dokumentuar me dokument nr.34_1 është një dokument serioz i vertetuar nga Përgjegjësi i DTAU, mbi bazën e një databazë që FBU dhe DTAU disponojnë mbi bashkëpunimin me bizneset. Sic mund të shihet, kjo listë përmban emrin e personit të kontaktit, llojin e aktivitetit dhe numrin e telefonit, pra është shumë e lehtë të verifikohet.*

Arsyeja e paraqitjes vetëm të listës përmbledhëse të bizneseve me të cilat FBU ka bashkëpunim, ishte për të evituar dokumentacionin e zgjeruar që kjo dosje përmban. FBU i disponon këto dokumente dhe mund të verifikohen në çdo kohë

Përgjigja e GVJ - Në dokumentat e dorëzuar 34.2 nuk ka marrëveshje të zyrtarizuara dypalëshe. Ai është thjesht një model ose template e marrëveshjes dypalëshe. Faleminderit për sqarimet në lidhje me këtë kriter

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XVI - Si është paraqitur në Draft RVJ - Vlerësimi sipas GVJ I Standardit II.4 është “KRYESISHT”

Përgjigja e GVJ - Në përfundim të Standardit II.4 konstatohet se nuk janë paraqitur vërejtje të genesishme lidhur me plotësimin e kërkesave të këtij standardi. Prandaj, lutemi që shkalla e vlerësimit të tij të ndryshojë nga “Kryesisht” në “Plotësisht”

Përgjigja e GVJ - GVJ mendon se vërejtjet e bëra nuk e justifikojnë vlerësimin “Plotësisht”

vlerësimi mbetet **KRYESISHT**

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XVII - Si është paraqitur në Draft RVJ - Vlerësimi për fushën II është dhënë Kryesisht Përgjigja e UBT - *Ne perfundim te shqyrtimit te verejtjeve te bera ne plotesimin e kritereve te Standardit II, lutemi rivleresimin e ketij standardi duke kaluar nga Vleresimi "Kryesisht" ne "Plotesisht"*

Përgjigja e GVJ – Fusha II ka 8 Standarte, nga të cilat 5 standarde janë vlerësuar plotësisht, 1 kriter është vlerësuar kryesisht dhe 2 kritere janë vlerësuar pjesërisht. Bazuar në sa më sipër vlerësimi nuk mund të jetë plotësisht. **Vlerësimi mbetet KRYESISHT**

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XVIII - Si është paraqitur në Draft RVJ Standardi III.2 Kriteri 1 - Verejtje: "Raporti midis formimit teorik dhe praktik 1:1,14 dhe jo 1:2 si parashikohet në rregulloren e programit master Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 7"

Përgjigja e UBT - *Në rregulloren e programit master Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 7" nuk paraqitet ne asnje rresht raport 1:2*

Përgjigja e GVJ - Kjo është diskutuar dhe në standartin dy, raporti 1:2 si parashikohet në rregulloren e programit master Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 7" kjo është pjesë dhe konstatim i RVB, që siç shihet është i gabuar. GVJ e ka cilësuar bazuar në planet mesimore që ky raport është 1:1

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XIX - Si është paraqitur në Draft RVJ vlerësimi për Standardin III.2 është "Kryesisht:

Përgjigja e UBT - *Sic mund të shikohet, praktikisht nuk ka ASNJË vërejtje negative nga ana e GVJ për Standardin III.2. Mendojmë se vlerësimi që GVJ i ka dhënë Standardit III.2 si "Kryesisht" është një lapsus. Ai duhet të kthehet menjëherë në "Plotësisht"*

Përgjigja e GVJ - Së pari mendoj që institucioni në komunikimet duhet të respektojë etikën dhe nuk mund të shprehet në mënyrë urdhërore "Ai duhet të kthehet menjëherë në "Plotësisht". Së dyti duhet të sqarohet se kjo nuk është lapsus, por fillimisht vlerësimi është bërë me % dhe me pas u kalua në kategorizimet aktuale (vlerësimi nuk ka qënë 100%). Objeksioni dhe kërkesa e institucionit është marrë në konsideratë, kështu për standartin III.2 vlerësimi bëhet "**Plotësisht**"

GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XX - Si është paraqitur në Drfat RVJ, Standardi III.3, Kriteri 1: GVJ nga vizita në institucion konstatoi se laboratorët janë ambiente të përshtatshme për veprimtarinë formuese përkatëse, janë të pajisur me aparaturat e nevojshme, mbahen mirë, por grupet laboratorike të studentëve që punojnë aty brenda një séance janë me numër të lartë, 20 studentë. Duket një sipërfaqe e vogël për këtë numër studenësh dhe nuk krijohet mundësia për pjesëmarrjen aktive të tyre"

Përgjigja e UBT - *Mendojme se gjykimi mbi siperfaqet ne dispozicion te studenteve per veprimtari laboratorike, duhet bere mbi baze faktesh e normativash, e jo mbi baze "dukjeje". Keshtu, ne*

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

www.ascal.al13

dispozicion te studenteve te MSH LAU-TAU (gjithsej 52 studente, per te dy vitet e PS) jane ne dispozicion kater laboratore, dokument 55_1; 55_2; 55_3 dhe 55_4. Te kater laboratoret jane te pajisur shume mire, me aparatura te kohes dhe funksionale dhe me nje siperfaqe totale prej 225.2 m² (dok.42.1). Rezulton se siperfaqja ne dispozicion per praktika laboratorike dhe procesin kerkimore eshte

4.3 m²/student, nje siperfaqe kjo e mjaftueshme dhe brenda normativave te punes ne laboratore.

Përgjigja e GVJ - Sigurisht që siperfaqja totale dhe m²/student janë dhënë me shifra në standartet më poshtë, por në këtë rast vërejtja është për numrin e studentëve të grupeve të laboratorit. Grupet laboratorike të studentëve që punojnë aty brenda një séance janë me numër të lartë, 20 studentë dhe nuk krijohet mundësia për pjesëmarrjen aktive të tyre” Kjo mund të perceptohet lehtësisht nga vizita e disa prej laboratorëve.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXI - Si është paraqitur në Draft RVJ, Standardi III. 4 Kriteri 7 - Verejtje: Personeli akademik bën perpjekje të vazhdueshme në permiresimin e metodave te mësimdhënies dhe testimin e metodave te reja. Deri tani nuk janë analizuar efektet dhe pritshmerite e tyre në mënyrë periodike në nivel departamenti apo më tej. Dokumenti I dorezuar ne 3.3

Përgjigja e UBT: E vertete, por eshte gjykuar se duhet nje periudhe kohe e caktuar, jo me pak se 3-4 vjet per te testuar metodat e reja te mesimdhënies dhe analizimin e pritshmerive te tyre, te cilat jane duke u zbatuar prej jo me shume se 2 vjetesh.

Përgjigja e GVJ – Institucioni e pranon dhe GVJ nuk bën ndryshim.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXII - Si është paraqitur në Draft RVJ - Vleresimi sipas GVJ i Standardit III.4 eshte “KRYESISHT”

Përgjigja e UBT - Sic mund te shihet, nga 8 kritere qe perbejne Standardin III.4, per 7 kritere GVJ nuk ka paraqitur asnje verejtje. Vihet re vetem ne Kriterin 7 nje verejtje, per te cilen eshte paraqitur obieksioni perkates. Por kjo verejtje e vogel eshte krejtesisht jo relevante ne krahasim me plotesimin e Standardit III.4 ne teresi. Prandaj, mendojme, se edhe ne kete rast GVJ mund te jete nxituar ne vleresimin permbledhes duke e cilesuar ate “Kryesisht”. Faktet e mesiperme tregojne se ky vleresim duhet te kaloje ne “Plotesisht”.

Përgjigja e GVJ - Sqarojmë se GVJ nuk është nxituar dhe as nuk ka bërë lapsus sipas hamendësive të institucionit, por fillimisht vlerësimi është bërë me % dhe më pas u kalua në kategorizimet aktuale (vlerësimi plotësisht ka qënë kur standarti përmbushej 100%). Meqënëse ju e quani vërejtje të vogël dhe jo relevante në krahasim me plotësimin në tërësi, edhe GVJ është dakort që sipas kategorizimit të ri të përdorur në vlerësimin e përmbushjes së standarteve, **Standarti III4 vlerësohet PLOTESISHT.**

GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXIII - Si është paraqitur në Draft RVJ, Standardi III.6, Kriteri 2 - Ne RVJ nuk eshte paraqitur asnje verejtje negative lidhur me plotesimin e ketij kriteri. Dokumentacioni mbeshtetes konstatohet i plote dhe ne perputhje me kriterin.

Përgjigja e GVJ – GVJ mendon se Institucioni është nxituar dhe nuk e ka lexuar mirë RVJ për këtë kriter. Në RVJ shkruhet: *Testimi i studentëve në vlerësimin përfundimtar realizohet me teza të printuara dhe zhvillohet në to ose me fletore të firmosur nga pedagogu. Nga vizita ne institucion, takim me student u konstatua që testimi dhe vlerësimi përfundimtar nuk zhvillohet në*

formë elektronike.

Përgjigja e GVJ - Kriteri kërkon që Institucioni ve në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Siç shihet dhe nga përgjigja në RVJ ky kriter nuk plotësohet.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXIV - Si është paraqitur në Draft RVJ, Standardi III.6, Kriteri 4 - Nga vizita në institucion, e GVJ, takim me studente u konstatua që kontrolli i dijeve nuk zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim Sekretimi I provimeve do të ndihmonte në rritjen e objektivitetit të vlerësimit”

Përgjigja e UBT - *Kontrolli i dijeve me sekretim apo kodifikim nuk është shënuar si metode provimi në Programet e Lendes sipas VKM nr.41, rrjedhimisht nuk mund ta zbatojmë. Provimi me sekretim zakonisht përdoret kur ka numer të konsiderueshem studentesh. Grupet e ketij PS janë me 22-25 studente, pra jo masive.*

Përgjigja e GVJ - VKM nuk e ndalon aplikimin e provimeve me sekretim. Sekretimi nuk ka lidhje me numrin e studentëve që testohen por është një formë për të eliminuar vlerësimin abuziv dhe për të rritur transparencën dhe objektivitetin në vlerësim. Mendojmë që ky kriter nuk përmbushet.

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXV - Si është paraqitur në Draft RVJ -- Vlerësimi i Standardit III.6 sipas GVJ është:
“KRYESISHT”

Përgjigja e UBT - *Sic verëhet perseri, edhe në Standardin III.6 me 9 kritere gjithsej, 8 prej tyre plotësohen pa asnjë vërejtje nga GVJ. Vërejtja e vetme që GVJ ka bërë ndodhet në Kriterin 4 dhe është me tepër një sugjerim, se sa një vërejtje. Rrjedhimisht nuk mund të pranojmë vlerësimin “Kryesisht” për Standardin III.6 dhe me të drejtë pretendojmë vlerësimin “Plotësisht”.*

Përgjigja e GVJ - Në standardin III.6 sipas argumentave më sipër 2 kritere nga 9, nuk përmbushen, Kriteri 2 dhe Kriteri 4 nuk përmbushen. Rrjedhimisht vlerësimi për këtë standart nuk mund të jetë Plotësisht, Vlerësimi mbetet në kategorinë KRYESISHT

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXVI - Si është paraqitur në Draft RVJ - Vlerësimi i Standardit III.7 nga GVJ është:
“KRYESISHT”

Përgjigja e UBT - *Standardi III.7 është vlerësuar pa asnjë vërejtje nga ana e GVJ. Nuk kuptojmë arsien përse është vlerësuar “Kryesisht”. Kërkojmë që vlerësimi të kalojë në “Plotësisht”*



Përgjigja e GVJ – GVJ është dakort me pretendimin e Institucionit në vlerësimin e standardit III.7 Vlerësimi për këtë standart bëhet PLOTESISHT.

GVJ bën ndryshim në RVJ përfundimtar

XXVI - Si është paraqitur në GVJ - Vlerësimi për fushën III është dhënë “Kryesisht”

Përgjigja e UBT - *Sic konstatohet nga shqyrtimi i vlerësimit që GVJ ka bërë mbi Standardin III, vërejtjet e bëra janë të pakta dhe aspak rrelevante për vlerësimin e kriterit në teresi. Shpesh është marrë vlerësimi “Kryesisht” pa shënuar asnjë vërejtje.*

Per keto arsye, lutemi rishikimin e vlerësimit të Standardit III nga “Kryesisht” në



vlerësimin "Plotesisht"

Përgjigja e UBT - Me ndryshimet e bëra në përmbushjen e standarteve III.2, III.4, III.7; konstatohet se nga 8 standarte të fushës III, 7 prej tyre përmbushen sipas vlerësimit Plotesisht dhe një Standard III.6 përmbushet sipas vlerësimit Kryesisht. Mendoj që të japësh vlerësimin "Plotesisht" do të thotë të vlerësohen të gjitha standartet në kategorinë "Plotesisht" 8 me 8. GVJ vlerëson përmbushjen e fushës III me kotegorinë "KRYESISHT"

GVJ nuk bën ndryshim në RVJ përfundimtar

Për sa më sipër Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raporti i Jashtëm dhe firmoset nga Ekspertët e vlerësimit.


Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Agrorshqimore” Profili “Teknologji Agrorshqimore”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Agrorshqimore, profili Teknologji Agrorshqimore (MSH në IUA-TAU), është hartuar në përputhje me interesat kombëtare dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Ky program synon përgatitjen profesionale bazë dhe me metodologji shkencore të studentëve që të jenë të aftë të drejtojnë proceset në industrinë agrorshqimore; të punojnë si inspektorë të ushqimit, specialistë të kontrollit të cilësisë së ushqimit, të zbatojnë sisteme dhe procese teknologjike për prodhimin e produkteve sipas standarteve të tregut dhe eksportit. <i>Dokumenti i dorëzuar 7.1 neni 2; pika d. (Rregullore e programit Msc IAU-TAU).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Mbështetur në objektivat e studimit Programi i Studimit MSH në IAU-TAU synon ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore, duke mbështetur potencialin teknologjik të vendit dhe jep kontribut në sektorët e prodhimit dhe teknologjitë e ushqimit si dhe në zhvillimin ekonomik kombëtar. <i>Dokumenti i dorëzuar 6.1 neni 36.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në Statutin e institucionit, Programi i Studimit MSH në IAU-TAU është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e FBU. Ai pason programin e studimit Bachelor në TAU dhe si i tillë duhet të thellojë më tej studimet dhe formimin shkencor, nëpërmjet moduleve të grup lëndëve inxhinierike duke synuar përgatitjen e specialistëve në Inxhinieri Agrorshqimore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 4 (Strategjia e zhvillimit FBU)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Rritja e numrit të ndërmarrjeve të agropërpunimit, ndërmarrjeve e shërbimit katering, rrjetit të supermarketeve ushqimore, institucioneve shtetërore të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, laboratorëve të kontrollit të ushqimeve, lidhet me nevojën e tregut të punës për specialistë në fushën e teknologjisë ushqimore ku përfshihen edhe të diplomuarit në programin MSH në IAU- TAU. Hartimi dhe realizimi i këtij programi të studimit udhëhiqet nga nevojat e biznesit për t’iu përgjigjur tregut të punës dhe është hartuar në përputhje me zhvillimin e njohurive shkencore, teknologjike për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 16.2</i>

	<p>Programi i studimit MSH në IAU-TAU krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e profesional e shkencor. Cikli i tretë i studimeve ose programet e studimit të doktoratës, hartohen mbi programe individuale për profilizim dhe aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë. Cikli i tretë ka në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese të përvetësuara nga niveli i studimit master.</p> <p><i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1. neni 44;</i> <i>Dokumenti i dorëzuar nr 64 neni 4.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.2	
Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Hartimi i programit të studimit të Ciklit të Dytë MSH në IAU-TAU, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit dhe në përputhje me parimet e deklaratës së Bolonjës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 3 pika 4; Dokumenti i dorëzuar nr 3.3 pika 3.1; 4.1.</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Mbështetur në Statutin e FBU që ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat e agropërpunimit dhe ushqimit, drejtime që përcaktohen specifikisht edhe në Rregulloren e Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, Programi i Studimit fokusohet në fushën e zhvillimit rural dhe të politikave agrare. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 2 dhe 6; dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 2.</i>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit IAU-TAU ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Ky Program Studimi konsiderohet një vazhdim i programit me të njëjtin emër në Ciklin e Parë të studimeve Bachelor, hapja e tij është bërë në zbatim të Rregullores së UBT për hapjen e programeve të reja, neni 18 si dhe në Rregulloren e FBU, Dokumenti i dorëzuar 6.1 neni 38; (ne RVB i referohet neni 22 që është e gabuar) është aprovuar nga Këshilli i Akreditimit me vendimin dt. 26.08.2008; Dokumenti i dorëzuar nr 16.1 dhe me Urdhërin e MAS për hapjen e këtij programi studimi, dt. 03.09.2008. GVJ mbështetur në kurrikulën e vitit 2018-2019 të programit të studimit, (dhe atyre të mëparëshme) mendon që emërtimi i këtij





	<p>programi studimi, i cili pasqyron më mirë përmbajtjen është Master i Shkencave në “Teknologji Agroushqimore”; duke pasur parasysh që numri i moduleve me karakter inxhinierik në raport me numrin total të moduleve që zhvillohen në program është 3:14. Për këtë arsye, GVJ mendon dhe rekomandon që Departamenti duhet të bëjë përmirësime të kurrikulës në këtë drejtim duke përfshirë më shumë module të grup lëndëve inxhinierike, meqënëse programi i studimit është i nivelit të dytë “Master i Shkencave” në vijim të programit të studimit Bachelor me të njëjtin titull. Kështu justifikohen dhe studime të thelluara në Inxhinieri Agroushqimore.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit, struktura dhe përmbajtja e tij synon formimin e thelluar të profesionistëve të përshtirë në procesin e transformimit të ushqimit, duke iu përmbajtur fushës së studimeve dhe drejtimeve akademike në FBU, të cilat janë nëpërputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesat kombëtare dhe prirjet globale të zhvillimit.</p> <p><i>Dokumenti i dorëzuar 3.3 pika 1</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>✓</p>

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MSH në IAU-TAU ka objektiva të mirë përcaktuara për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Këto janë përshkruar qartë në secilën nga modulet e programit (të paraqitur sipas kritereve të VKM nr.41) në seksionin” rezultatet e të nxënir” (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.2</i>) dhe karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve (Cikli i dytë) dhe me kërkesat e tregut të punës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 18</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe</p>	<p>FBU ka ndërmarrë studime të tregut të punës që lidhet me të diplomuarit për programin e studimit, mbështetur dhe në Ligjin e Ushqimit i cili nënkupton si detyrim ligjor punësimin pranë ndërmarjeve të specialistëve të agropërpunimit, ku të diplomuarit në këtë program shikohen si një potencial kryesor. Institucioni ka krijuar marrëdhënie me bizneset e fushës nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve për kryerjen e praktikave profesionale dhe nëpërmjet komunikimit zyrtar me punëdhënësit për nevojat e tyre krijon mundësitë e punësimit të</p>

<p>zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>studentëve. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 16.2.</i> Studentët e diplomuar plotësojnë pranë Zyrës së Karrierës skedën e punësimit, (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 17</i>) duke dhënë informacione në lidhje me punësimin aktual për të vijuar gjurmimin e punësimit në 5 vitet e ardhëshme. Kështu, nga komunikimi i vazhdueshëm që Zyra e Karrierës në FBU ka me operatorët e biznesit, në kuadër të Panairëve të Karrierës që UBT organizon çdo vit, por edhe në kuadër të marrveshjeve që FBU ka me operatorë bisnezi (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 34.1;32.</i>) kryhet studimi periodik i tregut të punës. Nga të dhënat e kësaj Zyre dhe statistikave që disponohen, në 5 vitet e fundit, punësimi i të diplomuarëve në MSH në IAU-TAU (sipas të dhënave dhe të raportit të analizës vjetore të punës mësimore-kërkimore dhe <i>Dokumenti i dorëzuar nr 18</i>) është rreth 64% teknolog agropërpunimi, 28% në shërbime restorante dhe në profesionë të tjera; 8% të papunë. (numri i studentëve që ndjekin vitin e dytë të këtij programi studimi nuk është shumë i lartë, 22 studentë, po kaq janë dhe në vitin e parë)</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathëtsive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 2</i> dhe në çdo syllabus të moduleve janë të përcaktuara objektivat formues të programit të studimit MSH në IAU/TAU. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.2</i> (model syllabus sipas VKM nr 41 shtojca 2) dhe <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.7</i> ku janë gjithë syllabuset e PS. Ato garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shprehive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit MSH në IAU-TAU përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare. Aktualisht, UBT zhvillon dy programe Erasmus+ me Universitetin e Molisë dhe Universitetin e Milanos, në Itali. Nga krahasimi i kurrikulave rezulton ngjashmëri midis programeve të studimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.7</i> Reth 70% e lëndëve në FBU (10 module), janë pothuajse të njëjta me lëndët që zhvillohen në të njëjtin program studimi në Universitetin e Molise-s; (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14 -10.1</i>) pjesa tjetër 30% e lëndëve (4 module) nuk zhvillohen në U. MOLISE. (ky program përmban 13 module, 1 më pak se në FBU). Nga krahasimi FBU-U. MILANOS (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14-10.2</i>) rezulton se numri i lëndëve të MSH në IAU-TAU është gjithsej 14, ndërsa në U. Milanos numri i lëndëve është 12 plus 3 lëndë me zgjedhje nga një listë prej 10 module. Përmbajtja e 7 moduleve të U. Milanos ka përputhshmëri të lartë me programet e lëndëve përkatëse në FBU. Kjo ka bërë të mundur një mobilitet të studentëve shqiptarë drejt këtyre universiteteve, për shkëmbim kreditesh - ECT për një periudhë studimi një ose dy semestra, si dhe për</p>

	<p>realizim tema diplome të përbashkëta. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.2; 35.3</i></p> <p>Sipas dokumentave të paraqitura, duhet të cilësojmë se të dy Programet e Studimit, kurrikulat e të cilëve referohen për ngjashmëri me Programin MSH në IAU-TAU, emërtohen Master Shkencor “Teknologji Ushqimore”. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14-10.1 dhe 14-10.2</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit që u krijua fillimisht 1992 si Seksioni i Teknologjisë Ushqimore në varësi të Fakultetit të Agronomisë. Me Urdhër të MASH 1998, pranë Fakultetit të Bujqësisë të UBT krijohet “Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore” dhe Kursi i Studimit “Teknolog ushqimor” me kohëzgjatje 4.5 vjet. Kurrikula e këtij programi u ngrit nga bashkëpunimi në kuadrin e një Projekti TEMPUS disa vjeçar me Universitetin e Bujqësisë dhe Teknologjisë Ushqimore, Universitetin e Hohenheim, Shtutgart Gjermani. Në vitin akademik 2005-2006, pranë DTA të Fakultetit të Bujqësisë, në kuadrin e reformës në Arsimin e Lartë në UBT, sipas sistemit 3+2 të Bolonjës, kurset e studimit 4.5 vjet në Teknologji Ushqimore, u cilësuan 3 vjet studime në Inxhinieri Agroushqimore, me dy profile: a. Teknologji Agroushqimore b. Vreshtari-enologji. Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë kursi i studimit në Inxhinieri Agroushqimore u emërtua “Cikli I i Studimeve-Bachelor” dhe u propozua i njëjti kurs studimi për “Ciklin e II, Master i Shkencave” në vitin akademik 2008-2009. Plani strategjik i UBT ndërthur vizionin për Arsimin e Lartë me kontributet që burojnë nga procesi i Bolonjës, për integrimin në rrjetin rajonal, europian të arsimit të lartë bujqësor. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 3 pika 1 dhe 2.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit MSH ka parashikuar 30 kredite nga 120 gjithësej për përgatitjen e Tezës së Diplomës Master, gjatë semestrit të katërt. Kjo siguron aftësimin profesional me qëllim arritjen e objektivave të formimit të programit, me një numër orësh gjithësej 300. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7_1.</i> FBU ka krijuar të gjitha kushtet për punë kërkimore shkencore në kuadër të Tezës së Diplomës, duke vënë në dispozicion 4 laboratorë shkencorë dhe 5 linja pilot prodhimi teknologjik. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 60 dhe 55.</i> Për kryerjen e punimeve të tezave Master studentët bashkëpunojnë edhe me operatorët e biznesit apo institucione të ndryshme, (lidhjet me të cilët sigurohen në mënyrë individuale por/edhe mbështeten nga fakulteti) gjë që zhvillon më tej aftësimin e tyre profesional. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.1</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”,</p>	<p>Programi i studimit MSH në IAU profili TAU zhvillohet në gjuhën shqipe meqënëse dhe studentët janë shqipfolës të vendit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al21

duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	dhe nga trojet. Stafi mendon dhe ka planifikuar për tu përgatitur në gjuhë të huaj (anglisht) dy module nga lënda “Metodologji e Kërkimit Shkencor” dhe një modul nga lënda “Toksikologjia e ushqimeve”, për vitin akademik 2019-2020, me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të institucionit..			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Aktualisht departamenti ka arkivuar në gjuhën angleze dokumentacionin: CV akademike të pedagogëve, Programe të lëndës sipas formatit VKM nr.41, Lista studentësh në programe shkëmbimi Erasmus, dhe disa Plane kalendarë për modulet e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit MSH në IAU profili “Teknologji Agroushqimore” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore bazë, realizohet pranë FBU dhe Departamenti i Teknologjise Agroushqimore, është përgjegjës për zbatimin e këtij programi. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 6.</i> Stafi akademik që realizon programin e studimit ka një personel prej 16 vetësh, ndër të cilët: 5 janë Prof.Dr, 2 janë Prof.Asc, 6 Dr Shkencash dhe 3 Msc Shkencore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 24.1.</i> Dy prej stafit akademik janë të ftuar: Prof. Dr.V. M dhe Ing.Msc.N. T. – teknolog bulmeti me një përvojë 40 vjeçare pune. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 59.</i> Në funksion të përmbushjes së programit të studimit, janë angazhuar edhe 6 pjestarë nga stafi akademik ndihmës, me përvojë dhe kualifikimin e duhur për të asistuar seancat mësimore e laboratorike, por edhe për të mbështetur punën kërkimore shkencore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 22.1.2.3.</i> Stafi akademik bën përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e tij. Stafi akademik ka marrë pjesë në Projekte të ndryshme: IPA, ERASMUS, Horizon 2020; në konferenca, kongrese, trajnime brenda dhe jashtë vendit, me qëllim thellimin e nivelit të njohurive dhe aplikimit të tyre në këtë program studimi. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.6</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSH në IAU, profili TAU është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, DTA përgjegjëse për programin e studimit. Fusha e studimit të programit të

studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

studimit lidhet me modifikimin e ushqimeve me origjinë bimore e shtazore, kontrollin e cilësisë në proceset teknologjike të krijimit, manipulimit, transformimit, ambalazhimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve ushqimore. Garantimin e cilësisë së proceseve dhe produkteve, me anën e zbatimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë dhe administrimit të saj. Kodifikimi i programit të studimit të ciklit MSH në IAU profili “Teknologji Agroushqimore” duhet të bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Dokumenti i dorëzuar nr 36 Neni 86, pika 1.

Në RVB cilësohet: “*kemi informacion që UBT ka bërë kërkesën pranë MAS për kodifikimin e Programeve të Studimit, por nuk ka marrë ende një konfirmim të këtij kodifikimi*”.

Emërtimi i programit të studimit bëhet me dy emra, kjo sqarohet në një dokument, tabelë e gjithë programeve të studimit që UBT ofron e manaxhon. Programet klasifikohen sipas fushës së studimit (Inxhinieri Agroushqimore), profilit (Teknologji Agroushqimore) dhe kategorisë Bachelor ose Master (professional/shkencor). Dokumenti i dorëzuar nr 26. Në fakt, mendoj që fusha e studimit është më e gjërë se profili i studimit, sipas kësaj llogjike programi duhet të emërohet: MSC Teknologji Agroushqimore profili Inxhinieri Agroushqimore. Unë mendoj që programet të emërtohen thjeshtë, me një emërtim dhe jo me dy siç emërtohet nga institucioni (në rastin e këtij programi: Master Shkencor në Inxhinieri Agroushqimore me profil Teknologji Agroushqimore); ose më thjeshtë. Mendojmë se është më mirë që programi i studimit në fjalë të emërohet thjesht Master Shkencor në “Inxhinieri Agroushqimore”, meqenëse është i nivelit master dy vjet, pra studime të thelluara dhe të profilizuara dhe paraprihet nga PS bachelor ne Teknologji Agroushqimore. Për të mbajtur këtë emërtim Master Shkencor në “Inxhinieri Agroushqimore”, rekomandojmë të shikohet dhe të përmirësohet kurrikula me module të grup lëndëve inxhinierike.


Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje

Njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e Programit të studimit MSH në IAU, profili TAU, është Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore. Ky Departament është përgjegjës edhe për 5 programe të tjera studimi: Bachelor në IAU, profili TAU; Bachelor në IUA profili VE; Master Shkencor në IAU, profili Teknologji Pijesh; Master Profesional “Cilesia dhe Siguria Ushqimore. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MSH në IAU, Profili TAU është nëpërputhje me fushën akademike dhe kërkimore të DTAU: Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 38

Lëndët ndërdisiplinore të Programit të studimit MSH në IAU-TAU sigurohen nëpërmjet njësisë bazë bashkëpunuese, siç është Departamenti i Kimisë dhe Departamenti i Shkencave të

	Ushqimit dhe Bioteknologjisë. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1</i> Dokument me nr 6 rregullore e DTAU është vetëm faqja e parë. Është kërkuar kodifikimi i Programit të Studimit nga MAS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		✓		

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Me mbikëqyrjen, mbarëvajtjen e programit të studimit MSH në IAU në profilin “Teknologji Agroushqimore”, është i ngarkuar përgjegjësi i Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, detyrat dhe kompetencat e të cilit janë të përcaktuara në Rregulloren e DTAU. Në RVB i referohet dokumentit nr 6, ky dokumentet mungon është vetëm faqja e parë. Në përbërje të këtij Departamenti janë grupet mësimore e kërkimore (GMK). Krijimi dhe organizimi i tyre bëhet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të Departamentit (mbi bazën e akteve të miratuara në strukturat eprore) dhe me miratim të Dekanit të FBU. GMK në DTA janë dy: a. GMK i Teknologjisë Agroushqimore; b. GMK i Inxhinierisë së Proceseve të Përpunimit të Ushqimeve. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.3 dhe 43.5.</i> Veprimtaria e GMK-ve monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga Përgjegjësi i DTA dhe një herë në vit kryhet analiza e punës mësimore e kërkimore e tyre. Këto dy analiza vjetore ju percillen përkatësisht Z/Dekanit për mësimin dhe atij për shkencën e kërkimin. Z/Dekanët përgatisin dhe paraqesin në mbledhjen e Dekanatit përkatësisht analizën mësimore dhe analizën kërkimore për vitin përkatës. Pas miratimit në Dekanat, këto analiza diskutohen në Asamblenë e Fakultetit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 37.1; 37.3</i> Për realizimin e Programit Mësimor të këtij Programi Studimi, DTA bashkëpunon në mësimdhënie dhe kërkim shkencor edhe me pedagogë nga Departamente të tjera.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Që nga themelimi i FBU ka zhvilluar një lidhje shumë të ngushtë me Universitetet partnere si: Universiteti Shtetëror i Tetovës. Krijimi i kurseve të studimit dhe kurikulave përkatëse ka qënë rezultat i bashkëpunimit me profesorë të departamenteve homologe të universiteteve gjermane (Hohenheim University, Stuttgart; dhe italiane (Universita degli Studi di Tuchsia, Viterbo). FBU ka marrëveshje afatgjata bashkëpunimi dhe projekte të përbashkëta me disa nga këto Universitete. Me disa prej tyre janë realizuar shkëmbime pedagogësh. <i>(Dokumenti i dorëzuar nr 43.2)</i>



	vizita studentësh, konsultime për lëndë dhe botime të ndryshme, konferenca të përbashkëta shkencore.			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” në IAU profili TAU, FBU ka marrëveshje me 16 institucione kërkimore, kompani të fushës (10 operatore biznesi) për realizimin e vizitave, intershipeve, praktikave profesionale, zhvillimin e punimit të temave të diplomës pranë disa prej këtyre institucioneve. Marrëveshjet janë lidhur në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore, punimit të temave të diplomave organizimin e trajnimeve. etj. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 32-1.2 ;</i>			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Programi Studimit “Master i Shkencave” në IAU, profili TAU nuk ka të parashikuar praktika profesionale. Këto të fundit janë pjesë e detyruar e programit studimit të Ciklit të Parë Bachelor. FBU mbajnë lidhje të ngushta me institucionet e specializuara të fushës apo operatorët e biznesit për të forcuar bashkëpunimin në drejtimin e punimeve të përbashkëta të tezave të Diplomave Master, si dhe në kontaktimin e herëpashershëm të tyre, me qëllim studimin dhe nxitjen e tregut të punës për të diplomuarit në këtë program. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 16.2</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	FBU ka si prioritet të punës së tij bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim mobilitetin e personelit dhe studentëve. Është përfshirë në bashkëpunime kërkimore-shkencore, shkëmbimi reciprok apo ngritje/ forcim kapacitetesh, nëpërmjet projekteve ndërkombëtare me institucione të rëndësishme të Europës. Në këtë kuadër, ka patur një mobilitet të konsiderueshëm të stafit akademik dhe studentëve. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.2.</i> FBU është i angazhuar në projekte evropiane, IPA, FP7, Erasmus Mundus, Erasmus +, projekti STEPS që të zbatojë një program modern në lidhje me "Sistemet e Prodhimit të Qëndrueshëm të Ushqimit "; Projekti NETCHEM. Programi për Mbështetje Zhvillimore të Republikës Sllovaqe në Fushën e përbërjes ushqimore për Evropën Qendrore dhe Lindore" Në kuadër të këtij projekti janë realizuar lëvizje jashtë shtetit për trajnime dhe vazhdon puna për plotësimin e të dhënave sipas programit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.4</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Arritjet mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, raportohen rregullisht në analizën mësimore dhe analizën kërkimore shkencore që departamenti DTA kryen në fund të çdo viti kalendarik. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 38.1 dhe 38.2.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.6


Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UBT publikon revistën shkencore AJAS (Albanian Journal of Agricultural Sciences ISSN: 2218-2020) e cila është ndërkombëtare, me akses të hapur që publikohet çdo tre muaj nga UBT. Qëllimi i revistës është të sigurojë publikimin e kërkimeve origjinale për spektrin e plotë të shkencave biologjike dhe atyre bujqësore. Fushat e botimit përfshijnë: Shkencat Bujqësore dhe mjedisore, Mjekësia Vetërinare, Bioteknologjia dhe Ushqimi, Ekonomia dhe Agrobiznesi dhe Shkencat Pyjore. Në vitin 2015 Revista AJAS ka rritur Global Impact Factor 0.987; Index Copernicus 74.51; indexi ISRA JIF (2016) 3.832; Scientific Journal Impakt Factor value 4.24 dhe Universal Impact Factor (2013)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Personi i ngarkuar me detyra dhe kompetenca në ndjekje të veprimtarisë kërkimore shkencore në fakultet është Z/Dekani për shkencën, detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen në Statutin e UBT dhe në Rregulloren e Studimeve të FBU. Dokumenti i dorëzuar nr 5 neni 14. Njëkohësisht në FBU zv/dekani për mësimin kryen edhe detyrën e Drejtorit të Shkollës së Doktoraturës. Ai kujdeset për veprimtarinë kërkimore, botuese të studentëve të ciklit të tretë dhe manaxhimin e karrierës në fakultet. Dokumenti i dorëzuar nr 5 neni 14 dhe nr 6.1</p> <p>Pranë FBU është ngritur dhe funksionon Komisioni i cili shqyrton dhe përcakton procedurën për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor i Shkencave”. Ky komision është i përbërë nga shtatë anëtarë, të cilët bëjnë pjesë në asamblenë akademike të FBU dhe i përkasin kategorisë Profesor”. Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 12 Detyrat dhe funksionimi i Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore Doktor përcaktohen në statutin e UBT. Dokumenti i dorëzuar nr 2 neni 16.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>UBT publikon revistën AJAS ku në shumicën e rasteve publikohen arritjet në kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve. Njëkohësisht Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor nëpërmjet organizimit të Konferencave Ndërkombëtare pranë UBT që shërben për kërkuesit e rinj për të promovuar rezultatet e kërkimeve të tyre. Vitet e fundit janë organizuar një numër konferencash: 2014 1st International Conference “Biotechnology in Agriculture” Numri i pjesëmarrjeve dhe botimeve në tre vitet e fundit nga stafi i DTA që ofron këtë PS, në konferenca, kongrese, simpoziume shkencore për vitin 2017-2018 është 9 gjithësej, 6 brenda vendit dhe 3 jashtë. Dokumenti i dorëzuar nr 38.2 dhe nr 37.2.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site:


E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al26





<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Kërkimi shkencor në UBT realizohet në përputhje me parimet universale të kodit etik të shkencëtarit. UBT nxit debatin aktiv për ndërgjegjësimin e kërkuesve për impaktet që kanë studimet e tyre dhe mundëson komunikimin midis tyre dhe publikut për sfida të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. UBT ndëshkon praktikat korruptive të konfliktit të interesit në kërkimin shkencor dhe të plagjiaturës në kërkim dhe publikimin e rezultateve të kërkimit, kjo sipas statutit UBT <i>Dokumenti i dorëzuar nr 2. Dokumenti i dorëzuar nr 2, neni 62.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për marrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor nëpërmjet projektit INTERREG Balkan-Mediterranean 2014 2020 IPA. "Balkan ideas network for sustainable innovations in the agro-food sector -balkanet", me fonde te EU Project Number: CCI 2014TC16M4TN003. Në kuadër të këtij projekti, pas thirrjes që iu bë studentëve, do të zhvillohet një workshop, ku studentët do të paraqesin idetë e tyre inovative për produkte të reja ushqimore. DTA është pjestar në 5 projekte ndërkombëtare, ku mundohet të aktivizojë dhe studentët e masterit, nëpërmjet mobilitetit në periudha të caktuara. <i>Sipas dokumenti i dorëzuar nr 43.8.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	




**II ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE**

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit në ciklin e dytë, Master Shkencor në IAU, profili TAU është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite dhe realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi referuar Ligjit të Arsimit të Lartë (Dokumenti i dorëzuar nr 36 neni 70,75.) si dhe sistemit të llogaritjes së krediteve, sipas VKM nr.41(Dokumenti i dorëzuar nr 14.2 pika 2.1.) Numri total i krediteve në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave është 120, bazuar në Rregulloren e FBU dhe Rregullores së Studimeve MSH në IAU, Profili TAU. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 37 dhe nr 7.1).</i> Kreditet e lëndëve janë të paraqitura në çdo syllabus, sipas VKM nr. 41 <i>Dokumenti i dorëzuar nr14.2 shtojca A</i> dhe e përmbledhur në kurrikulën e çdo viti si dhe në Planin mësimor të detajuar në orë/kredite. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.2 ; 14.7</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>PS i ciklit të dytë në Master i Shkencave në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Agroushqimore synon përgatitjen e specialistëve me njohuri të avancuara teknologjike agroushqimore, specialistë për ushqimin dhe sigurinë ushqimore, të aftë të kontribuojnë në të gjitha etapat e zinxhirit ushqimor. Ai synon përgatitjen e duhur profesionale bazë dhe një metodologji shkencore për zgjidhjen e problemeve teknike dhe shkencore. Studenti do të jetë i aftë të organizojnë proceset dhe të drejtojë projekte të kërkimit dhe zhvillimit në industrinë agroushqimore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 2.</i> Gjithashtu studenti i cili përfundon këtë Master të Shkencave duhet të këtë aftësi projektimi dhe zbatimi në sisteme dhe procese teknologjike për prodhimin e produkteve sipas standarteve të tregut dhe të eksportit. GVJ mendon se duhet të përmirësohet kurrikula me lëndë që japin këtë formim. Aftësitë e duhura profesionale që fitohen në përfundimin e çdo moduli të ofruar në programin studimit të ciklit të dytë shprehen në syllabusin e depozituar nga çdo pedagog i modulit në departament. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.5.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>PS Master i Shkencave ka përmbajtje që u ofron studentëve njohuri të thelluara teorike, si edhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar për të ndjekur ciklet e tjera të studimit. Njëkohësisht u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 37/1.</i></p>




	<p>Të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës mbështeten në veprimtaritë formuese të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mësim në auditor: si leksione, seminare, ushtrime, laboratore, - forma të kontrollit të vazhdueshëm, dhe - seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në impiantet pilot. <p>Gjithashtu studimi individual, punim detyrash apo projektshesh kursi; veprimtari të tjera, si praktika mësimore në subjekte nëpërmjet vizitave dhe punimi në mënyrë të pavarur i diplomës. Të gjitha këto veprimtari janë të shprehura në programin mësimor të çdo disiplinë të programit të studimit, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.5.</i> në Planet mësimore (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8.</i> dhe ato kalendarike.(në RVB thuhet se është dokumenti nr 54.1 por konstatohet se ky nuk është dorëzuar on line).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi studimit siguron formim, njohuri, aftësi dhe kompetenca të karakterit specifik me të thelluara dhe analitike duke nisur nga prodhimi i lëndëve të para me origjinë bimore e shtazore, përpunimi pas korrjes, vjeljes, mjeljes, therrjes, transformimet e lëndëve të para në produkte ushqimore, ambalazhimi, ruajtja, shpërndarja dhe tregtimi i tyre, teknologji të manipulimit, transformimit, ruajtjes dhe një sistem i administrimit të cilësisë së ushqimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Dokumenti kryesor i programit të studimit në ciklin e dytë, është plani mësimor hartuar sipas akteve ligjore e nënligjore të LAL. Plani mësimor (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8</i>) përbën dokumentacionin kryesor informativ ku jepen në mënyrë të përmbledhur: Emërtimi i programit të studimit, kohëzgjatja normale e studimeve sipas Rregullores se studimeve Master; modulet e zhvilluara në kurset përkatëse të studimit, me ngarkesën duke paraqitur edhe numrin e krediteve, orët mësimore sipas veprimtarive formuese (disiplinave) të grupuara në semestra dhe të renditura sipas semestrave, (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj.), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor. Karakteristikat e tezës së diplomës Master i Shkencave dhe Diploma me suplementin. Numri total i krediteve në programin e ciklit të dytë të studimeve është i shpërndarë sipas veprimtarive formuese, të kërkuara nga VKM Nr. 41, shtojca A, e cila shpreh qartë përqindjen që duhet të zërë specifikisht çdo veprimtari formuese sipas topologjisë.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara ose tipologjia me % përkatëse sipas krediteve. Kështu, në programin e studimit MSH në IAU profil TAU, përqindja totale e lëndëve të kategorive bazë, tipologjia A është 10%; e lëndëve karakterizuese tipologjia B është 55%; e lëndëve interdisiplinore tipologjia C është 10%, dhe diploma D është 25% (<i>Dokumenti i dorëzuar nr</i></p>

	14.9.) Vërehet se të gjitha veprimtaritë formuese janë në përputhje me VKM Nr 41/ 2018, për programet e ciklit të dytë. Sipas kurrikulës për vitin akademik 2018-2019, (Dokumenti i dorëzuar nr 14.1). lëndët e tipologjisë B në këtë PS janë 60%.			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Në programin e studimit, Master i Shkencave, janë të përcaktuara orët dhe kreditet që lidhen me temën e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të saj. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 41.</i> Kreditet e përcaktuara për punimin e temës së diplomës janë 30 dhe realizohen në semestrin e dytë, parashikuar 300 orë. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.1.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Sukursuesit përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				✓

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	FBU është i organizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë». <i>Dokumenti i dorëzuar nr 57 neni 23/3.</i> Në përputhje me Statutin e UBT, (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 2 neni 25.1c</i>); FBU funksionon dhe realizon misionin e tij duke u mbështetur në aktivitetin mësimor dhe kërkimor të katër njësive bazë të ligjshme, të ngritura pranë tij: Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore, Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, Departamenti i Kimisë, Qendra e Kërkimeve të Ushqimit.(kjo sipas RVB Dokumenti i dorëzuar nr 3.3) Struktura organizative e FBU propozohet nga Fakulteti, rishikohet dhe miratohet nga Rektorati dhe nga Senati i UBT. Dokumenti i dorëzuar nr 2 neni 6.. UBT ka marrë konfirmimin nga ASCAL për vlerësimin në kuadër të akreditimit të Programit të Studimit Master i Shkencave në IAU Profili TAU (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 1.2</i>) dhe ka paguar detyrimin financiar për këtë shërbim. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 1.3</i>)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njesia bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH në IAU profili TAU, është Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore. Ky Departament përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, pasi ka në përbërje të tij 9 (nëntë) lektorë të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, Departamenti ka në përberje dhe 4 (katër) anëtarë personel ndihmës akademik. Kjo sipas ligjit 80/2015, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 57 neni 25/4; dhe dokumentave 23.2; 23.3 dhe nr 24.</i>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>DTA, përgjegjëse për Programin e studimit të ciklit të dytë MSH në IAU profili TAU, përmbush detyrimet ligjore duke qenë se ka në përberje të stafit të saj 9 (nëntë) anëtarë, ku 1 (një) është Prof.Dr, 2 (dy) janë Prof.As, 4 (katër) janë Doktorë Shkencash dhe 2 (dy) mbajnë gradën Msc, ndër të cilët njëri është në përfundim për mbrojtjen e gradës Doktor i Shkencave. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 23.2 dhe 24.</i> Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, në ciklin e dytë të studimeve japin mësim dhe 2 (dy) pedagogë të ftuar, (njëri prej të cilëve është Prof.Dr dhe tjetri inxhinier prodhimi me experiencë të gjatë në fushën e bulmetit); emrat e tyre figurojnë në listën e pedagogëve të jashtëm të miratuar për këtë vit akademik 2018-2019. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 59, lista e pedagogëve i miratuar të ftuar ne UBT.</i></p> <p>Nga vizita e GVJ pranë institucionit, takimi me studentët, e programit master u konstatua që lënda e PS: “Inxhinieria e përpunimit të ushqimeve” nuk zhvillohet nga staf i brendëshëm përgjegjës i lëndës, sipas përcaktimit në syllabusin përkatës. Ky modul zhvillohet nga pedagog staf akademik i jashtëm emri i të cilit nuk figuron në listën e miratuar të pedagogëve të jashtëm për këtë vit akademik (verifikuar edhe në zyrën e burimeve njerëzore). Leksionet e këtij moduli nuk zhvillohen në ambientet e FBU, studentët zhvillojnë leksionet në ambientet e FSHN –UT.</p> <p>Raporti personel me kohë të plotë/pedagogë të ftuar është 14:3 Staf i akademik bën përpjekje për ngritjen e tij profesionale, nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm, marrjes së titujve e gradave dhe kërkimit shkencor. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.1;43.2;43.6).</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ për këtë kriter është shprehur në Kriterin 2, pasi është njësoj. Përsëritet</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MSH në IAU-TAU, është Departamenti i Teknologjise Agroushqimore. Ky Departament përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, pasi ka në përberje te tij 9 (nëntë) lektorë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët 3 (tre) lektorë janë kategoria “Profesor”, (1 (një) me titull “Professor”, 2 (dy) me titull “Professor i Asociuar) 4 (katër) kanë gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe 2 (dy) asistentë lektorë kanë gradën Msc. Departamenti ka në përbërje dhe 4 (katër) anëtarë personel ndihmës akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>DTA përgjegjëse për programin e studimit MSH në IAU-TAU angazhon 6 (gjashtë) personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, projekteve studimore e temave kërkimore të Diplomës Master. Personeli ndihmës akademik mban titullin Master i Shkencave apo Master Profesional, ka experiencën dhe ekspertizën e duhur për të mbështetur aktivitetin eksperimental dhe studimor të studentëve. <i>Dokumenti i dorëzuar</i></p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al31



	<i>nr 22.3;22.1 ;22.2. Personeli ndihmës akademik funksionon sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në Rregulloren e FBU, Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 98.</i>			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në programin Master i Shkencave, Koordinatori i Programit është në të njëjtën kohë Përgjegjës Departamenti që organizon dhe zhvillon Programin e studimit. Koordinatori i programit Master i Shkencave mban titullin Prof. Asc në përputhje me kërkesat e LAL Dokumenti i dorëzuar nr 57 neni 45, pika 3 dhe ka detyra të mirë specifikuar në përputhje me rregulloren e FBU Dokumenti i dorëzuar nr 6.1. neni 16. Ai është përgjegjës edhe për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Dokumenti i dorëzuar nr 30.2 vendimi për rezultatet e zgjedhjeve në UBT-FBU, tregon për emerimet sipas këtyre rezultateve të dekanit dhe përgjegjës departamenti.			
Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit, për çdo fund viti akademik harton Raportin e Analizës Mësimore, Raportin e Analizës Kërkimore në DTA, Raportin mbi indikatorët e cilësisë në kërkim si dhe Raportin e Performancës. Në këto raporte janë paraqitur problematikat që janë shfaqur në programet e studimit që mbulon Departamenti, pra edhe për Programin e studimit i MSH në IAU profili TAU. Paraqiten analiza, evidentime dhe përmirësime në programet dhe planet mësimore të programeve të studimit duke synuar një përmirësim të vazhdueshëm. Janë evidente ndryshimet që janë bërë në katër vitet e fundit në kurrikulën e PS jo më shumë se 20%, çdo vit të cilat propozohen nga departamenti, miratohen nga Dekanati dhe senati akademik i UBT. Dokumenti i dorëzuar nr 52.2; 52.3;52.4.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		✓		

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, DTA është mbështetur në VKM Nr 41, datë 24.01.2018, pika 2.6. Ajo disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Tërësia e veprimeve formuese shprehet në planin mësimor. Në planin mësimor të programit të studimit të ciklit të dytë MSH në IUA profili TAU janë përcaktuar: (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8.</i>) - lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, të vendosura në vite e semestra me





	<p>kreditet përkatëse. Shpërndarja e krediteve sipas elementëve të tipologjisë didaktike për çdo modul është treguar për çdo disiplinë dhe pasqyrohen edhe në programet e lëndëve (syllabus). Veprimtaritë formuese të programit të studimit të ciklit të dytë MSH në IAU-TAU janë në përputhje me specifikimet në planin mësimor dhe me Rregulloren e FBU, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1. neni 23.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. VKM nr. 41/2018, Pika 2.3, programi i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në IAU profili TAU është i organizuar në lëndë, module, aktivitete formuese dhe Diploma, të cilat pasqyrohen te Plani Mësimor. Ato paraqiten qartë në sylabuset përkatëse të lëndëve ndërsa planet calendar nuk gjenden në dokumentat e dorëzuar; nëRVB ato referohen si dokument nr 54</p> <p>Objektivat formuese, përcaktues dhe specifike, janë të përcaktuar në Rregulloren e PS, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1. neni 2</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë në Master Shkencor në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Agroushqimore është i organizuar në 14 lëndë ose module të cilat janë vlerësuar në total me 90 kredite ECTS, të ndara në tre semestra. Çdo semester ka 30 kredite. Në semestrin e katërt përgatitet Tema e Diplomës, e cila përmban 30 kredite. (300 orë) Në total PS ka 120 ECTS (1200 orë mësimore gjithësej) Lëndët janë të ndara në % në bazë të tipologjisë (A,B,C,D) të përcaktuara nga VKM nr.41, shtojca A <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.9</i>) Në programin e studimit lëndët bazë(A) zënë 10%; lëndët karakterizuese B, zënë 60%; lëndët ndërsiplinore C, zënë 10% dhe lëndët plotësuese D dhe detyrime përmbyllëse, zënë 20 %, duke ju përafuar limitet e vendosura në VKM nr.41/2018. Këto të dhena janë të paraqitura në Planin mësimor, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8. dhe Syllabuset e lëndëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Sipas VKM nr. 41/ 2018: Pikat 2.1, 2.2, 2.6, plani mësimor, përbën një nga dokumentat më të rëndësishëm që karakterizojnë programin e studimit. Në këto plane mësimore paraqiten edhe orët mësimore sipas veprimtarisë formuese: leksione, seminare, ushtrime, praktika laboratorike; detyrimet e modulit, periudha dhe mënyra e kontrollit të dijeve, vlerësimi i studentit si dhe mënyra e zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p>Në planin mësimor 2018-2019, të PS MSC IAU-TAU, Dokumenti i dorëzuar nr 14.8.3 në lidhje me këto informacione ka paqartësi. Ngarkesa mësimore e moduleve ndahet vetëm në dy zëra: orë leksion dhe seminare. Nga vizita e GVJ në DTA u konstatua që disa module të programit zhvillojnë edhe seanca praktike laboratorike, por ato nuk pasqyrohen as në planin mësimor as edhe në sylabuset e lëndëve përkatëse. Mendojmë</p>

	<p>që në planin mësimor duhet të jepet informacion për peshën që zënë në ngarkesën javore seancat laboratorike, dhe të specifikohet ngarkesa sipas tre zërave: orë leksion: orë seminar/ushtrime: orë laboratore. Gjithashtu kjo duhet të pasqyrohet paralelisht në syllabuset përkatëse të lëndëve që zhvillojnë seanca praktike laboratorike, shoqëruar edhe me tematikat e laboratoreve. Këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lënde ashtu si e parashikon VKM Nr 41 dt 24.01.2018. Nuk është e nevojshme që krahas programit të lëndëve të jenë dhe planet kalendarike thjesht për të treguar tematikat e seminareve ose praktikave laboratorike. Ky dokument nuk është në ato të dorëzuara për këtë PS por pretendohet nga pedagogët përkatës se egziston për çdo lëndë. Përsa i takon detyrimeve që studentët kanë për modulet dhe mënyra e vlerësimit janë pasqyruar qartë, por ka mospërputhje për mënyrën e zhvillimit të provimit përfundimtar. Në planin mësimor figuron për të gjitha modulet që provimi përfundimtar zhvillohet me gojë, ndërkohë që në programet e lëndëve përkatëse mënyra e provimit ndryshon; kryesisht është me shkrim, ose shkrim gojë. Kjo duhet të rregullohet, të jetë e njëjta mënyrë kontrolli i dijeve përfundimtare si në planin mësimor ashtu dhe në programin e lëndës përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i Studimit MSH në IAU - TAU vepron në bazë të një rregulloreje të caktuar, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1</i>; ku janë përcaktuar qartë kushtet dhe kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit. Kushtet e transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të tyre përcaktohen qartë në Rregulloren e FBU <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 Kreu X, neni 67-75</i>. Zyra e Studentëve dhe Karrierës në FBU jep kontributin kryesor në informimin e studentëve për programet e studimit, siç është përcaktuar në Rregulloren e DZHKKVI, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 12-13 neni 15, 16</i>. për rezultatet e provimeve, detyrimeve, grafikët e provimeve dhe njoftimeve të tjera që lidhen me kriteret e pranimit të studentëve, rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit dhe kurrikulën përkatëse realizohet duke shfrytëzuar forma të shumta komunikimi dhe informimi, si panairë të IAL-ve, Guida e Studimeve në FBU, fletëpalosje, duke shfrytëzuar rrjetet sociale si dhe faqen WEB të UBT/FBU. <i>Dokumentet e dorëzuar nr 51</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit</p>	<p>Titullarët e moduleve/lëndëve, pjesë e personelit akademik të DTAU, ku ky program studimi operon, dorezojnë çdo fillim viti akademik, programin lëndor (syllabus-in) për modulën që mbulojnë, në formatin e përcaktuar të VKM Nr 41/2018. Gjithashtu referuar ndarjes së praktikave lëndore, leksioneve, seminare dhe gjithë pjesëve përbërëse të modulit, secili titullar</p>






<p>brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>lënde paraqet në departament, planin kalendar ku ka të specifikuar me orë dhe përqindje, të gjithë informacionin e nevojshëm për organizmin e lëndës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.2 shtojca 2.</i></p> <p>GVJ mendon që në programet lëndore duhet të jepet informacion për peshën që zënë në ngarkesën javore seancat laboratorike, dhe të specifikohet ngarkesa sipas tre zerave: leksion: seminar/ushtrime: laboratore; shoqëruar edhe me tematikat e laboratorëve. Këto elemente duhet të jenë në të njëjtin format syllabusi ose programi lëndë ashtu si e parashikon VKM Nr 41/2018. Nuk është e nevojshme që krahas programit të lëndëve të jenë dhe planet kalendarike.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Modulet mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në programet e studimit dhe kreditet për secilën prej tyre mund të rishikohen. Ndryshimet propozohen nga Departamenti përkatës, Dekanati, deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UBT-së, në rastin kur masa e ndryshimit të kërkuar nuk e kalon nivelin 20% .</p> <p>Propozimi për ndryshimin e përmbajtjes së Programit mësimor i propozuar nga Departamenti, miratohet nga Dekani i FBU pasi ka shqyrtuar me kujdes Analizën Mësimore të DTA, Raportin e Analizës Mësimore të FBU dhe të Raportin vjetor të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave.</p> <p>GVJ shprehet se: Duke krahasuar planet mesimore dhe kurrikulat e këtij programi studimi për tre vitet e fundit janë evidente ndryshimet që janë bërë në masën jo më shumë se 20%, çdo vit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 52/1,/2/3/4.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa në programin e studimit, “MSH IAU - TAU është shpërndarë në dy vite akademike, sipas përcaktimit në Statutin e UBT, Rregulloren e FBU, Rregulloren e Studimeve të Programit Master. Sasia e totale e krediteve të Programit të Studimit Master i Shkencave është 120 kredite, ku çdo semestër përmbledh module me 30 kredite, dhe veprimtaritë formuese janë shpërndarë sipas Udhëzimit të VKM Nr.</p>

	41/2018. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.2 aneksi 2.</i> Gjithashtu kjo është pasqyruar edhe ne kurrikulen <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.1 dhe planet mesimore te këtij PS Dokumenti i dorëzuar nr 14.8</i>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit në MSH në IAU profili TAU mundëson thellimin e njohurive dhe aftësive për studime në ciklin e tretë ose dhe për punësim, pasi gjatë dy viteve të studimit, studenti merr njohuritë në lidhje me shumë aspekte të teknologjisë, aspekte inxhinierisë ushqimore, shkencave të ushqimit dhe aspekte të drejtimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 2.</i> Ai aftësohet duke punuar në linjat pilot të përpunimit të qumështit, prodhimit të djathit, linja e prodhimit të vajit të ullirit, linja e prodhimit të verës, linja e përpunimit të drithit, prodhimit të bukës dhe produkteve konditore qe janë të disponueshme në ambientet e FBU. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 60.</i></p> <p>Sipas RVB të diplomuarit e këtij PS në 5 vitet e fundit kanë mundur të punësohen rreth 64% në sektorin e agropërpunimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 18.</i> Numri studentëve aktualë në këtë program është i vogël, 23 studentë në vitin e parë dhe 22 studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e dytë, plus 6 studentë të mbartur. Gjithsej këtë program e ndjekin 51 studentë.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Shuma e përgjithshme e orëve të moduleve të PS është 1200 orë, për 120 kredite në total. Lëndët zhvillohen në tre semestra, secili ka module me 6 kredite, vetëm një modul Analizat e Ushqimeve ka 12 kredite dhe zhvillohet në semestrin e tretë. Në semestrin e parë dhe të dytë zhvillohen në secilin 5 module cdo semestër ka në total 30 kredite dhe 300 orë në auditor. Semestri tretë ka 4 module në total 30 kredite dhe 300 orë. Në semestrin e katërt kryhet nga studentët Teza e Diplomës që vlerësohet me 30 kredite të përkthyer në 300 orë mësimore. Kjo strukturë dhe shpërndarje mendojmë se mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1</i>) dhe rezultateve të pritshme të të nxënit (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 27.5 dhe 27.6</i>) dhe kërkimit shkencor, nëpërmjet realizimit të temave të diplomës.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Agroushqimore, ka strukturë në përputhje me profilin e masterit shkencor ku orët fizike të zhvilluara janë: 420 orë leksione • 480 orë seminare, ushtrime, punë laborator • 300 orë teza e Diplomës • Në përgjithësi çdo modul ka parashikuar një raport të barabartë orë leksione: orë seminare/ushtrime ose praktikë laboratorike. Kjo ndarje e orëve të studimit sipas elementëve të mësimin pasqyrohet qartë</p>

	<p>në Planet mësimore <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8</i> dhe ndihmon studentin të kuptojë më mirë dijet e tij, në njohuritë praktike dhe teorike. Vihet re përputhshmëri me programe studimi analoge në Universitete Europiane me të cilat FBU ka shkëmbime në kuadër të Erasmus+. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.10</i> Kështu, siç shikohet nga krahasimi me të njëjtin Program Studimi që zhvillohet në Universitetin e Molise, Itali rezulton që 71.4% (10 module) e PS MSH IAU-TAU janë pothuajse ose krejtësisht të njëjta me modulet që zhvillohen në U Molise. Pjesa tjetër e lëndëve 4 module të programit nuk zhvillohen në U Molise. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.10.1</i>. Ngjashmëria me PS të U Milanos janë përmëndur më sipër.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijtjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në ciklin e dytë të studimeve organizimi i moduleve dhe raportit midis formimit teorik dhe praktik është 1:2 parashikuar sipas Rregullores së Studimeve MSH në IAU-TAU. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 7</i>. Në fakt sipas planit mësimor të këtij PS ky raport është 2 orë leksion:2 orë seminare/laborator pra 1:1. Në total 420 orë leksione • 480 orë seminare, ushtrime, punë laborator dmth 1:1,4.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e moduleve të PS Master i Shkencave në IUA TAU përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Disa syllabuse janë modifikuar në mënyrë të pjesshme, disa të tjera në mënyrë rrënjësore. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse duhet të rishikohet çdo vit dhe shënohet në fund të syllabusit. Literatura ndahet në kategori: literaturë bazë e detyruar dhe literaturë e rekomanduar. Konstatohet që në disa module literatura nuk është pasqyruar në programin e lëndëve, e detajuar për çdo kapitull, sipas formatit të rekomanduar nga VKM nr 41. Ka module ku mungon literatura dhe në disa raste nuk tregohet viti i botimit.(dokumenti i dorëzuar syllabus I modulit Inxhineria e Produkteve Ushqimore) Për të siguruar transmetimin sa më të mirë të njohurive bashkëkohore tek studentët, përzgjedhja e literaturës në këtë PS është bërë mbi bazën e përdorimit si tekste bazë të librave të botuar në shtëpi botuese, nga stafi akademik i Fakultetit.dokumenti i dorëzuar nr 45.2 Në mbështetje të literaturës bazë të lëndëve të ndryshme, janë sugjeruar dhe përdorur edhe botime të specialitetit të botuara nga Universitetet perëndimorë. Në kushtet e numrit të vogël të studentëve dhe të dinamikës së zhvillimit të teknologjive, përdorimi i leksioneve të shkruara, paraqet një formë me interes. Kështu në mjaft disiplina, pedagogu u jep studentëve materiale të shkruara në formë dixhitale ose të shkruar. Në këtë PS modulet janë shoqëruar me tekste mësimore dhe leksione të shkruara. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 45.2</i></p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit MSH garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të tretë. Studentët e diplomuar në këtë program studimi mund të vazhdojnë në Ciklin e Tretë të Studimeve të Doktoraturës, sipas kritereve të vendosura në Rregulloren e Doktoraturës së FBU (<i>dokumenti i dorëzuar nr 64</i>), ose në degë të ngjashme në universitete të tjera.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga komunikimi i vazhdueshëm me studentët e sidomos me punëdhënësit potenciale, operatorët e biznesit apo institucione të ndryshme të fushës, rezulton një shkallë e kënaqëshme punësimi, rreth 640% në ndërmarrje agropërpunimi, 28% në ndërmarrje shërbimi dhe rreth 10% e të diplomuarve pa punë. <i>dokumenti i dorëzuar nr 18</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>FBU, bashkëpunon me biznesin. Në funksion të nevojave për zhvillimin e procesit mësimor si dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushën e Ushqimit, lidhjes së kërkimit shkencor me aktivitetet private dhe industrinë. FBU shpreh gadishmërinë që të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për realizimin e shërbimeve dhe ofrimin e konsulencës shkencore, si dhe për “Këshillime për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programeve të studimit në FBU dhe përshtatjen sa më mirë të tyre me kërkesat e tregut tëpunës. Nga dokumentat e dorëzuara nuk rezulton marëveshje konkrete të nënshkruar midis UBT_FBU dhe bizneseve. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 34.1</i> është vetëm një listë biznesesh bashkëpunuese dhe <i>dokumenti i dorëzuar nr 34.2</i> është vetëm një format marëveshje</p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Përgjigje e njëjtë me kriterin 7 Përmbajtja e programit të studimit MSH garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të tretë. Studentët e diplomuar në këtë program studimi mund të vazhdojnë në Ciklin e Tretë të Studimeve të Doktoraturës, sipas kritereve të vendosura në Rregulloren e Doktoraturës së FBU ose në degë të ngjashme në universitete të tjera. <i>dokumenti i dorëzuar nr 64.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al38

<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në ligjin L.80/2018, Neni 59, pika 6; Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme që angazhohet në Mësimdhënie në Programin e studimit Master i Shkencave, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Staf (14 personel akademik, 7 janë kategorisë Profesor, dhe 6 gradën Doktor) ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës; bëjnë përjashtim vetëm 2 staf akademik i brendshëm që mbajnë akoma gradën MSc, regjistruar dhe janë në përfundim Doktorature, <i>dokumenti i dorëzuar nr 24</i>. Mer pjesë një staf akademik i ftuar, i cili mbart 40 vjet punë si Teknolog bulmeti dhe ftohet të japë leksione në lëndën "Shkenca e Bulmetit dhe Prodhimi i Djathrave special". <i>dokumenti i dorëzuar nr 21.2.2</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Lektorët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë perpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e mëtejshëm të tyre, duke zhvilluar punë kërkimore shkencore, botojnë artikuj dhe marrin pjesë në trajnime, projekte e konferenca të ndryshme shkencore, duke rritur kështu kualifikimin shkencor për Programin e Studimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.1 dhe 43.6</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli Akademik i cili mbulon programin e studimit Master i Shkencave IAU-TAU ka background në përputhje me specifikën e modulit të cilin ai mbulon si dhe është në kualifikim të vazhdueshëm. Kriteret bazë të përzgjedhjes së personelit akademik vendosen duke u bazuar në: eksperiencën në mësimdhënien universitare, grada dhe titulli shkencor i kandidatit për pedagog dhe aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij. CV akademike të stafit dorëzohen çdo vit pranë Përgjegjësit të DTA, i cili është njëkohësisht Koordinator i Programit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 24 dhe 43.6</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga FBU janë realizuar vizita në stabilimente prodhuese dhe kompani të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit në disa qytete. FBU bashkëpunon me këto bisnese për realizimin e punimeve shkencore të temave të Diplomave Master të studentëve, por edhe me Universitete të huaja (Projekte Erasmus+107) ku studentë të PS Master Shkencor, kryejnë një pjesë ose tërësisht temën e Diplomës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.2 dhe 35.3 dhe 79.2</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborante, teknike) ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Programi i Studimit MSH në IAU profili TAU ka në dispozicion 6 staf ndihmës akademik, të gjithë me gradën Master i Shkencave, ose Master Profesional, me përvojë të gjatë pozitive në fushën e analizave të ushqimeve, të lëndëve të para, në fushën e pajisjeve</p>

	dhe vënies në punë të linjave pilot dhe pajisjeve të analizës instrumentale të ushqimeve. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 22</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	FBU bashkëpunon në mënyrë të vazhduar me biznesin. Në funksion të nevojave për zhvillimin e procesit mësimor si dhe realizimin e programit kërkimor e shkencor në fushën e Ushqimit, lidhjes së kërkimit shkencor me aktivitetet private dhe industrinë. Staf i akademik i PS shpreh gadishmërinë që të bashkëpunojë me institucionet dhe biznesin për realizimin e shërbimeve dhe ofrimin e konsulencës shkencore, si dhe për këshillime për përmirësim të përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen sa më mirë të tyre me kërkesat e tregut e punës. <i>dokumenti i dorëzuar nr 32.2.1 Marëveshje me AKU</i>
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Në fund të çdo semestri në të gjitha kurset e studimit kryhet anketimi për modulet që janë zhvilluar në atë semestër. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 40 dhe nr 40.1.</i> Në këtë anketim studentët përgjigjen për performancën e pedagogut, cilësinë e materialeve didaktike, logjistikën si dhe janë të lirë të shprehin gjithë problematikat e tyre në lidhje me Programin e Studimit. Rezultatet e anketimit përpunohen nga Komisioni i Anketimit dhe i vlerësimin të cilësisë së procesit mësimor, i ngritur në bazë të rregullores FBU. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 90 pika b.</i> Raporti bëhet i njohur dhe miratohet nga Dekani më pas raportohet në mbledhjen e Asamblesë së Fakultetit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 37.1.</i> Gjithashtu, pranë FBU është ngritur dhe funksionon Forumi Studentor për evidentimin e problematikave të ndryshme dhe sugjerime për zgjidhjen e tyre. <i>dokumenti i dorëzuar nr 72.</i>
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Pranë FBU është ngritur Bordi Alumni me pjesëmarrje të studentëve të diplomuar pranë FBU i cili bën të mundur përafrimin e kapaciteteve me edukimin e duhur profesional të studentëve me sipërmarrjet. Bordi Alumni ka 5 përfaqësues nga FBU dhe njësi bazë merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 75.</i>
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson,	Me qëllim zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit shkencor dhe arsimor, UBT bashkëpunon me Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Evropë, Kosovë dhe Shqipëri.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al40

përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - Shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore. - Shkëmbimin e studentëve. - Shkëmbimin e stafit administrative. - Nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. - Organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve. - Shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore. <i>Dokumente i dorëzuar nr 43.4 dhe nr 79.2</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit MSH në IAU-TAU është hartuar dhe ofrohet në përputhje me objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në FBU. Objektivat e këtij programi janë përcaktuar qartë në Rregulloren e PS dhe synojnë përgatitjen e specialistëve dhe në Teknologjitë Agroushqimore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 4 dhe 7.1 neni 2.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia bazë, Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 18.</i> Liria akademike shfaqet në të drejtën e personelit për të marrë pjesë, nëpërmjet aplikimit, në projekte zhvilluese të financuara nga B.E; për të vendosur lidhje me institucione të tjera të arsimit të lartë (vendase dhe të huaja) për shkëmbim përvoja dhe për bashkëpunim në mësimdhënie, në kërkimin shkencor si dhe për kualifikimin e personelit. Çdo anëtar i personelit akademik është i lirë të punojë, të vendosë bashkëpunime kërkimore shkencore me partnerë dhe institucione vendase apo të huaja, në fushat e veprimtarisë kërkimore shkencore të GMK ku kontribuon. <i>dokumenti i dorëzuar nr 2 neni 3</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit nëpërmjet politikave të tij, nxit studentët të angazhohen në pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore, në projekte apo aktivitete kërkimore të cilat e zhvillojnë dhe e ndihmojnë studentin të jetë më i përgatitur për tregun e punës. Kështu, në kuadër të Projektit Interreg 2014-2020 IPA. "studentët janë thirrur të marrin pjesë. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.7.</i> Disa studentë kanë kryer punimet e tezës të Diplomës

	Master në universitete europiane në kuadër të shkëmbimeve Erasmus +. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.1</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Ne këtë kuadër pjesëmarrja aktive e stafit akademik të Programit Mësimor të MSH në IAU profili TAU, në projekte të zhvillimit rajonal dhe europian sjell një frymë të re pozitive zhvillimi të këtij programi, nën një perspektivë të re rajonale dhe europiane. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.2</i>			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore shkencore Departamenti i Teknologjise Agroushqimore, përgjegjës për zhvillimin e Programit të Studimit MSH në IAU profili TAU, e mbështet nga të ardhurat sekondare të gjeneruara nga FBU si dhe financimet nga projektet e bashkëpunimit rajonale apo Europiane. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 76 fq 28,29.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓



Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Shembull i këtij bashkëpunimi të frytshëm ka qenë implementimi i projektit ERASMUS+; PROJECT NETCHEM: “ICT networking for overcoming technical and social barriers in instrumental analytical chemistry education”. Në sajë të këtij projekti është bërë e mundur të përmirësohet plotësimi i objektivave të programit në kërkimin shkencor; nëpërmjet softëareve që do të instalohen në Laboratorin të Inxhinierisë Ushqimore studentët do të jenë në gjendje të modelojnë procese të përpunimit ushqimor. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 39.1 dhe 55.4</i> Gjithashtu është marrja pjesë në një network të përbashkët me 6 universitete europiane në realizimin e disa analizave instrumentale të ushqimit, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe demonstrimin e drejtpërdrejtë për efekte mësimore ose kërkimore, në kuadrin e lëndës: Analizat e Ushqimeve.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Teknologjise Agroushqimore i përgjigjet kërkesave për analiza, studime e projekte, duke kryer aktivitet kërkimor shkencor në fushat e prodhimit dhe përpunimit të ushqimeve, bioteknologjisë, sigurisë ushqimore, legjisllacionit dhe standartet mbi ushqimin, mjedisit dhe impaktin e ndërsjelltë që ka mjedisi dhe ushqimi. Aktivitetin shkencor DTAU e kryen në kuadrin e dy grupeve mësimore-kërkimore <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 18</i> , dhe angazhohet duke vënë në dispozicion të gjitha burimet e saj për realizimin e këtyre objektivave, duke ju përgjigjur si nga ana financiare ashtu dhe

	vënien në dispozicion të ambjenteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për këtë program studimi. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 42.1 dhe 42.4.</i> Punimet e GMK paraqiten në Konferenca shkencore, publikime artikujsh apo nëpërmjet diplomave të studentëve <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.4 dhe 43.6.</i>			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Stafi akademik ka referuar punimet shkencore në Konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara nga UBT. Njësia përgjegjëse nuk ka organizuar deri tani konferenca shkencore, por ka zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të implementimit të projekteve <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.4 IPA, NETCHEM, ERASMUS</i> (dosjet e projekteve të depozituara)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Institucioni ka adaptuar metodat inovative të mësimdhënies. E-learning është një metodë inovative që përfshin format e të mësuarit dhe të dhënies së mësim, e cila zhvillohet me ndihmën e paisjeve elektronike. Dokumenti i dorëzuar nr 39 Metodave dhe qasjet e mësimit elektronik ndihmojnë stafet akademike të krijojnë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënies përdorimi i paisjeve elektronike në mësimdhënie zë një përqindje të konsiderueshme krahas mësimdhënies tradicionale të shpjegimit me të shkruar në tabelë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Mësimdhënia mbetet aktiviteti kryesor i personelit akademik dhe i nënshtrohet monitorimit të vazhdueshëm me qëllim sigurimin e cilësisë. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative. Monitorimi kryhet në nivel fakulteti: Dekanati; Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, që funksionon në nivel Rektorati. Komisioni i Anketimit dhe vlerësimi të procesit mësimor dhe marrdhëniesve pedagog-studentë. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 40.1</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimi të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Si me sipër standardi II 6 kriteri 2 Studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor. Në fund të çdo semestri studentët marrin pjesë në anketimin e zhvilluar nga Komisioni i Anketimit dhe Vlerësimi të Cilësisë së Procesit Mësimor, (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 40 dhe nr 40.1</i>); ku ata vlerësojnë procesin me gjithë parametrat e tij. Rezultatet e anketimeve përpunohen nga zv. Dekani për mësimin dhe pasqyrohen prej tij në Raportin e Analizës Vjetore Mësimore FBU. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 37.2</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimi.	Çdo fund viti kalendarik strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimi për vitin e kaluar akademik. Kështu, përgjegjësi i DTA përpilon Analizën Mësimore, Analizën e punës kërkimore të DTA. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 38.1 dhe nr 38.2.</i> Performancën akademike të anëtarëve të departamentit si dhe tabelën e indikatorëve të cilësisë në kërkim shkencor. Këto materiale raporton për diskutim në mbledhjen e DTA dhe përdoren për raportin e analizës vjetore për mësimin dhe Raportin e Analizës Vjetore për kërkimin. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 37.2.</i> Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kurrikulave,

	bën vlerësim periodik dhe një herë në vit paraqet një raport kryesisht mbi vlerësimin e lëndëve dhe moduleve nga pikepamja e realizimit cilësor të tyre, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 38.3</i> . Njëkohësisht bën propozime për përmirësime apo ndryshime të kurrikulës deri në masën 20%. Sa më lart diskutohen në Mbledhjen e Asamblesë së Fakultetit.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, të gjithë anëtarët e Personelit Akademik gëzojnë liri akademike. Liria dhe përgjegjësitë akademike janë vendimtare për zhvillimin e plotë të njësisë kryesore dhe shtrihen në procesin e mësimdhënies. Promovimi i praktikave të mira në Programin e studimit të MSH në IAU profili TAU është implementimi i projektit NETCHEM, nëpërmjet së cilit stafi akademik i këtij programi është trajnuar në mënyrë të vazhdueshme për metodat e inovative të mësimdhënies. Gjithashtu pjesëmarrja në projekte ERASMUS ku shkëmbimi i stafit për mësimdhënie apo trajnime është një shëmbull i përmirësimit të cilësisë dhe kualifikimit të personelit akademik. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.8</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓


Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Pogrami i studimit të Diplomës së ciklit të dytë në Inxhinieri Agrorëshqimore, profili Teknologji Agrorëshqimore, ka strukturë në përputhje me profilin e masterit shkencor ku orët fizike të zhvilluara janë: • 420 orë leksione • 480 orë seminare, ushtrime, punë laboratorie • 300 orë teza e Diplomës • shumica e përgjithshme e orëve është 1200 që i përket 120 krediteve. Provimi për çdo lëndë • Përgatitja e materialit të shkruar në fund të kryerjes së Tezës së Diplomës. Raporti midis formimit teorik dhe praktik 1:1,14 dhe jo 1:2 si parashikohet në rregulloren e programit master <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni7</i> . Mënyrat e zhvillimit të mësimin janë paraqitur në Programet e lëndëve, Planet Mësimore (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8</i>), ku tregohen dhe % që zënë detyra kurse, projektet, praktikat profesionale.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve	Personeli akademik bën përpjekjet maksimale për të ofruar mundësi alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në procesin e mësimdhënies janë futur teknikat audiovizive të mësimdhënies. Ka disiplinën të tilla ku këto teknika kanë përparësi. Për të bërë të mundur realizimin e këtyre teknikave, në FBU janë ngritur mjedise mësimdhënëse si auditorë dhe

<p>formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>laboratorë të pajisur me kompjutera, retroprojektorë. PS i jep rëndësi veprimtarive praktike të formimit, siç janë: ushtrime, laboratore, detyra, projekte, apo edhe praktika të lëndës, që studentët të aftësohet në zbatime praktike të njohurive teorike të dhëna në leksione. Një pjesë e këtyre veprimtarive formuese bëhet nën asistencën e pedagogut, ndërsa një pjesë tjetër zhvillohen si punime të pavarura të studentit siç janë detyrat, projektet etj. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Kualifikimi në vazhdimësi i stafit pedagogjik është prioritet e FBU, kjo për faktin se moshë e personelit në fakultet është e re dhe nevoja për kualifikim specifik, është e lartë, për natyrën specifike të fushave që ai mbulon. Mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi, në institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit i shërben punës së tyre didaktike e mësimore, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.2 dhe 43.8.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Në rekrutimin e personelit i kushtohet vëmendje e veçantë përzgjedhjes se personelit akademik te kualifikuar dhe kompetent ne fushën e tij. Për këtë qëllim nga ana e DTAU është ndjekur procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës në Buletin e Njoftimeve Publike si dhe në ëbsite e institucionit. Në njoftim institucioni shpall ofertën e punës me kërkesat specifike që ka propozuar njësi bazë dhe dekanati, të miratuara nga titullari i insitucionit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 44.2 .1 dhe 44.3</i> Kandidatët që përzgjidhen kanë një background të lidhur me profilin e mësimdhënies qe kërkohet dhe mundësisht experiencë pedagogjike. Në kriteret e vendosura për rekrutim personeli, përparësi kanë ata që janë kualifikuar jashtë vendit. Metodot qe perdor personeli ne mësimdhenie janë të ndryshme, në varësi të specifikeve të lëndës. Në procesin e mësimdhënies janë futur teknikat audiovizive të mësimdhënies. Ka disiplina të tilla ku këto teknika kanë përparësi. Përmendur tek kriteri 2 si më sipër.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Per përfshirjen e studentëve ne permiresimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe për vlerësimin prej tyre te te gjithë elementëve te procesit mësimor zhvillohet anketimi i tyre. Studentët përfshihen në këtë proces duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, nëpërmjet plotësimit të pyetsorëve, në fund të çdo semestri. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 40.</i> Në shpërndarjen/grumbullimin e pyetësorëve si dhe në nxjerrjen e tabelave përmbledhëse angazhohen edhe përfaqësues të “Këshillit studentor”. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 72.</i> Rezultatet e anketimit përfshihen në Raportin Mësimor të çdo viti të FBU dhe diskutohet në Dekanat dhe në Mbledhjen e Asamblesë për përmirësime të mundshme. (si më sipër)</p>






<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Përdorimi i metodave interaktive të të menduarit kritik është vlerësuar në mësimdhënien nga stafi i PS Stafi akademik e ka reflektuar këtë në rritjen e masës së vlerësimit gjatë vitit përkundrejt vlerësimit final, pothuajse në të gjitha lëndët në 30%- 40%. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.8</i> planet mesimore. Kjo gjë inkurajon studentët që të jenë me aktivë gjatë kohës së mësimit, të thellojnë aresyetimin kritik dhe aftësinë për të diskutuar, duke u përgatitur më mirë për tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Realizimi i programit të studimit mbështetet në metodat që venë theksin tek studentit, si dhe që kërkojnë formimin e njohurive hap pas hapi. Këto metoda kuptojnë më shumë përfshirje të studentëve për zhvillimin e ideve të reja dhe të ndryshme. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 51.3</i> konferenca IV studentore UBT.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Programi i Studimit të Ciklit të dytë, Master i Shkencave në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Ushqimore, zhvillon aktivitetin e tij mësimor dhe shkencor në mjediset e Godinës së Laboratorit të Kimisë, Bibliotekës së UBT, ish Kantina e Verës dhe Qendra e Kërkimit të Ushqimit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 42.1.</i> Hapësira totale e vënë në dispozicion për procesin kërkimor është 4.3 m²/ student dhe për procesin mësimor është 5.42 m²/ student. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 42.3.</i> Këto normativa plotësohen edhe në bashkërendim me ambientet e programeve të tjera të studimit apo edhe fakulteteve e tjera. Mirëmbajtja e pastrimi i ambienteve kryhet në mënyrë të përditëshme nga stafi i shërbimeve numri i të cilëve është 5. GVJ nga vizita në institucion konstatoi se laboratorët janë ambiente të përshtatëshme për veprimtarinë formuese përkatëse, janë të paisur me aparaturat e nevojshme, mbahen mirë, por grupet laboratorike të studentëve që punojnë aty brenda një seance janë me numër të lartë, 20 studentë. Duket një sipërfaqe e vogël për këtë numër studenësh, dhe nuk krijohet mundësia për pjesëmarrjen aktive të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për</p>	<p>Mjediset e dedikuara për zhvillimin e procesit mësimor përfshijnë sallat e leksioneve, seminareve, seanceve laboratorike si edhe praktikave. Sallat e leksioneve dhe</p>



<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>seminareve janë të pajisura kryesisht me tavolina dhe ulëse me kapacitet në përputhje me numrin e studentëve që përmban secili grup mësimor. Numri i studentëve në grupin mësimor është jo më shumë se 25 studentë për çdo grup seminaresh. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 27.4</i> Gjithashtu laboratorët janë pajisur me pajisje, sipas specifikës së secilit laborator në ndihmë të një procesi sa më të rregullt mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Sigurimi i internetit në kampus realizohet nëpërmjet rrjetit WLAN dhe Wireless “Campus UBT” dhe është i aksesueshëm nga stafi akademik dhe nga studentët nga çdo laptop, smartphone dhe kompjuter</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Libraria Universitare shërben dhe plotëson përgjithësisht nevojat bazë për tekstet e domosdoshëm mësimorë të botuara nga shtëpi botues, apo cikleve të leksioneve që secili pedagog përgatit për modulën përkatës. Secili nga pedagogët dorëzon pranë Librisë Universitare materialin bazë për modulën që drejton në fillim të çdo viti akademik. Studentëve u vihet në dispozicion materiale të tjera të përkthyer në shqip, leksione të shkruara, prezantime në poërpint, të cilat shpërndahen në format elektronike (e-mail), ose shfaqet ne site-n e pedagogut, apo një kopje e printuar në letër. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 45.2 dhe 47.2.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita e GVJ ne institucion u konstatua qe stafi akademik, ai ndihmës dhe studentët shrytëzojnë Bibliotekën Shkencore. Kjo bibliotekë mund të shfrytëzohet, përveç literaturës, edhe si ambient studimi, duke qenë se ka në dispozicion 5 salla studimi, ndër të cilat dy janë salla studimi të pajisura me kompjutera, Në pesë vitet e fundit Biblioteka ka marrë një fond të librit tekniko shkencor për FBU prej 111 titujsh nga të cilët 44 janë në gjuhën shqipe dhe 67 në gjuhë të huaj <i>Dokumenti i dorëzuar nr 45.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Aksesimi i librarive on-line nga stafi akademik si dhe studentët përbën një risi, pasi stafi akademik plotëson boshllëkun që ka pasur me vite, për sigurimin e periodikëve në fushat e tyre; ndërkohë, studentët mund të aksesojnë materialet kudo nëpërmjet teknologjisë smartphone. Biblioteka ofron informacione online nga burimet elektronike, me abonim ose free nga projekte si Research for life. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 45.3 dhe 45.5.</i> Biblioteka Shkencore disponon gjithashtu një koleksion periodikësh shkencorë në fusha të shkencës të ushqimit që lidhen me modulet e këtij programi studimi, në shqip dhe në gjuhë të huaj, nje pjesë e të cilëve janë siguruar përmes abonimit vjetor. Gjithashtu, për të përcjellë informacionin kudo dhe kurdo, është krijuar në</p>

	<p>masën më të madhe katalogu online i Bibliotekës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 45.5.</i> Gjithashtu nëpërmjet rrjetit akademik shqiptar (RASH) studentët kanë akses përdorimi të aplikacionit library i cili shërben për kërkimin dhe shkarkimin e litaraturave të huaja dhe shqip. Ky akses ju ofrohet të gjithë studentëve të FBU-së të cilët janë të pajisur me një llogari nëpërmjet sistemit ESSE3. Ky aplikacion është pa pagesë . <i>Dokumenti i dorëzuar nr 39.</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura laboratorike për realizimin e seancave eksperimentale laboratorike dhe punëve praktike, përshtatet sipas specifikave të programit. 182.44 m² janë të ambienteve të laboratorëve shkencorë, 225.2 m² janë salla dhe klasa për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, ndërsa një sipërfaqe prej 535 m² disponohet për linjat pilot të prodhimit eksperimental të djathrave, produkteve të qumështit, vajit të ullirit, verës dhe pijeve alkoolike si dhe drithërave dhe produkteve konditore. Të gjitha këto laboratore janë të mobiluara dhe të pajisura sipas specifikës së laboratorit, në të gjenden reagentë, mjete ndihmëse aparatura etj, të cilat mundësojnë realizimin e seancave praktike. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 55.3 dhe 55.4. dhe nr 60.</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Si më sipër, ashti sic edhe e kemi përmendur, përdoren metodat inovatore të mësimdhënies. Metodatat që përdoren janë: e-learning, etj. Për përdorimin e këtyre metodave është në dispozicion udhëzuesi i përdorimit ku janë të bashkëngjitur edhe adresat e faqes ëeb për çdo program. Të gjithë studentët janë të përfshirë në faqen e sistemit ESSE3. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 39.</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>	<p>Komunikimi i brendshëm ndërmjet stafit akademik, studentëve dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet platformës Esse3. Përkatësisht pedagogu dhe studenti, kanë një account personal në Esse3. Çdo veprimtari e pedagogut që ka lidhje me studentin (plotësimi i pikëve gjatë vitit, shpallja e datës së provimeve, vendosja e notës) bën të mundur dërgimin e një e-mail-i lajmërues në account-in e studentit; kështu në kohë reale ai mund të marrë informacione në lidhje me procesin mësimor. Gjithashtu çdo pedagog disponon një site personal në faqen zyrtare të UBT në të cilin bën transparent syllabusin për modulën/et që mbulon si dhe leksione të ndryshme. Ky site është i arritshëm nga të gjithë studentët dhe është i shpallur edhe në syllabusin e dorëzuar në departament. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 47.1 47.2 dhe 47.3.</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik ndihmon studentët e ciklit të dytë të studimeve MSH IAU-TAU, në përzgjedhjen e një teme studimore, që mundëson vendosjen në praktikë të njohurive që studenti ka marrë gjatë gjithë studimeve të tij. Çdo titullar</p>

	lëndë, harton grup temash studimi të cilat i paraqet tek përgjegjësi i departamentit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.4</i> Pedagogët udhëheqës, ndjekin gjithë procesin e punës së studentit dhe garantojnë cilësinë e punimit. Çdo personel akademik udhëheq deri në 3 studentë për diplomë master. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 11</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓



Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Këtë rol UBT e kryen përmes funksionimit efektiv të zyrave në përbërje të Rektoratit si Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, Zyrës së Studimeve dhe Studentëve, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 12 13 neni9</i> . Gjithashtu në përputhje me Udhëzimin dt 29.12.2017 mbi Strukturat e Brendshme Akadematike, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 2.2</i> ; si dhe koordinimit me njësitë kryesore konkretisht DTAU në procesin e kontrollit dhe përmirësimit të cilësisë të procesit akademik.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Njësia Kryesore FBU dhe DTAU përgjegjës për këtë program studimi në mënyrë të përvitshme realizon analizën e punës mësimore, ku një nga rubrikat kryesore që diskutohet është cilësia e mësimdhënies. Për këte informacioni shfrytëzohen raportet specifike të analizës mësimore të të gjitha njësive bazë, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 38.1 dhe 38.2</i> . Përdoren edhe pyetorët e realizuar me studentët dhe stafi akademik dhe ndihmës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 40 dhe nr 41</i> . Nga strukturat drejtuese të njësive, vlerësohet performanca e pedagogëve; gjithashtu, plotësohet formulari performancës akademike, ku një nga elementët e të cilit është mësimdhënia, ku angazhimi matet edhe nëpërmjet ngarkesës që ka secili pedagog. Nga evidencat e ngarkesës kostatohet që personeli me titull akademik ka mbingarkesë në auditor deri në 200 orë mbi normën që është 140 orë. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 25.3</i> ; Sipas këtij dokumenti ngarkesa mësimore, konstatohet se ngarkesa minimale është 60 orë pedagogu M.K, ndërsa ngarkesa maksimale është 365 orë për pedagogun A.P Pedagogë me ngakese të lartë janë edhe K.M me 360 orë. Këto personel janë me gradë Doktor dhe kanë mbingarkesë në auditor deri në 200 orë mbi normën që është 160 ore për këtë kategori.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e	Promovimi i praktikave të mira në Programin e studimit të MSH në IAU -TAU është implementimi i projektit NETCHEM,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al50

<p>metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>nëpërmjet të cilit stafi akademik i këtij programi është trajnuar për metodat e inovative të mësimdhënies në analiza instrumentale, në përputhje me profilin e programit. Gjithashtu përfitimi prej projekteve ERASMUS ku shkëmbimi i stafit për mësimdhënie apo trajnime janë një pikë e fortë e përmirësimit të cilësisë së personelit akademik. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.2 dhe 43.8.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Njësia bazë për programin e studimit ka në përbërje dy grupe mësimore kërkimore, GMK të cilët dorëzojnë çdo vit planin e tyre mbi punën mësimore kërkimore për vitin pasardhës. <i>Dokumenti dorëzuar 43.5.1 dhe 43.5.2.</i> Objekti i punës kërkimore shkencore në FBUE është përqëndruar në studime mbi potencialin prodhues nga lëndë të para të vendit, optimizim të teknologjive të përpunimit, përmirësim të standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore si dhe zhvillimin dhe prodhimin e produkteve të reja ushqimore me cilësi, të sigurta, me vlera ushqyese dhe të shëndetshme, të bazuara mbi parimet e teknologjisë agrourbushqimore. Promovimi i stafit akademik për kryerjen e kualifikimeve të vazhdueshme, ka krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në jo vetëm në cilësinë e mësimdhënies, por edhe në cilësinë e kërkimit shkencor. Rritja e nivelit të kërkimit shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte zhvillimore e shkencore dhe përmirësimit të infrastrukturës laboratorike është një prioritet i kualifikimit të stafit në këtë drejtim. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.2 dhe 43.4.</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Për përmirësimin e mësimdhënies, në nivel të njërive kryesore angazhohet stafi akademik dhe stafi ndihmës mësimor –shkencor Mbështetur në Rregulloren e studimeve, por edhe në përshkrimin e punës për stafin ndihmës-mësimor realizohet me korrektësi procesi mësimor. Në dispozicion të realizimit të procesit mësimor vihen të gjitha mjediset e universitetit. Në fillim të çdo semestri hartohet orari mësimor në të cilin detajohen mjediset mësimore se ku do të zhvillohen konkretisht leksionet, praktikat laboratorike, seminarët. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14. 11.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe testimin e metodave të reja. Sipas RVB deri tani nuk janë analizuar efektet dhe pritshmëritë e tyre në mënyrë periodike në raportimet në nivel departamenti apo më tej. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 3.3</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Gjatë zhvillimit të programit të studimit, DTAU angazhon në kuadër të shkëmbimit të ideve dhe metodave të mësimdhënies, lektorë dhe kërkues shkencor të huaj apo vendas të cilët japin eksperiencën e tyre në këtë fushë. Gjithashtu personeli akademik, i punësuar me kohë të plotë, bashkëpunon me kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve, dhe kërkimeve shkencore. Këto bashkëpunime paraqiten në konferenca apo revista shkencore</p>

	duke ndihmuar dhe në kualifikimin e stafit akademik. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 24 dhe 38.3</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kontrolli i dijeve për çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të punimit dhe prezantimit të detyrave të kursit, puneve në grup, kontrolleve ndërmjetëse, pjesmarrjes dhe aktivizimit në seminare laborator si dhe provimit përfundimtar. Mënyrat e vlerësimit dhe ndarjes së pikëve për vlerësimet e sipërpërmendura janë të shprehura qartë në syllabusin e çdo moduli, “Elementët e vlerësimit”, në Rregulloren e Sudimit të Programit Master i Shkencave në IAU profili TAU, në planin mesimor si dhe në Rregulloren e Studimeve UBT. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 6 /j dhe nr 5 neni 56.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo semestri, pedagogu /titullari i lëndës, paraqet tek studentët që do të ndjekin këtë lëndë/modul, strukturën e lëndës, në bazë të sillabusit dhe planit kalendar. Aty paraqiten temat që do të shqyrtohen gjatë gjithë modulit, struktura e lëndës, mënyra e vlerësimit të studentëve. Studenti njihet me metodologjinë e testimit gjatë vitit dhe merr informacion për formën e provimit përfundimtar (me shkrim apo me gojë); numrin e kontrolleve ndërmjetëse që do të realizojë gjatë vitit, tema të detyrave të kursit etj. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.5.</i> Gjithashtu studentëve u tregohet qartësisht mënyra e sigurimit të literaturës (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 98 pika 2e.</i>) tekst në shitje, leksione të shumëfishuara, shënime në klasë, literaturë e huaj etj
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Testimi dhe vlerësimi i njohurive në programin e studimit të ciklit të dytë, kryhet në forma të ndryshme. Gjatë vitit testimi kryhet me testime ndërmjetëse, punëve në grup dhe në fund të vitit – para hyrjes në provim – për disa lëndë aplikohen detyra kursit apo projekte që studenti i ka përgatitur gjatë studimit individual. Provimi përfundimtar kryhet provim me shkrim ose me shkrim dhe gojë, sipas përshkrimit në syllabusin përkatës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.5 dhe nr 14.8.</i> Provimi me shkrim mund të jetë me

	alternativë ose pyetje me shtjellim. Tezat e provimit përfundimtar riformulohen dhe azhornohen çdo vit, ato hartohen nga titullari i lëndës, firmosen nga përgjegjësi i Departamentit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 98/2d dhe neni 57 pika e.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Ashtu siç edhe e kemi paraqitur edhe më sipër , Testimi dhe vlerësimi i njohurive në programin e studimit të ciklit të dytë, kryhet në forma të ndryshme. Gjatë vitit testimi kryhet me testime ndërmjetëse, punëve në grup dhe në fund të vitit – para hyrjes në provim – për disa lëndë aplikohen detyra kursit apo projekte që studenti i ka përgatitur gjatë studimit individual. Provimi përfundimtar kryhet provim me shkrim ose me shkrim dhe gojë, sipas përshkrimit në syllabusin përkatës. Provimi me shkrim mund të jetë me alternativë ose pyetje me shtjellim. Tezat e provimit përfundimtar riformulohen dhe azhornohen çdo vit, ato hartohen nga titullari i lëndës, firmosen nga përgjegjësi i Departamentit. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 98 pika 2d.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi i studentëve në vlerësimin përfundimtar realizohet me teza të printuara dhe zhvillohet në to ose me fletore të firmosur nga pedagogu. Nga vizita ne institucion, takim me student u konstatua që testimi dhe vlerësimi përfundimtar nuk zhvillohet në formë elektronike.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve realizohet nga një komision i posaçëm (zakonisht 2 anëtarë) i ngritur nga zv. Dekani për mësimin, në bazë të Rregullores së FBU <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 61/pika a</i> , ku njeri prej anëtarëve është dhe titullar moduli. Komisioni i Provimeve shpallet në Grafikon e Provimeve, që miratohet nga Dekani i FBU.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Testimi i vlerësimit të njohurive të dijeve realizohet me shkrim dhe/ose me gojë. Pjesa më e madhe e tezave, aty ku është e mundur, aplikojnë sistemin me alternativa, të cilat ndihmojnë në objektivitetin e vlerësimit. Nga vizita ne institucion, e GVJ, takim me student u konstatua që kontrolli i dijeve nuk zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim Sekretimi i provimeve do të ndihmonte në rritjen e objektivitetit të vlerësimit.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas shpalljes së rezultateve të provimeve, studenti ka të drejtë brenda 48 orëve të paraqitet para komisionit për të parë provimin që ka zhvilluar dhe të sqarohet në lidhje me pikët, si dhe të diskutohet mbi vlerësimin e tij. Gjatë kësaj procedure studentit i paraqiten përgjigjet korrekte, në rastet kur ai është përgjigjur gabim. Në këtë mënyrë ai informohet për mënyrën se si duhet të përgjigjet korrektësisht. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 64 pika b.</i>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Gjatë vitit, pedagogu i lëndës kryhen disa kontrole dijesh përmes testeve të ndërmjetme apo detyrave të kursit, kontrolli i detyrave të kursit realizohet nga pedagogu, në rastin kur detyra e kursit nuk pranohet dhe studenti vlerësohet negativisht, kjo mund të jetë penguese për hyrjen e studentit në provimin përfundimtar të rradhës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 58 pika b.</i> Gjatë provimit përfundimtar, komisioni monitoron studentin për të shmangur kopjimet dhe mund ta paraqesë dhe si student mbetës në rastet kur ai kapet duke kopjuar apo mashtruar me mjete ndihmëse jo te lejueshme. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 64 pika i.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimeve hidhen në sistem brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda tetë ditëve kalendarike kur provimi është me shkrim. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 64 pika a.</i> Vlerësimi i provimeve bëhet me pikë dhe më pas konvertohet me notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 55 pika a.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas përfundimit të provimit dhe korrigjimit të tij, studentit në sistemin e tij Esse3, i shfaqen pikët e marra në provimin përfundimtar, të cilat i shtohen pikëve që studenti ka marrë gjatë vitit. Brenda 48 orëve nga hedhja e pikëve në sistem, studentit i jepet e drejta të sqarojë për çdo paqartësi që mund të ketë ose të kundërshtojë rezultatin e provimit. Komisioni i provimit sqaron studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 64 pika b.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Në rast se studenti nuk është dakord me rezultatin e provimit dhe nuk bie dakord me vlerësimin përfundimtar të komisionit, ai ankimon këtë vlerësim. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit (nëse ka kontestim për mënyrën e zhvillimit të provimit ose trajtim jo të saktë ndaj tij apo studentëve të tjerë) dhe brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit të vlerësimit. Kjo ankesë paraqitet tek përgjegjësi i departamentit ku ai studion. Procedura e ndjekur në këto raste është transparente dhe e rregullt. Gjatë shqyrtimit të ankesës, thërriten për sqarime, përgjegjësi i departamentit përkatës, komisionin e provimit dhe vetë studenti. Dekani ka të drejtën e vlerësimit përfundimtar për të përcaktuar nëse ankesa është e drejtë apo jo dhe ti japë zgjidhjen përfundimtare çështjes. Procedura e ndjekur është transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 65.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

Standardi III.7



Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret Vlerësimi i ekspertëve



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al54

<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë në Master i Shkencave, në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Agroushqimore, mundëson thellimin e njohurive. Gjatë dy viteve të studimit, studenti merr njohuri të hollësishme, në lidhje me shumë aspekte të teknologjisë, si projektimin dhe zbatimin e proceseve teknologjike, në linjat pilot të përpunimit të qumështit, prodhimit të djathit, linja e prodhimit të vajit të ullirit, linja e prodhimit të verës, linja e përpunimit të drithit, prodhimit të bukës dhe produkteve konditore. Në këtë mënyrë zhvillon aftësitë profesionale e ato kërkimore e shkencore; implementimin e sistemeve të sigurisë ushqimore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 14.5 syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>FBU në kuadër të bashkëpunimeve me projekte ka filluar të aplikojë dhe module të edukimit në distancë, që rrisin potencialin e informimit të studentëve dhe nivelin e fleksibilitetit të programeve të studimit. Mobiliteti i studentëve është një formë për të zhvilluar aftësi të reja, rritja e mundësisë për punësim si dhe fitimi i eksperiencave internacionale, duke mundësuar komunikimin dhe ndërveprimin në gjuhë dhe kultura të huaja. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.2; 35.3;43.4 79.2</i></p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë MSh në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Agroushqimore, garanton zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet aplikimit të programeve në lëndën Inxhinieria Ushqimore, ku laboratorit është i pajisur me mjete kompiuterike që ndihmojnë në realizimin e seancave. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 39.1 dhe nr 55.4.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, analizohen në përfundim të lëndës si një shumatore e kontrollit të vazhduar. Elementët e kontrollit të vazhduar janë: frekuentimi, diskutimi në seminare, provimet ndërmjetese, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 5 neni 56, 57; dhe nr 14.8.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Personeli akademik në përfundim të modulit orienton studentin në lidhje me testimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të pyetjeve, pikët e testit final dhe informacione të tjera që studenti ka nevojë në lidhje me testimin final. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 65 pika 3.9.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik ka organizuar orë të hapura, me tema specifike të cilat kanë interes për studentët dhe për publikun e gjerë, në ambjentet e FBU.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në Programin e Studimit MSH në IAU - TAU, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash dhe u mundëson studentëve që njohuritë teorike t'i vënë në zbatim në laboratorët shkencore që disponon; si linja pilot të cilat ndihmojnë në prodhimin e produkteve të ndryshme ushqimore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 60. Nr 55 55.4.</i> Njësi bazë ka marrëveshje me bizneset apo me institucione shtetërore, të cilat ndihmojnë në realizimin e pjesës praktike të diplomave. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.1.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në</p>	<p>Personeli akademik për të mbështetur diskutimet dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara, përdor: Mbledhja e Asamblese së</p>



interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Fakultetit, ku diskutohen problematika të ndryshme në lidhje me programet mësimore, kërkimin shkencor, problematika të tjera që mund të dalin nga pyetësorët e studentëve dhe stafit akademik. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 81.</i> Mbledhje Dekanati, ku shyrtohen për miratim analizat vjetore të mësimit dhe kërkimit dhe probleme të tjera. Mbledhje Departamenti ku shyrtohen dhe diskutohen Raportet Vjetore të Mësimit dhe Kërkimit, puna e GMK, referohen punimet ndërmjetëse dhe përfundimtare të Doktoraturës, diskutohen çështje të organizimit të punës shkencore dhe mësimdhënies të programeve të studimit që mbulon Departamenti. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 69.</i>			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Personeli akademik, pjesë e kësaj njesie, krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative të cilat i paraqet dhe i diskuton në mbledhjet e GMK. Personeli akademik, ka nxitur idetë inovative të studentëve, në lidhje me teknologjitë e reja të prodhimit të produkteve ushqimore, duke i mbështetur me njohuri shkencore dhe inovative, të cilat vendosen në zbatim në rastin kur përdoren për përgatitjen e temave të diplomave apo për realizimin e artikujve shkencore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 43.7 dhe 35.4.</i> Institucioni i mbështet ato financiarisht, në lidhje me blerjen e lëndëve të para, materiale që duhen për realizimin e eksperimenteve. Institucioni mbështet dhe vë në dispozicion të studentëve pajisje laboratorike, linja pilot për prodhimin e produkteve të reja të propozuara prej tyre dhe të miratuara nga strukturat përgjegjëse.			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Për të rritur mundësinë e mobilitetit të studentëve, si dhe për të siguruar një tranzicion mësimnxënës më të lehtë nga një institucion në një tjetër, (brenda dhe jashtë vendit), personeli akademik kryen gjithashtu shkëmbim experiencë në mësim dhenie, me institucionet me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.2 35.3 nr 43.2 43.8 nr 79.2.</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Rregullat e përgatitjes së Tezës së Diplomës Master janë parashtruar shumë qartë në Rregulloren e Programit të Studimit MSH në IAU profili TAU, <i>Dokumenti i dorëzuar nr 7.1 neni 11.</i> Ky informacion është i njohur nga studentët para diplomimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion	Pedagogu udhëheqës vë në dispozicion të gjithë materialet didaktike, informacione shkencore, udhëzime si dhe materialet e nevojshme që do ti duhen studentit për realizimin e temës studimore. Ai e ndjek gjatë gjithë punës së tij, për ta ndihmuar si

të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	në pjesën teorike ashtu dhe në atë eksperimentale, në interpretimin e rezultateve si dhe në përpilimin e materialit përfundimtar. Komunikimi i tyre për shkëmbimin e informacioneve realizohet në kontakt të drejtpërdrejtë apo me e-mail.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në ciklin e dytë të studimeve, në MSH në Inxhinieri Agroushqimore, profili Teknologji Agroushqimore, provimi përfundimtar është mbrojtja e Tezës së Diplomës, e cila realizohet para një komisioni të propozuar nga Përgjegjësi i Departamentit, njeherësh dhe koordinatori i programit të studimit dhe miratuar nga Dekanati. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 14 pika 5h, neni 16 pika 18; nr 73.1.</i> Ky komision jo gjithnjë ka shkalle të gjere perfaqesimi, ne lidhje me modulet specifike ku bazohet permbajtja e tezes se diplomes. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 35.4.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Njesia bazë, angazhon një përfaqësues të personelit akademik, që të njohë studentët me të gjithë temat e diplomave të miratuara më parë dhe i orienton për mënyrën e përzgjedhjes së tyre.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në bazë të fushave të studimit që studenti ka përzgjedhur për realizimin e temës së diplomës, stafi i departamentit asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve, prodhimin e produkteve etj, si në mjediset universitare ashtu dhe jashtë saj. Stafi ndihmës akademik është gjithashtu në dispozicion të studentëve diplomantë për ti mbështetur dhe ndihmuar në realizimin e matjeve apo eksperimenteve të kryera në kuadrin e temës së diplomës. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 22.2.</i>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i Diplomës, ndihmon studentin, në përzgjedhjen e materialeve teorike, listën e analizave që do të realizojnë, metodikën e analizave. Gjithashtu pedagogu udhëheqës, garanton cilësinë e rezultateve, duke i krahasuar ato me standarde ose studime (në rast të mungesës së standardeve). Në fund të studimit, pasi të jenë mbaruar të gjitha analizat dhe eksperimentimet, studenti shkruan materialin, pjesën teorike dhe praktike, së bashku me rezultatet dhe literaturën e përdorur, sipas modelit të përshkruar në rregulloren e PS (<i>Dokumenti i dorëzuar nr 7_1 neni 11.</i>) Udhëheqësi vendos nëse materiali është korekt për tu paraqitur para komisionit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Studenti prezanton punën e tij para komisionit i cili propozohet nga koordinatori i programit dhe miratohet nga Dekani. Vlerësohet me notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 55</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në RVB: Pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse, studentit pajiset me diplomë "Master i Shkencave" në Inxhinieri Agroushqimore profili Teknologji Agroushqimore. Dokumenti i dorëzuar nr 15; të firmosur nga Dekani dhe Rektori i UBT. Format i Diplomës dhe i suplement është i paraqitur qartë në rregulloren e PS. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 87, 88.</i> Përgatitja e Diplomës realizohet nga Zyra e Studimit dhe Studentëve dhe zakonisht dorezohet në një ceremoni diplomimi që organizon Universiteti.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në	Në përfundim të programit të studimit, studentit i vihet në paiset me kopje të plotë të programit të studimit të zhvilluar, sipas


dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	një afati kohor të mirëpërcaktuar në rregullore. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 6.1 neni 103.</i>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Institucioni mban në formë të shkruar dhe elektronike këto dokumenta: regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Regjistrat depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me originalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. <i>Dokumenti i dorëzuar nr 5 neni 44.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të gjitha të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ përditësohen çdo vit akademik nga drejtuesit e GMK.</p> <p>Në këto të dhëna përfshihet angazhimi i personelit akademik në program dhe angazhimi i çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në Fakultet konstatohet që të gjitha dosjet për personelin akademik të rregullt dhe të angazhuar, ruhen në zyrat e Drejtorisë së burimeve njerëzore, dhe të njëjtat në vazhdimësi përditësohen.</p> <p><i>Dokument 11.3 – Rregullore e Burimeve njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Pas analizimit të dokumenteve GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë) dhe aktet e brendshme rregullatorë të institucionit.</p> <p><i>Dokument – Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015</i></p> <p><i>Dokument – Statuti i UBT</i></p> <p><i>Dokument 11.1 Rregullore e rekrutimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në UBT ndiqet procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike si dhe në websitin e institucionit.</p> <p>Procedura që ndiqet është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe është e përshkruar me detaje në rregulloren e rekrutimit dhe të institucionit. Në njoftim institucioni shpall ofertën e punës me kërkesat specifike që ka propozuar njësia bazë dhe dekanati, të miratuara nga titullari i institucionit.</p> <p>Po, sipas konstatimit gjatë vizitës, Institucioni respektivisht, Fakulteti (Departamentet) përpilojnë nevojat për staf, të cilat i dërgojnë në Rektorat për miratimin e tyre e mandej për publikimin e konkurseve.</p> <p><i>Dokument 11.1 - Rregullore e rekrutimit</i></p> <p><i>Dokument 11.3 – Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Institucioni zbaton Ligjin e Arsimit të Lartë për rekrutimin e punonjësve akademikë. Senati Akademik i UBT ka kritere bazë për rekrutimin e personelit dhe mënyra e vlerësimit të tyre, të cilat bëhen publike në çdo konkurs.</p> <p>UBT-ja ka përcaktuar modelin e procedurave të zhvillimit të konkurimit të rekrutimit të personelit akademik dhe joakademik si dhe ka caktuar edhe komisionin e rekrutimit sipas pozicionit të punës për çdo anëtar në mënyrë që të jetë në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>






	<i>Dokument 44.1 - UBT Formatii i dosjes personale</i> <i>Dokument 44.2 - Formatii i publikimit të kriterëve</i> <i>Dokument 44.3 --UBT Formatii i publikimit të ofertës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ konstatoi se UBT-ja angazhohet vazhdimisht për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë sa më profesionale. UBT-ja angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, duke i dhënë mundësi për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit. Personeli është i përfshirë në projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore. Mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi, në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit dhe riintegrimi i tyre në radhët e personelit akademik. Fakulteti ka një eksperiencë të mirë në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij. Konsatojm se një pjesë e konsiderueshme e Stafit akademik dhe të studentëve në kuadër të projekteve CEEPUS dhe Erasmus + i shfytëzonin këto mundësi me qëllim të avancimit të metodologjisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies nga stafi akademik, derisa studentët kishin mundësinë e përfitimit të përvojave në Institucionet ndërkombëtare. <i>Dokument 42_1 Të dhëna për infrastrukturën MSH IAU-TAU</i> <i>Dokument 42_4 Ambjentet e FBU, Shërbimet që ofrohen</i> <i>Dokument 6. Rregullore e Brendshme e Departamentit të Teknologjisë Agrorshqimore (hardcopy tek dosja)</i> <i>Dokument 6_1 Rregullore FBU (2017)</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Pas analizimit të dokumenteve GVJ konstaton se UBT posedon Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në kuadër të projekteve Tempus Fakulteti dhe departamenti ka pasur mundësinë të zhvillojë disa trajnime për metodat inovative të mësimdhënies (I-Learning). Gjatë vizitës në Fakultet u vërtetua se në disa lëndë përdorshin metoda të reja në mësimdhënie. <i>Dokument 6_1 Rregullore FBU (2017)</i> <i>Dokument 39. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i> <i>Dokument 43_1 Kualifikimi stafit me grada&tituj 2013-2018.</i> <i>Dokument 43_6 Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin për Stafin Akademik MSH IAU-TAU 2013-2018</i>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e	Nga takimi me stafin akademike GVJ konstaton se UBT-ja realizon veprimtarinë kërkimore dhe shkencore përmes angazhimit të stafit akademik me kohë të plotë, por numri i pedagogëve të ftuar

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al60

objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>është i kufizuar. Stafit me kohë të plotë përbën pjesën më të madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Personeli akademik që angazhohet në veprimtarinë mësimore dhe shkencore është pjesë e ekipit që ka hartuar programin mësimor.</p> <p><i>Dokument 56_1. Kontrata për profesorët e fuar</i> <i>Dokument 56_2 Kontrata individ.e punes me pershkrimin e punës Nr 3 Prot, date 01.01.2012</i> <i>Dokument 74. Leksione të hapura nga profesorët të fuar</i> <i>Dokument 34_1 Listë biznesesh bashkëpunuese me FBU 2018</i> <i>Dokument 34_2. Template marrveshje bashkëpunimi</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Pas vizitës së mjediseve për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike GVJ konstaton se UBT zhvillon veprimtarinë e tij në objekte të ndërtuara në periudha kohore të ndryshme bazuar mbi standartet e ndërtimit të periudhave përkatëse dhe janë në rinovim e sipër të mjediseve mësimore. Për realizimin e procesit mësimor UBT-ja ka vënë në dispozicion të gjitha mjediset e universitetit. Në fillim të çdo semestri hartohet orari mësimor në të cilin detajohen mjediset mësimore se ku do të zhvillohen konkretisht leksionet, praktikat laboratorike, seminarët, etj.</p> <p><i>Dokument 42_1 Të dhëna për infrastrukturën MSH IAU-TAU.</i> <i>Dokument 42_4 Ambjentetet e FBU, Shërbimet që ofrohen</i> <i>Dokument 42_3 Raporti i ekspertit</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Gjatë vizitës së klasave, laboratorëve dhe mjediseve të tjera GVJ konstaton se shumica e mjediseve mësimore në Fakultet - Departament, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><i>Dokument 39. Udhëzues në nivel institucional për zvrillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies</i></p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Fakulteti - Departamenti posedon disa laboratorë didaktike dhe shkencore që mundësojnë aftësim të studentëve në drejtim të shprehive praktike brenda mjediseve të universitetit dhe përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave të programit të studimit në tërësi.</p>
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al61

profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Studentët e UBT-së kanë në dispozicion: laboratorë informatike, sallë vidiokonferencash, laboratorë të gjuhëve të huaja. <i>Dokument 39_1 Programe kompjuterike mësimdhënie MSH në IAUT-TAU</i> <i>Dokument 55 Pajisje të Laboratorëve</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Nga dokumentet e analizuar GVJ konstaton se UBT për disa vite ka bashkëpunime me institucione shtetërore dhe subjekte private me të cilat ka nënshkruar marrëveshje të posaçme të bashkëpunimit, për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Krahas marrëveshjeve të UBT, të cilat janë në rang institucional, Fakulteti – Departamenti në vite ka krijuar kontakte individuale me partnerë të ndryshëm shtetërorë dhe privatë, ish studentë që tani punojnë në institucione shtetërore si; ISUV, MBZHR, AKU, etj., me sipërmarrës të kompanive të ndryshme specifike në fushën e Teknologjisë Agrorëshqimore, disa nga marrëveshjet janë në dokumentat bashkangjitur në RVB. <i>Dokument 55 Pajisje të Laboratorëve dhe Dok 60</i> <i>Dokument 42_1 Të dhëna për infrastrukturën MSH IAU-TAU.</i> <i>Dokument 7_1 Rregullore e MSH në IAU-TAU</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Pas vizitës së bibliotekës GVJ konstaton se biblioteka Shkencore është në dispozicion të studentëve, me cilësi të mirë dhe për të mbështetur kërkimin shkencor, të mësuarit dhe mësimdhënien. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura, të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë edhe nga studentët e programit të studimit MSH në IAU - TAU. <i>Dokument 45_4 Biblioteka Elektronike Screenshot Model</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në bazë të vizitës dhe takimit me përgjegjësen e bibliotekës, UBT-së është e pajisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Por, duhet pasuruar me botime të reja dhe specifike për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarisë mësimore të programit të studimit MSH në IAU - TAU. <i>Dokument 45_2 Materiale didaktike të MSC 2018-2019</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ofron informacione online (pa pagesë) nga burimet elektronike nga projekte të ndryshme. Në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Network Support Services” (LNSS), janë pjesë e platformës Springshare LNSS, një platformë online, me burime informacioni shumë të pasura: https://lnss-albania.libguides.com/. Gjithashtu, për të përcjellë informacionin kudo dhe kurdo, është krijuar në masën më të madhe katalogu online i Bibliotekës: http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss <i>Dokument 45_3 Projekti i librit Elektronik.</i> <i>Dokument 45_5. Online Catalog i Librarisë Universitare</i> <i>Dokument 45_6 Informacioni i përgjithshëm mbi Bibliotekën</i></p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Burimi kryesor i informacionit është kryesisht bibliografik (libra, postera, harta, CD-ROM), sikundër edhe shërbim në version on-line në funksion të shfrytëzimit pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. Salla e studimit dhe e kompjuterave për studentët ka një kapacitet 50 poste. Posedon disa kompjutera në gjendje të mirë pune. Studentët mund të studiojnë me materialet e tyre, si dhe mund të punojnë në grup për detyrat e kursit dhe projektet që kanë në programin mësimor. <i>Dokument 45_4 Biblioteka Elektronike Screenshot Model</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka Shkencore "Mentor Përmeti" disponon adresën në kuadër të UBT (biblioteka@ubt.edu.al) me anën e së cilës ka mundësi të dërgojë informacion simultan tek i gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik. Informacionet e dërguara janë të lidhura me titujt e ri në bibliotekë të literaturës në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Janë një ndihmesë shumë e madhe për përditësimin e literaturës në kuadër të programeve mësimore por edhe të punës kërkimore. <i>Dokument 43_4 Listë e projekteve të FBU</i> <i>Dokument 49-50 Plan Financiar dhe Shpenzime faktike FBU</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka është e hapur nga e Hënë në të Premte 8.00 – 16.00, oraret e saj janë publike dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit. Salla e librit tekniko-shkencor ka një kapacitet 35 poste; studentë të anëtarësuar 862; pedagogë të anëtarësuar 208; staf ndihmës akademik dhe administrativ 76. Frekuentimi mujor rreth 400-500 përdorues në muaj. <i>Dokument 45_6 Biblioteka-Informacioni i përgjithshëm</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Standardi IV.5


Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi</p>	<p>GVJ konstaton se UBT disponon sistem menaxhimi të informacionit të saj nëpërmjet të cilit administron çdo gjë që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Universiteti ka një</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al63



<p>deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>bashkëpunim me AKP (duke realizuar regjistrimin e studentëve nga ZSS në sistemin e AKP http://qsha.gov.al/akp/ për të vazhduar më pas me pajisjen e tyre me NIM. Gjithashtu UBT ka marrëveshje me RASH https://ëëë.rash.al/sq/ me anë të së cilës realizon menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave. <i>Dokument 5 Rregullore e Studimeve UBT 2017 neni,33,36,37,38;</i> <i>Dokument 6_1, neni 39,40,41;</i> <i>Dokument 9_1 Rregullore e ZSS KreuV, Kreu VI; 7_1, neni3,4</i> <i>Dokument 9_2 Rregullore e DIOKS</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>UBT disponon sisteme të integruara informacioni si Universiteti i parë pilot bashkëpunues në projektin e RASH. Ky projekt garanton sisteme të menaxhimit gjithëpërfshirës të informacionit duke mundësuar sigurimin e informacionit strategjik, duke kombinuar aplikacionet kryesore administrative si: të mësuarit dhe studenti, kërkimin, burimet njerëzore, kontabiliteti, etj. <i>Dokument 30_1 Komisioni i Sigurisë dhe Cilësisë FBU</i> <i>Dokument 30_3 Grupi i Punës Sig.Cil. FBU 2014</i> <i>Dokument 6_1, Rregullore e FBU 2017, Neni9, Neni 15,Neni 16</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ ka verifikuar se UBT ka faqen e tij zyrtare (ëëë.ubt.edu.al), në të cilën jepet informacion për Fakultetet, ciklet dhe programet e studimit që ofron, shkollën e doktoratës, revistën shkencore, librarinë, Statutin dhe Rregulloret e funksionimit të tij, të dhëna statistikore për numrin e studentëve, të dhëna për stafin akademik, njoftime, etj. Aplikacionet Esse 3 janë lehtësisht të aksesueshme nga personeli akademik dhe nga studentët. Gjithashtu UBT ka site për Departamentet dhe pedagogët. (https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/). Personeli akademik përgatit dhe vendos informacione dhe dokumente të lidhura me programin mësimor MSHMB, leksione, skripte, video, etj. https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/magdalena-cara/. <i>Dokument 39 Udhëzues institucional për met.inovative në mësimdhënie</i> <i>Dokument 46-47 Udhëzues IT</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit elektronik mundëson vendosjen e teksteve në word, krijimin e menuve sipas organizimit vetiak të çdo pedagogu, “upload” dhe “download” e materialeve të ndryshme në word, “power point”, pdf, video, etj. Studentët kanë mundësi të hyjnë në këto site dhe të “download” materialet gjithashtu kanë mundësinë të bëjnë komente brenda siteve të pedagogut. <i>Dokument 59 Site i pedagogut</i> <i>Dokument 54_1 Planet kalendare shqip</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Informacionet e hedhura nga Fakulteti - Departamenti dhe personeli akademik i tij në “site pedagog UBT”, “ESSE3”, etj. si psh.: Raportet Mësimore e Kërkimore, Pyetorët, leksionet, vlerësimet gjatë vitit, vlerësimi përfundimtar, etj. janë vizibël në kohë reale, ato janë gjithashtu të aksesueshme nga studentët dhe organet drejtuese dhe titullarët. <i>Dokument 54_1 Planet kalendare shqip</i> <i>Dokument 61 Regjistri i pedagogut</i></p>



	<i>Dokument 58 Shembull axhenda javore+mujore ne DTAU</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen e internetit (www.ubt.edu.al) dhe në sitin (pedagogë ubt) ka informata për personelin akademik, CV akademike, programin e studimit si dhe leksionet, në gjuhën shqipe dhe angleze. https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/magdalena-cara/home/leksione-ne-anglisht. Gjithashtu edhe informacioni për projektet është në të dyja gjuhët. <i>Dokument 47 1 Struktura e faqes zyrtare të UBT</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nis	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në çdo fundvit FBU harton një plan buxheti financiar të shpenzimeve për vitin në vazhdim. Në këtë plan financiar pasqyrohet parashikimi i te ardhurave nga buxheti i shtetit, si dhe parashikimi i te ardhurave dytësore që mblidhen nga tarifat e shkollimit. Informacionet e nevojshme Departamenti i merr nëpërmjet dekanatit dhe Administratorit të UBT dhe Fakultetit. <i>Dokument 49-50 Plani Financiar dhe Shpenzimet</i> <i>Dokument 6 1, Rregullore e FBU 2017, Neni 16</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit të programit të studimit MSH në IAU - TAU përmban dy kollona kryesore: të ardhurat dhe shpenzimet. Në bazë të dokumentit mjetet për investime janë të vogla dhe nuk figurojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, pajisjeve laboratorike, kimikateve, reagentëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line. Financimi i kërkimit shkencor është realizuar edhe përmes projekteve të perbashketa apo financimeve nga projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Keshtu janë shfrytëzuar projekte IPA (Linja e prodhimit të djathrave), projekte me BE (Linja e vazhduar e përpunimit të qumshtit), Erasmus +Project NETCHEM: “ict networking for overcoming technical and social barriers in instrumental analytical chemistry education” (Laboratori i Inxhinjerise Ushqimore) <i>Dokument 4 Strategjia e zhvillimit të PS MSH në IAU-TAU</i> <i>Dokument 43_4 Listë e Projekteve në FBU</i> <i>Dokument 60 Linjat Pilot Foto+inventare</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar	UBT-ja kryen auditim të përvitshëm të brendshëm, duke përgatitur një pasqyrë të qartë të situatës financiare për përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al65






përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<i>Dokument 2 Statuti i UBT miratuar 2018</i>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Analizat financiare dhe raportet e institucionit realizohen nga zyra e financave të UBT. Analizat dhe Raportet financiare raportohen në rektorat, senat akademik, dhe miratimi përfundimtar bëhet në Bordin e Administrimit. <i>Dokument 76 Raporti Financiar i UBT 2017</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Drejtoria e Financave – Kontabilitetit, UBT-ja ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit MSH në IAU - TAU.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, por dhe nga intervistat me Zyrat e Karrierës së Studentëve (ZKS) se aplikohen politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik për këtë program studimi, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto politika dhe procedura janë shprehur mjaft qartë në Statutin e UBT-së dhe në Rregulloren e Studimeve të UBT-së.</p> <p><i>Dokument 5 Rregullore e studimeve UBT</i> <i>Dokument 9_1 Rregullore e ZSS</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se nga intervistat me ZSS dhe studentët, rezultojnë se të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk vërehen raste të diskriminimit gjinor, racor, fetar etj.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>I gjithë informacioni në lidhje me këtë çështje është i bërë publik. Ky informacioni i nevojshëm mund të gjendet në uebsite-n e Fakultetit, Departamentit, profilet e pedagogëve etj. Konstatohet qartë se QKA realizon në mënyrë periodike këshillim të studentëve në varësi të nevojave të tyre profesionale.</p> <p><i>Dokument 7_1 Rregullore e Studimeve MSH në IAU Profili TAU</i> <i>Dokument 39 Udhëzues institucional për metodat inovative mësimdhënie</i> <i>Dokument 46-47 Udhëzues IT UBT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton qartë nga rregullorja e brendshme e Departamenti dhe me rregulloren e programit të studimit MSH në IAU - TAU, se kriteret për përfshirjen në këtë program studimi janë të paraqitura në mënyrë të detajuar. Bazuar në Rregulloren e MSH në IAU-TAU njësia ofruese e programit të studimit harton kriteret specifike dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në ciklin e II të studimit. Kriteret bëhen publike nga Fakulteti në uebsite. FBU ka vendosur si prag pranimi në Programin Master i Shkencave notën 7.5. Në rast se ka ende kuota të lira, nuk do përjashtohen aplikantët me mesatare më të ulët, por jo me të ulët se nota 6.5.</p> <p><i>Dokument 7_1 Rregullore e Studimeve MSH në IAU Profili TAU</i> <i>Dokument 47_1 Struktura e faqes zyrtare UBT</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Rezultojnë se QKA përgjegjëse për këtë program studimi disponon numra kontakti në të gjitha rrethet e Shqipërisë, të cilët angazhohen dhe informojnë nxënësit e shkollave të mesme mbi këtë program studimi dhe çdo element tjetër të domosdoshëm.</p> <p><i>Dokument 51_1.1 Broshurë Programet e Studimit UBT</i> <i>Dokument 51_1.2 Fletë Palosje Qendra e Karrierës</i></p>



	<p><i>Dokument 51_1.4 Fletëpalosje e FBU</i> <i>Dokument 51_1.5 Fletëpalosje e UBT</i> <i>Dokument 51_1.6 Marketingu – Faqja WEB FBU</i> <i>Dokument 51_1.7 Faqe Facebook FBU</i> <i>Dokument 51_1.8 Guida e studimeve FBU</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Konstatohet se ky informacion është publik dhe paraqitet në Rregulloret e Fakultetit dhe Departamentit, Rregullores së programit të studimit MSH në IAU - TAU dhe nëpërmjet dokumentave të publikuara dhe të përditësuara.</p> <p><i>Dokument 5 Rregullore e studimeve UBT</i> <i>Dokument 6_1 Rregullore FBU</i> <i>Dokument 7_1 Rregullore e PS në IAU Profili TAU</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Konstatohet se i gjithë informacioni mbi kriteret e pranimit të studentëve, rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, etj është publik dhe paraqitet në Rregulloret e Fakultetit dhe Departamentit si dhe rregullores së studimeve të UBT-së.</p> <p>Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me ligjin e AL, akte të tjera nënligjore dhe <i>Rregulloren e FBU 6-1 neni 68</i>.</p> <p>FBU ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitetet të tjera, sipas procedurave të parashikuara në këtë <i>Rregullore 6_1 neni 69</i>. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve apo të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre nëpërmjet <i>ZSS 9_1, Kreu V, Kreu VI</i> në nivel universiteti dhe nga ZKS në nivel Fakulteti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se këto janë elementë që rezultojnë të paraqitura mjaft qartë në rregulloren e programit të studim MSH në IAU - TAU.</p> <p>Studentit i lind e drejta e hyrjes në provim, pasi pedagogu i disiplinës ia ka komunikuar atij këtë të drejtë në orën e fundit të mësimit. Gjithashtu emrat e studentëve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e disiplinës pasqyrohen në Pasqyrën e Rezultateve të Detyrimeve dhe Provimit <i>5 Rregullore e studimeve UBT, neni 55, neni56, neni 57, neni 58, neni 59</i>, një kopje të së</p>

	cilës e dorëzon në sekretarinë e ZKS që nënshkruhet nga sekretarja përkatëse e ZSS-së, Përgjegjësi i ZSS-së, përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët që përbëjnë komisionin e provimit. Kjo pasqyrë mban vulën e ZSS-së 5 Aneksi 4; 78. Studentët që nuk kanë hyrë në provim për shkak të mos realizimit të detyrës apo projektit të kursit kanë të drejtë të bëjnë shlyerjet e tyre në javën e parë të shtatorit. Informimi i studentëve lidhur me vlerësimin e dijeve bëhet nëpërmjet sistemit ESSE3 <i>Dokument 46-47/47_3 IT</i> , ku studentët kryejnë veprimet dhe marrin informacion në llogaritë e tyre.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Konstatohet se ky informacion është publik dhe paraqitet në Rregulloret e Fakultetit dhe Departamentit si dhe rregullores së studimeve të UBT-së. <i>Dokument 15 Modeli i Diplomës MSH</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Konstatohet se institucioni aplikon forma të ndryshme për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit si postera, fletëpalosje me qëllim thithjen e studentëve me mesatare më të lartë. Këto aktivitete pohohen dhe nga intervista me stafin akademik të Departamentit dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga intervistat me studentët u pohua se ata informohen që në fillim të studimeve në lidhje me shumë çështje që kanë lidhje me këtë program studimi. Gjatë intervistave ata theksojnë se nuk e kanë të qartë nëse në vijim do të ketë ndonjë lëndë me zgjedhje, dhe se do të dëshironin që në program të kishte të tilla lëndë. <i>Dokument 14_1 Kurrikula e FBU 2018-2019</i> <i>Dokument 14_3 Kurrikula MSH nw IAU Profili TAU</i> <i>Dokument 14_5 Programet e lëndës sipas VKM nr.41 Shqip</i> <i>Dokument 47_1 Struktura e faqes zyrtare UBT</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga intervistat me studentët u pohua se ata janë të informuar mbi përmbajtjen e lëndës, ndarjen në module, shpërndarjen e krediteve, personelin akademik përgjegjës për secilin modul, mënyrën e shlyerjes së lëndës etj. GVJ konstaton se Departamenti ka përgatitur dhe një 'Guidë Informuese për programin ku paraqiten informacione mbi misionin, vizionin dhe modulet, përmbajtjen e tyre, stafin akademik, etj. <i>Dokument 51_1.1 Broshurë Programet e Studimit UBT</i>



	<p><i>Dokument 51_1.4 Fletë Palosje e FBU</i> <i>Dokument 51_1.8 Guida e Studimeve në FBU</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Rezultoni se QKA jep informacione të vazhdueshme në lidhje me mundësitë për punësim dhe orientimin drejt tregut të punës nëpërmjet ftesës që i bëhet studentëve për pjesëmarrje në panairin e karrierës. Por, konstatohet dhe pohohet dhe nga punonjësit e QKA-së se pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete është e ulët.</p> <p><i>Dokument 18 Studimi Periodik për Tregun e Punës pas diplomimit</i> <i>Dokument 34 Shembull marrveshje bashkëpunimi</i> <i>Dokument 34_1 Listë biznesesh bashkëpunuese</i> <i>Dokument 34_2 Template marrveshje bashkëpunimi</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë intervistave nga studentët u pohua se ata janë plotësisht të informuar nga institucioni në lidhje me këto çështje dhe asistohen për informim të vazhdueshëm.</p> <p>https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/auth/studente/</p> <p><i>Dokument 9_1 Rregullore e ZSS</i> <i>Dokument 26_2 Screenshot faqe WEB Kurrikula e studimeve FBU</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Konstatohet se studentët disponojnë llogaritë e tyre elektronike nëpërmjet të cilave mund të marrin të gjitha informacionet e duhura në portalin elektronik. Nga studentët u pohua se ata përdorin ëbesite-in dhe profilet individuale të pedagogëve për të marrë informacionet e nevojshme.</p> <p><i>Dokument 47_1 Struktura e faqes zyrtare UBT</i> <i>Dokument 26_2 Screenshot faqe WEB Kurrikula e studimeve FBU</i></p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>GVJ konstaton se platforma ESSE 3 funksionon me efikasitet edhe për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit mësimor të studentëve.</p> <p>https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/auth/studente/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës rezultoi se mbahen me korrektesë dhe përpikmëri të plotë të gjitha statistikat e nevojshme për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në ZSS dhe sekretarinë mësimore, konstatohet se e gjithë puna për të përmbushur të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al70


<p>e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>gjithë këto elementë ishte e realizuar në mënyrë mjaft korrekte dhe tepër të saktë.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në UBT kreu vizitë edhe në Sekretarinë mësimore ku u panë rregjistrat e amzës, rregjistri i notave, rregjistri i diplomimit.</p> <p>Sipas rregjistrat të amzës por edhe të dhënve të paraqitura në RVB, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentë të rregjistruar në vitin akademik 2016-2017 janë 13 studentë të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë, të gjithë të matrikulluar. Nuk ka studentë të çrregjistruar apo të larguar. - Studentë të rregjistruar në vitin akademik 2017-2018 janë 23 studentë të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë. 2 studentë akoma nuk janë matrikulluar pasi nga QSHA është kërkuar diploma e Bsc e këtyre studentëve. Nuk ka studentë të çrregjistruar apo të larguar. - Studentë të rregjistruar në vitin akademik 2018-2019 janë 22 studentë të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë. 6 studentë akoma nuk janë matrikulluar (1 studenti i kërkohet diploma e Bsc nga QSHA ndërsa 5 studentë janë nga trojet dhe e kanë diplomë për njehsim në MASR). Nuk ka studentë të çrregjistruar apo të larguar <p>Studentë aktualë që ndjekin këtë program studimi janë 45 + 6 studentë të mbartur = 51 studentë.</p> <p>ZSS disponon regjistra bazë për të dhënat personale të studentëve (që nga krijimi i tij në 1951 në formë shkresore) dhe që nga 2007 i disponon ato në formë shkresore dhe elektronike 27_1; Ref.27_2; 27_3; 27.4; 27_5;27_6; 28.</p> <p><i>Dokument 9_1 Rregullore e ZSS</i> <i>Dokument 27_1 Studentë të diplomuar 2013-2018</i> <i>Dokument 27_2 Studentë të çrregjistruar 2014-2019</i> <i>Dokument 27_3 Studentë të regjistruar 2014-2019</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Konstatohet se edhe kjo çështje realizohet me korrektesë të lartë nga ZSS dhe sekretaria mësimore.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga intervistat vihet re se edhe sekretaria mësimore përdor sistemin ESSE 3 për ruajtjen e të dhënave, një platformë që, siç u pohua edhe nga intervistat, rezulton tepër efikase dhe e sigurtë në përdorim.</p> <p><i>Dokument 27_1 Studentë të diplomuar 2013-2018</i> <i>Dokument 27_2 Studentë të c"regjistruar 2014-2019</i> <i>Dokument 27_3 Studentë të regjistruar 2014-2019</i> <i>Dokument 27_5 Nota mestare e studentëve në hyrje në MSH</i> <i>Dokument 27_6 Nota mesatare e studentëve të MSH në përfundim të studimeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e</p>	<p>Konstatohet se Qendra e Karrierës dhe Alumni përgatit; "Raportin e performancës së QKA". raport që përgatitet në bashkëpunim me personelin akademik të Departamentit.</p>

cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<i>Dokument 3_3 Raport i Vlerësimit të Brendshëm FBU 2018</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të IAL-ve në fuqi. Nga intervistat me studentët ata pohojnë se në grupin e tyre nuk kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në statutin e UBT-së garantohej pjesëmarrja e studentëve në senat dhe konkretisht në masën 10% (dhjetë për qind) të numrit të studentëve. Konstatohet se edhe në Rregulloren e Fakultetit parashikohet formimi, organizimi dhe funksionimi i këshillave të studentëve. <i>Dokument 3_3 Raport i Vlerësimit të Brendshëm FBU 2018</i> <i>Dokument 6_1 Rregullore e FBU</i>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në hartimin e programit të studimit FBU merr parasysh ngarkesën akademike në bazë të Plotësimit të krediteve të fituara sipas kurrikulës. Për studentët që vijnë nga programe të tjera studimi FBU bën ekuivalentimin e moduleve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm nga të interesuarit, përcatuar në <i>Rregulloren e FBU 6_1, neni67, neni68, neni69, neni70, neni71, neni 72 dhe neni73, neni 74, neni 75, neni 76, neni77, neni78, neni 79.</i> Në Rregulloren e FBU përcaktohen kushtet e kalimit në vitin pasardhës brenda programit të studimit. Studentët kanë lehtësi në procedurat burokratike dhe favorizohet përparimi brenda programit të studimit sipas meritës <i>6_1 Rregullore e FBU, neni28.</i>
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nga shqyrtimi i procedurës së rishikimit të kurrikulës rezultojnë se në këtë proces angazhohen edhe përfaqësues të studentëve të këtij programi studimi. Nga intervistat me studentët ata pohojnë se në grupin e tyre kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë. <i>Dokument 72 Këshilli studentor</i>

<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Gjatë intervistave, nga studentët u pohua se atyre u jepet mundësia e shprehjes mbi çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me procesin mësimor, por edhe me atë të etikës në sjellje dhe komunikim, të ankimimit të rezultatit etj. Nga studentët u pohua se gjithmonë kanë pasur reagimin e duhur institucional në rast kur haseshin problematika të caktuara.</p> <p><i>Dokument 6_1 Rregullore e FBU</i> <i>Dokument 40 Pyetesor i studentëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik se pjesëmarrja në konferenca dhe në botime është mjaft e lartë. Këto punime shkencore të cilat rezultojnë në përputhje me fushën specifike të kërkimit shkencor të secilit anëtar të personelit akademik.</p> <p><i>Dokument 43_6 Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin për Stafin Akademik MSH IAU-TAU 2013-2018</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Konstatojmë që Fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi me Univeritete të tjera. Stafit Akademik e gjithashtu edhe studentët janë pjesë e partneritetit me institucionet ndërkombëtare në kuadër të Projekteve Erasmus + dhe CEEPUS, me qëllim të zhvillimit të metodologjisë mësimore dhe marrjes së eksperiencave, si me Universitetin e Hohenheimit, Universitetin Moliosa të Milanos etj.</p> <p><i>Dokument 14_10 Krahasimi kurrikulave të PS me universitete europiane</i> <i>Dokument 21_2 CV Pedagogë të ftuar English</i> <i>Dokument 22_1 CV Staf ndihmës akademik</i> <i>Dokument 32 Marrveshje e FBU me institucionet</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti vazhdimisht inkurajon studentët për pjesëmarrje në konferenca shkencore. http://ubt.edu.al/sq/event/konferenca-e-gjashte-e-studenteve-te-universitetit-bujqesor-te-tiranes/ Në RVB theksohet se studentët inkurajohen edhe për botime në revista shkencore, por dokumenti nuk paraqet një artikull të botuar (siç thuhet në RVB).</p> <p><i>Dokument 35_1 Temat e diplomave MSH 2016-2018</i> <i>Dokument 51_1.3 Konferenca VI studentore UBT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit</p>	<p>Nga intervistat me stafin GVJ konstaton se institucioni nuk mbështet financiarisht pjesëmarrje në konferenca apo publikime në revista shkencore. Ata shprehen se do të dëshironin shumë që të gjendej ndonjë mundësi nga institucioni për mbështetje financiare,</p>

akademik të institucionit dhe studentëve.	sigurisht pasi punimi shkencor ti ishte nënshtruar një vlerësimi institucional. <i>Dokument 38_3 Analiza-Kërkimit Indikatorët e cilësisë_2018</i> <i>Dokument 43_6 Të dhëna të plota për kualifikimin dhe kërkimin për Stafin Akademik MSH IAU-TAU 2013-2018</i>			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Personeli akademik i Departamentit u shpreh se ata motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. Nga intervistat me studentët ata shprehen se nuk i kanë shumë të qarta këto koncepte. <i>Dokument 43_4 Listë e projekteve të FBU</i> <i>Dokument 43_7 Thirrje e Projektit IPA</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Gjatë intervistave studentët u shprehën në mënyrë unanime se të gjithë anëtarët e personelit akademik ofrojnë asistencën e nevojshme dhe vënë në dispozicion të studentëve të gjitha mjediset laboratorike që ata disponojnë në shërbim të kryerjes së matjeve, analizave, për punën laboratorike si dhe përpunimin e rezultateve të marra nga ekperimenti i tyre shkencor. <i>Dokument 24 Tabela stafi akademik Prog MSH ne IAU-TAU 2014-2019</i> <i>Dokument 43_6 Te dhena te plota per kualifikimin dhe kërkimin per Stafin Akademik MSH IAU-TAU 2013-2018</i> <i>Dokument 22_1 CV Staf ndihmës akademik</i> <i>Dokument 22_2 Përshkrim Pune staf ndihmës</i> <i>Dokument 22_3 Lista e stafit ndihmës akademik per prog e MSH ne IAU-TAU</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ konstaton se UBT ka në vizionin dhe misionin e tij bashkëpunimin e vazhdueshëm me organizmat shkencorë, kombëtarë. Kjo reflektohet mjaft qartë në dokumentin ‘Strategjia e Kërkimit dhe Shkencor’ e cila është hartuar mbi bazën e praktikave më të mira të deritanishme duke reflektuar prioritetet kombëtare dhe Direktivat Europiane të Horizon 2020 të Kërkimit dhe Zhvillimit në sektorët relevantë të UBT-së për të siguruar një fuqizim të punës shkencore në departament por jo vetëm, duke synuar kërkimin e integruar ndër sektorial. <i>Dokument 35_1 Temat e diplomave MSH 2016-2018</i> <i>Dokument 35_2 Studentë Erasmus Molise</i> <i>Dokument 35_3 Studentë Erasmus Milano</i>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe	GVJ mendon se nga informacioni i grumbulluar dhe i shqyrtuar në mënyrë tërësore, ky program studimi krijon mundësi shumë të mira dhe siguron diplomimin e studentëve me aftësi të larta

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al74

<p>përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>teorike dhe praktike, të cilët janë kandidatë shumë potencialë për vijimin e ciklit të tretë të studimeve në këtë drejtim shkencor.</p> <p><i>Dokument 42_1 Të dhëna për infrastrukturën MSH në IAU-TAU</i> <i>Dokument 45 Biblioteka</i> <i>Dokument 60 Linja Pilot Foto+Inventare</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit TAU u shpreh se Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p> <p>FBU dhe UBT në sajë të projekteve të ndërmarra, mbështet dhe promovon stafin akademik për kualifikime afatgjata apo afatshkurtra në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në të gjitha këto raste kjo kategori nënshkruan një kontratë me institucionin për periudhën e kualifikimit 2, neni 52. Në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie, Universiteti ka marrë pjesë në projektet Netchem, Erasmus Mundus, Erasmus Plus, ku është mundur mobiliteti i stafit, kryesisht me moshë të re.</p> <p><i>Dokument 43_2 Levizje te stafit akademik FBU 2014-2018</i> <i>Dokument 43_4 Liste e projekteve të FBU</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit TAU shprehet se në kuadrin e projekteve që koordinon Departamenti ka një rrjet të gjerë kërkuesish.</p> <p>Nuk ka patur kërkues shkencorë të huaj në FBU.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se numri i mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS për studentët është i lartë. Studentët u shprehën se ata janë të inkurajuar vazhdimisht për aplikime të tilla.</p> <p>Prania e një numri të madh studentësh (sipas programeve të studimit) të angazhuar në Projektet IPA, ERASMUS+, HORIZON2020, Marrëveshje Bilaterale, ka përbërë një sjellje strategjike konstante në veprimtarinë menaxhuese të FBU. Në vitin 2016–2018 u realizuan shumë mobilitete për studentët dhe kjo përbën një tjetër mundësi më shumë për mbështetjen e programit të studimit që ofron FBU.</p> <p><i>Dokument 35_2 Studentë Erasmus Molise</i> <i>Dokument 35_3 Studentë Erasmus Milano</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Në lidhje me këtë çështje, personeli akademik i Departamentit TAU u shpreh se ka pasur pjesëmarrje të larta nga personel akademik apo studentë të huaj. FBU në mënyrë të vazhdueshme ka pasur bashkëpunim me universitete të tjera duke kryer këmbim eksperiencash në nivel profesorati. Prej vitesh anëtarë të stafit të FBU janë lektorë në universitetet e shteteve fqinjë në kuadër të Programeve Erasmus⁸. Në kuadër të mobiliteteve të studentëve në vitin 2018 një student nga Universiteti Pammukale, Denisli, Turqi, programit Erasmus+, ka kryer punimet e Tezës Master pranë Departamentit të Teknologjisë Agrorshqimore, Laboratori i Drithërave dhe Produkteve të Pjekjes</p> <p><i>Dokument 79_1 Exchange Studenti nga Pammukale University.</i></p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në bazë të LAL (L. 80/2015: Neni 104, Pika 1), UBT është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në përputhje me Statutin e saj në Kreun II “UBT_Struktura Organizative, të Drejta & Detyrime” në skemën e strukturës jepet: “Zyra e Sigurimit të Cilësisë & Vlerësimit Institucional” si një nga strukturat kryesore të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në Rregulloren e UBT dhe në Rregulloren e FBU, DTAU dhe të programit të studimit MSH në IAU - TAU janë të reflektura strukturat kryesore të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Dokument 2 Statuti i UBT</i> <i>Dokument 8 2 Sistemi i Brendshem i Sigurimit të Cilësisë UBT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UBT -ja në “Strategjinë e zhvillimit të UBT” ka të përshkruara me detaje aspektin e Sigurimit të cilësisë. Ky aktivitet përfshin: Vetë-analiza, Treguesit e cilësisë, Vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve, Vlerësimin e studentëve, Vlerësimin e programeve mësimore, Vlerësimin e pjesmarrjes në veprimtarinë kërkimore, Vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve nacionale, rajonale dhe më gjerë. FBU në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit MSH në IAU – TAU.</p> <p>Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë diskutohen në GMK dhe në mbledhjen e radhës në DTAU si dhe në analizat e punës mësimore dhe kërkimore në Departament dhe ne Fakultet.</p> <p><i>Dokument 3 Plani Strategjik i UBT</i> <i>Dokument 65 Manual i Cilësisë UBT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ ka verifikuar dokumentin se UBT ka kryer akreditimin Institucional sipas shkresës të ASCAL Nr.154.Prot. datë 12.05.2017 dhe Vendimit të BA Nr.11, datë 07.04.2017 për: “Akreditimin e Parë të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”.</p> <p>FBU i nënshtrohet procesit të vlerësimit të mësimdhënies, çdo tre vjet, nga ASCAL dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.</p> <p><i>Dokument 66 Vendim Akreditimi Institucional i UBT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e</p>	<p>UBT është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në UBT, pranë Degës së Mësimit, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë. Fokusi i veprimtarisë së kësaj zyre është: Evidentimi i problematikave të</p>




kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	lidhura me mësimin si dhe evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies në funksion të përmirësimit të tij. Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. <i>Dokument 41 Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik</i> <i>Dokument 81 Thirrje e mbledhjes së Asamblese</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Në Rregulloren e FBU parashikohet “Rishikimi periodik i programit të studimit”. Fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit MSH në IAU - TAU dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i fakultetit aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces. Gjatë rishikimit vëmendje i kushtohet: rishikimit të shpërndarjes së krediteve për modulën apo grup - modulet përkatëse; rishikimit të programeve mësimore të moduleve të veçanta; rishikimit të elementëve përbërës të moduleve dhe ndarjen e kredive ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë etj); rishikimi i rregullores së programit të studimit; rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës; rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës; rishikimi i implementimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik; rishikimi i procedurave të kontrollit të dijeve/provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit; rishikimi i opinionëve/feedback-ut të marrë nga studentët. <i>Dokument 6_1 Rregullore FBU</i> <i>Dokument 52_1 Raport mbi ndryshimet e kurrikules</i> <i>Dokument 52_2 VD për ndryshim kurrikule 2016-2017</i> <i>Dokument 52_3 VD për ndryshim kurrikule 2018-2019</i> <i>Dokument 52_4 VD për ndryshim kurrikule 2017-2018</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Konstatohet se UBT ka zyrën për zbatimin e cilësisë si degë e zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit si dhe kanë rregulloret dhe manualin për mbajtjen e cilësisë apo zbatimin e kurrikulave të miratuara, po ashtu Departamentet në kuadër të Fakultetit monitorojnë zbatimin e kurrikulës. <i>Dokument 38_1 Analiza mësimore DTA 2017-2018</i> <i>Dokument 38_2 Analiza kërkimore DTA 2017-2018</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe	Pedagogët në përfundim të vitit mësimor japin një raport me shkrim për të gjitha aspektet e organizimit të mësimdhënies për modulet

mbarëvajtjen e programit të studimit.	përkatëse, duke evidentuar problemet dhe sugjeruar zgjidhje, si dhe në lidhje me procedurat e kontrollit të dijeve dhe rezultatet e marra. <i>Dokument 38_1 Analiza mësimore DTA 2017-2018</i> <i>Dokument 38_2 Analiza kërkimore DTA 2017-2018</i> <i>Dokument 38_3 Analizat e kërkimit, Indikatoret e Cilësisë</i> <i>Dokument 38_4 Performanca e Departamenteve FBU</i>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Pas takimit me përfaqësuesit e ZCSVI, GVJ konstatohet se “Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional” (ZSCVI) në bashkërendim dhe nën drejtimin e strukturave drejtuese të UBT ka përgatitur udhëzime dhe Manualin për sigurimin e cilësisë në Universitet në mbështetje të procesit të vlerësimit programor dhe institucional, sipas formateve standarde për sondazhet studentore, dhe të stafit. FBU në vazhdimësi kontrollon ecurinë e procesit mësimor, duke regjistruar të gjitha mangësitë në zhvillimin e mësimin, të cilat bëhen objekt në provesin e rishikimit. ZSCVI inspekton raportet e vlerësimit të përgatitura nga njësitë dhe kur gjen mos respektim të standardeve të përshkruara në Manual për sigurimin e cilësisë në Universitet ti sugjerojë njësive korrektimin e tyre.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë pjesë e Raporteve Vjetore të analizës mësimore dhe kërkimore të UBT, FBU, DTAU. Në këto Raporte janë përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. <i>Dokument 27_3 Evidenca e studentëve të regjistruar</i> <i>Dokument 27_6 Mesataret e studentëve të MSH në përfundim të studimeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësitë e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional (ZSCVI), kujdeset që dokumentacioni që prodhojnë fakultetet të përputhet me standardet kombëtare të cilësisë sipas cikleve të studimit, merr pjesë në përgatitjen e Guidës në nivel Universiteti, programon kalendarin e procesit të vetëvlerësimit në nivel universiteti dhe ndjek realizimin e tij, bashkëpunon me Dekanët e fakulteteve për realizimin e vetëvlerësimit dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore, harton draftin tip të kërkesave dhe drejtimeve të realizimit të vlerësimit institucional në UBT në konsultim dhe në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve, koordinon bashkëveprimin e strukturave të vlerësimit institucional të fakulteteve, mban lidhje të rregullta institucionale me Agjencinë Kombëtare të Akreditimit të Arsimit të Lartë pranë MASR.

	<p><i>Dokument 3_3 Raport i Vleresimit te Brendshem FBU 2018</i> <i>Dokument 8_1 Kodi i cilësisë ne Aresimin e Larte</i> <i>Dokument 30_1 Komisioni i Sig&Cilësisë FBU</i></p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>ZSCVI në bashkërendim dhe nën drejtimin e strukturave drejtuese të UBT ka përgatitur udhëzime në mbështetje të procesit të vlerësimit programor dhe institucional. ZSCVI për kryerjen e vlerësimit me formatet standarde për sondazhet studentore, dhe të stafit, Manualin për sigurimin e cilësisë në Universitet i cili është i miratuar nga struktura vendimmarrëse.</p> <p>ZSCVI inspekton raportet e vlerësimit të përgatitura nga FBU pjesë e analizës mësimore dhe kërkimore dhe kur gjen mos respektim të standardeve të përshkruara në Manual për sigurimin e cilësisë në Universitet sugjeron korrektimin e tyre.</p> <p><i>Dokument 8_2 Sistemi i Brendshem i Sig.Cilësisë UBT</i> <i>Dokument 67 Relacione nga komisioni i cilësisë&sigurisë FBU</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Zhvillimi i cilësisë në UBT përqendrohet në mbështetjen pa kushte për misionin dhe strategjinë e universitetit. Për këtë arsye Universiteti zhvillon një sistem eficient në lidhje me: Monitorimin, menaxhimin dhe politikën e vendim marrjes, Sigurimin e autonomisë së punës së pedagogëve dhe pozicionin jo diskriminues të studentëve, Internacionalizimin e edukimit të arsimit të lartë, Monitorimin e ecurisë së të diplomuarve dhe programet e postdiplomimit.</p> <p><i>Dokument 14_5 Programet e lëndëve sipas VKM nr.41</i> <i>Dokument 14_8 Planet mësimore</i> <i>Dokument 55 Pajisjet e laboratoreve shkencore per MSH</i> <i>Dokument 60 Linjat pilot</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë në përputhje me statutin e UBT. Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të cilat përgatiten nga DTAU. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, FBU organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë këtu përfshihet edhe programi MSH në IAU - TAU.</p> <p><i>Dokument 40 Pyetësori i studentëve</i> <i>Dokument 41 Pyetësori i stafit akademik</i> <i>Dokument 37_2 Analiza Mësimore Kërkimore 2017-2018</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>FBU ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga FBU, në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR. <i>Dokument 6_1 Rregullore e FBU</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>FBU, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi ku përfshihet edhe MSH në IAU - TAU. Vlerësimi i cilësisë së institucionit, kurrikulës, procesit mësimor, pedagogëve, studentëve, të kontrollohet në mënyre periodike dhe më pas duke marrë masat e nevojshme për përmirësim. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>Dokument 30_1 Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, FBU</i> <i>Dokument 30_2 Vendimi për rezultatin e zgjedhjeve 2016</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e FBU, Sigurimi i brendshëm i cilësisë, ecuria e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit MSH në IAU - TAU ndiqet nga DTAU dhe FBU. Të gjithë anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në këtë proces vlerësimi. <i>Dokument 6_1 Rregullore e FBU</i> <i>Dokument 14_8 Planet mësimore</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>DTAU është përgjegjëse për krijimin dhe ofrimin e programeve në përputhje me rregullat që garantojnë cilësinë e detyrueshme. Përgjegjësi i Departamentit mbikëqyr të gjithë aktorët e brendshëm për të përmbushur standardet e cilësisë nën drejtimin e Dekanatit në bashkëpunim me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë së Institucionit dhe Senatin. DTAU në kuadrin e MSH në IAU - TAU ka krijuar një rrjet të qëndrueshëm me partnerë të huaj dhe vendas që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. <i>Dokument 6_1 Rregullore e FBU</i> <i>Dokument 8_1 Kodi i Cilësisë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site:

E-mail: info@ascal.al

www.ascal.al82

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në Planin Strategjik të UBT 2016-2022 janë të përshkuara politikat dhe procedurat që do të ndjekë institucioni gjatë gjithë kësaj periudhe. Veprimtaritë që janë zhvilluar në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MSH në IAU - TAU janë transparente janë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë takimeve me asamblenë akademike dhe me studentët. Ato publikohen në website.			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UBT përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit MSH në IAU - TAU janë diskutuar në GMK dhe më pas në departament, diskutimet kanë respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit në rastet kur ka problematika shoqërohen me një plan masash dhe synon përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. <i>Dokument 3_3, Raport i Vlerësimit të Brendshëm FBU 2018 Kapitulli 13, pika 13.2</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Për vlerësimin dhe sigurimin e efektivitetit dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit UBT, FBU në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. <i>Dokument 40_1 Ngritja e Komisionit Anketimit Studente</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Mbledhjet e hapura të asamblesë të FBU ndërgjegjësojnë personelin studentët për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Agrorëshqimore profili Teknologji Agrorëshqimore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Prania në ambientet e FBU të laboratorëve shkencorë dhe 5 linjave pilot të instaluar në ambientet e departamentit DTAU si: linja për përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve, djathit, linja e prodhimit të verës e pijeve alkoolike, vajit ullirit, bukës dhe produkte konditore; ndihmon në lidhjen e njohurive teorike me aplikimin dhe aftësimin praktik të studentëve. Gjithashtu mundëson kryerjen e studimeve eksperimentale nga ana e studentëve në ambientet e fakultetit për realizimin e tezave të diplomës.
2. Pjesëmarrja pothuaj e të gjithë pedagogëve në projekte kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, ndihmon në aftësimin e tyre në procesin e kërkimit shkencor dhe njëkohësisht garanton kompetencë profesionale dhe angazhimin e tyre maksimal në procesin mësimor.
3. Staf i akademik i pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie në këtë Program Studimi ka realizuar studime shkencore, dhe botimi i artikujve shkencorë, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët është një tregues i përpjekjeve për të qënë në nivelet bashkohore të kërkimit shkencor. Kjo ka ndikuar dhe ndihmon gjithashtu në vënien e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve dhe procesit akademik.

Pika të dobta

1. Emërtimi i PS Master Shkencor në Inxhinieri Agrorëshqimore profili Teknologji Agrorëshqimore nuk përputhet plotësisht me përmbajtjen e kurrikulës. Konkretisht në total nga 15 module (një prej të cilave është teza e diplomes) 3 janë të mirfillta inxhinjrike. Inxhinjria e Përpunimit të Ushqimeve, Reologjia e brumerave dhe. Projektimi në Industrinë Ushqimore. Në lidhje me modulën e fundit, referuar syllabusit të lëndës temat që trajtohen kanë të bëjnë me inovacionin e produkteve të reja dhe jo mirfilli projektim në industrinë ushqimore. Në lidhje me pjesën tjetër të moduleve, disa kanë karakter teknologjik si: “Shkencat e bulmetit dhe prodhimi i djatherave special” “Rruajtja dhe mbrojtja e produkteve ushqimore,” “Teknikat bashkohore të paketimit”, “Drejtimi i cilesise dhe sigurise ushqimore”. Nga ana tjetër, 4 module nuk kanë lidhje me orientimin teknologjik ose inxhinjrik, si “Toksikologjia e ushqimeve” “Biokimia e ushqimit dhe të ushqyerit tek njeriu” “Kimia e produkteve natyrore” “Metodologji e kërkimit shkencor”. Në këtë aspekt duhet të bëhet përmirësimi i kurrikules me module të grup lëndëve inxhinjrike. (modulet e këtij grupi që kanë të bëjnë me modelimin matematik dhe fizik, dinamikën, simulimin dhe optimizimin e proceseve në industri dhe në fund me projektimin e proceseve dhe impjanteve).
2. Institucionalizimi jo i plotë dypalësh i marrdhënieve me operatorët e biznesit, për pjesëmarrjen më të madhe të studentëve në kërkimin shkencor për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që kanë lidhje me prodhimin, ruajtjen dhe vlerësimin e sigurisë dhe cilesisë ushqimore.
3. Financim i kufizuar nga buxheti i shtetit për realizimin e proceseve të prodhimit dhe eksperimentimit shkencor në linjat pilot. Mungojnë reagentet kimike që duhet të sigurohen

- nga buxheti i Universitetit. Koha që duhet nga porositja e reagentëve/pajisjeve të konsumueshme deri tek lëvrimi i tyre në laboratorë kërkon muaj.
4. Ndjehet nevoja për staf teknik për shërbim, mirëmbajtjeje të aparaturave laboratorike dhe vënien në efikasitet të të gjitha paisjeve, në laboratorët shkencorë.

Rekomandime

1. Emërtimi i programit të studimit duhet të përputhet plotësisht me përmbajtjen e kurikulës. Për të ruajtur emërtimin aktual, Institucioni duhet të përmirësojë kurikulën me lëndë të fushës inxhinierike.
2. Të punohet më shumë për institucionalizimin dy palësh me biznese për të rritur numrin e pjesëmarrjes së studentëve në kërkimin shkencor për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që kanë lidhje me prodhimin, ruajtjen dhe vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore.
3. Të rriten mundësitë financiare dhe të shtohet buxheti për paisje laboratorike/praktikat mësimore në funksion të rritjes së cilësisë të programit të studimit.
4. Të shikohet mundësia për të rritur numrin e stafit teknik të kualifikuar.

Conclusions on the Evaluation of the Bachelor Study Program in " Master of Science in Agro-Food Engineering profile Agro-food technology", Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. Presence in the FBU of scientific laboratories and five pilot lines installed in DTAU department premises such as: milk and by-products processing line, manufacturing cheese line, wine and liquor production line, olive oil production line, bread and confectionery products processing and controlling laboratories; helps to link theoretical knowledge with practical application and training of students. It also allows students to carry out experimental studies in the faculty premises for the realization of the diploma thesis.
2. The participation of almost all lecturers in research projects, at our country and abroad, helps in their training in scientific research and at the same time guarantees professional competence and their maximum engagement in the teaching process.
3. The academic staff of lecturers engaged in teaching in this Study Program has carried out some of scientific studies. The publication of scientific articles, books or studies carried out by lecturers is an indication of efforts to be up-to-date on scientific research. This has influenced and also helps them to put the research results at the service of students and the academic process.

Weak points

1. The title of PS Master of Science in Agro-Food Engineering profile Agro-food technology does not fully comply with the content of the curriculum. Specifically, out of 15 modules (one of which is a diploma thesis) 3 are genuine engineering: "Food Processing Engineering", "Rheology of bread dough and conductive products" and "Designing in the Food Industry". Regarding the last module, referring to the subject syllabus the topics covered relate to innovation of new products rather than proper design in the food industry. In relation to the rest of the modules, some have technological characteristics such as:

"Dairy science and specialty cheeses production" "Preservation and protection of food products," "Contemporary packaging techniques", "Management of food quality and safety". On the other hand, 4 modules are not related to technological or engineering orientation, such as "Food Toxicology" "Biochemistry of Food and Human Nutrition" "Chemistry of Natural Products" "Research Methodology". The curriculum should be improved, in this regard with modules of engineering subject groups. (modules of this group dealing with mathematical and physical modeling, dynamics, simulation and process optimization in industry and finally design of processes and plants).

2. Incomplete institutionalization of relations with business operators, for the greater participation of students in scientific research to solve various problems related to production, preservation and evaluation of food safety and quality.
3. Limited funding from the state budget for the implementation of processes and scientific experimentation on pilot lines. There are no chemical reagents to be provided from the University budget. It takes months from ordering consumable reagents or equipment to delivering them to laboratories.
4. There is a need for technical staff to service, maintain laboratory equipment and make all equipment efficient in scientific laboratories.

Recommendations

1. Full program title compatibility with the content of the curriculum will must be. In order to maintain the current title, the Institution should improve its curriculum in engineering subjects.
2. Efforts be made to institutionalize bilateral partnerships with businesses to increase student participation in research to solve various issues related to the production, preservation and evaluation of food safety and quality.
3. Increase funding opportunities and increase the budget for laboratory equipment / teaching practices to improve the teaching quality of the study program.
4. Consider the possibility of increasing the number of qualified technical staff.

Ekspertët e vlerësimit

External Evaluation experts

Prof As Laura Shabani

Prof. As Bedri Dragusha

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			✓	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR				

